RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Degës Doganore Shkodër

Tiranë, gusht 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**4 - 8**
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit...	
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve...	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit...	
II.	**HYRJA**	**9 - 11**
1.	Objektivat dhe qëllimi ...	
2.	Identifikimi i çështjes...	
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese ...	
4.	Përgjegjësitë e audituesve...	
5.	Kriteret e vlerësimit...	
5.	Standardet e auditimit...	
7.	Metodat e auditimit...	
8.	Dokumentimi i auditimit...	
III	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	**12 - 176**
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	**12 - 12**
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	**12 - 176**
2.1	*Auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave doganore për periudhën nën auditim.*	**12 - 17**
2.2	*Auditimi i borxhit doganor, gjendja dhe masat e marra për rikuperimin e tij për periudhën nën auditim.*	**17 - 51**
2.3	*Auditimi i veprimtarisë doganore për procedurat e ndjekura sipas ligjit nr. 61, datë 24.05.2012 "Për akcizat në RSH", i ndryshuar, për periudhën nën auditim.*	**51 - 64**
2.4	*Auditimi i procedurave doganore, të ndjekura, në lidhje me veprimtarinë e regjimeve doganore ekonomike, magazinimit të përkoshëm dhe tranziteve, për periudhën nën auditim.*	**64 - 151**
2.5	*Auditimi i procedurave të ndjekura mbi vendimet administrative, të nxjerra nga autoriteti doganor, për periudhën nën auditim.*	**151 - 176**
IV	**REKOMANDIME**	**177 - 182**

LISTA E SHKURTIMEVE.

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KM	Këshilli i Ministrave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
MF	Ministria e Financave
DD	Dega Doganore
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
AD	Autoriteti Doganor Kompetent
VA	Vendim Administrativ
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
PV	Procesverbal
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
RPA	Regjimi i Përpunimit Aktiv
RLP	Regjimi i Lejimit të Përkohshëm
RSH	Republika Shqipërisë
DOH	Departamenti Operativ Hetimor
DA	Departamenti i Akcizës
MTL	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë
DZKD	Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor
NKM	Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave
DAV	Dokument Administrativ i Vetëm (Deklaratë Doganore)
TD	Taksa Doganore
KD	Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë
TAM	Taksë Ambalazhi
DSHA	Dokument Shoqërues Administrativ
LD	Laboratori Doganor
ISHTI	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial
ML	Magazinë e Lirë
MD	Magazinat Doganore
UE	Urdhër Ekzekutimi
DRRMSH	Drejtoria Rajonale e Rezervave Materiale të Shtetit
MSABE	Marrëveshja Stabilizim Asocimit me Bashkimin Europian

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 15/1, datë 15.01.2026, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Degën Doganore Shkodër, për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2020 deri më datën 31.12.2025.

Dega Doganore Shkodër është një njësi funksionale e miratuar që varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Kjo degë doganore mbulon operacione të deklarimit doganor të mallrave dhe zhdoganimit të tyre duke mundësuar lehtësimin e procedurave doganore për hedhjen e mallrave në territorin doganor si dhe kryerjen e procedurave të tjera doganore, tranzitim, magazinim, eksportim etj.

Misioni i Degës Doganore Shkodër, është: Mbledhja e të ardhurave doganore, garantimi i interesave fiskalë, të sigurisë dhe mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë; Mbikëqyrja e tregtisë ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, duke kontribuar për tregtinë e hapur e të drejtë në zbatim të politikave tregtare dhe atyre të sektorëve të tjerë të ekonomisë shqiptare, që ndikojnë në tregti dhe në sigurinë e të gjithë zinxhirit tregtar; Mbrojtja e interesave financiarë dhe mjedisorë të Republikës së Shqipërisë nga tregtia e padrejtë dhe e paligjshme, duke mbështetur ndërkohë aktivitetin e ligjshëm të biznesit; Garantimi i sigurisë e i mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe i banorëve të saj, si dhe mbrojtjes së mjedisit.

Nëpërmjet zbatimit të: -Parimit të mbrojtjes së shoqërisë dhe interesave financiarë të Republikës së Shqipërisë; -Parimit të mbështetjes së konkurrueshmërinë së kompanive shqiptare; -Parimit të lehtësimit të mëtejshëm të tregtisë së ligjshme; -Parimit të kontrollit dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit të përdorur për lëvizjen ndërkombëtare të mallrave; -Parimit të bashkëpunimit, duke mbajtur, zhvilluar dhe shtuar marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet autoriteteve doganore dhe agjencive të tjera qeveritare si dhe ndërmjet autoriteteve doganore dhe komunitetit të biznesit.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Në mbështetje të planit vjetor të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer auditimi i këtij institucioni, duke kontribuar kështu në realizimin e vizionit të KLSH-së për rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përmirësimin e shërbimeve publike si dhe për vetë rëndësisë që ka auditimi i njësive doganore të cilat kontribuojnë në mbledhjen e të ardhurave për Buxhetin e Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave.

Qëllimi i këtij auditimi ishte dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2025. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Planifikimi dhe realizimit i të ardhurave doganore për periudhën nën auditim.
- Borxhi doganor, gjendja dhe masat e marra për rikuperimin e tij për periudhën nën auditim.
- Veprimtaria doganore për procedurat e ndjekura sipas ligjit nr. 61, datë 24.05.2012 "*Për akcizat në RSH*", i ndryshuar, për periudhën nën auditim.
- Procedurat doganore, të ndjekura, në lidhje me veprimtarinë e regjimeve doganore ekonomike, magazinimit të përkoshëm dhe tranziteve, për periudhën nën auditim.
- Procedurat e ndjekura mbi vendimet administrative, të nxjerra nga autoriteti doganor, për periudhën nën auditim.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas

ose të kombinuara metodat dhe teknikat si vijon: verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 16 gjetje dhe ka dhënë 16 rekomandime, *nga të cilat;* masa organizative 12 gjetje me 12 rekomandime, masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara 4 gjetje dhe 4 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

1-Nga auditimi i dosjeve të përzgjedhura për auditim u konstatua mosrespektim i afatit për mbylljen e regjimeve RPA, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi. Më hollësisht, për 6 subjekte, regjimet RPA rezultojnë të mbyllura jashtë afatit kohor prej 30 ditësh për mbylljen e regjimit, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 251/2/1 të Kodit Doganor "Mosrespektimi nga mbajtësi i regjimit të përpunimit aktiv i detyrimit për mbylljen e regjimit doganor brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 23", si dhe me Udhëzimin nr. 4, datë 28.03.2019, pika 18, germa "dh" dhe kreu XIV, pika 2 të këtij udhëzimi, pasi regjimi duhej të mbyllej 30 ditë pas dhënies së destinacionit të produkteve parësore kompensuese. Nga autoriteti përgjegjës nuk është mbajtur procesverbal konstatimi, referuar nenit 273.3 të KD. Nga mosveprimi, referuar nenit 256, pika 1, shkronja "b" të KD, penaliteti është 20,000 lekë dhe, si rezultat, efekti financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit rezulton në total 120,000 lekë;

2-Nga auditimi i dosjeve të përzgjedhura për auditim u konstatua se 12 subjekte kanë importuar mallra që do të vendoseshin nën regjimin doganor për t'u përpunuar me kode që nuk janë pjesë e autorizimit RPA, të përcaktuara në pikën 7 të autorizimit të operatorit, si dhe kanë eksportuar mallra të përpunuara për të cilat nuk disponojnë kodet përkatëse në pikën 8 të autorizimit të RPA. Për këta artikuj, të papërfshirë në kodet tarifore të përcaktuara në pikat 7 dhe 8 të autorizimit, duhej të ishin paguar detyrimet doganore si në hyrje, ashtu edhe në dalje. Këto veprime nuk janë në përputhje me kërkesat e nenit 250.1/a, 250.2 dhe 250.4 të KD. Referuar neneve të sipërcituara, për shkeljen doganore të kryer, subjektet, përveç detyrimeve doganore (të cilat nuk janë përllogaritur në këto raste, duke qenë se mallrat janë rieksportuar në formën e produkteve kompensuese), për kodin tarifor të papërfshirë në autorizim duhej të penalizoheshin me 20,000 lekë për çdo deklaratë, referuar nenit 251, pika 1 dhe nenit 256, pika 1, shkronja "b" të KD. Efekti financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit është 990,000 lekë;

3-Nga auditimi i dosjeve të përzgjedhura për auditim, lidhur me subjektet që operojnë nën regjimin RLP, rezultoi se 4 subjekte kanë diferenca në sasi, pasi kanë eksportuar më tepër nga sa është përcaktuar në autorizim. Këto veprime të subjekteve, për diferencën në sasi të përcaktuar në autorizimin e RLP-së, përbëjnë shkelje doganore, referuar neneve 250, 252/c dhe 257/1, shkronja "b" të KD. Efekti financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit është 200,000 lekë.

4-Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Dega Doganore Shkodër, lidhur me vendimet administrative, në 5 (pesë) raste, të specifikuara në aneksin nr. 2, u konstatua mostrajtim i drejtë dhe klasifikim i gabuar i shkeljeve doganore duke mos aplikuar sanksionet apo penalitetin e duhur. Si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve, në kundërshtim me nenet 251, 252, 256 dhe 257 të Kodit Doganor, janë shkaktuar të ardhura të munguara në shumën 208,483 lekë;

5-Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të detyrimeve të papaguara është konstatuar se, në të gjitha rastet, Vendimi mbi Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor nuk është nxjerrë brenda afatit të parashikuar në pikën 2.1 të kapitullit VII të Udhëzimit nr. 15, datë 03.12.2018, "*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës*";

6-Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të lidhura me veprimtarinë e regjimeve RPA që kanë operuar pranë Degës Doganore Shkodër, rezulton se, në 58 raste, nuk është kryer kontroll fizik për verifikimin e koeficientit të shfrytëzimit, veprim i cili është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 4, datë 28.03.2019, "*Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv*", kreu XIII, pika 5.
7-Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Dega Doganore Shkodër, lidhur me vendimet administrative, në 24 (njëzet e katër) raste, të specifikuara në aneksin nr. 1, u konstatua se, edhe pse autoriteti vendimmarrës ka përdorur diskrecion në aplikimin e sanksionit, në lidhje me këtë të fundit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar. Mosveprim në kundërshtim me nenin 100 të "*Kodi i Procedurave Administrative*";
8-Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Dega Doganore Shkodër, lidhur me vendimet administrative, në 3 (tre) raste, të specifikuara në aneksin nr. 1, u konstatua se, edhe pse autoriteti vendimmarrës praktikisht ka sekuestruar mallin objekt kontrabande dhe ka zgjidhur administrativisht kontrabandën sipas nenit 272 KD, nuk rezulton të ketë marrë (formalizuar) një vendim të shkruar për sekuestrimin e përkohshëm të mallit objekt kontrabande apo për zgjidhjen administrative të kontrabandës. Mosveprim në kundërshtim me pikën 1 të nenit 268 dhe nenin 272 të "*Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë*".

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

1-Kryetari i Degës Doganore Shkodër të marrë masa për shqyrtimin, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve doganore/penaliteteve për subjektet që kanë rezultuar me shkelje në procedurat dhe respektimin e afateve për mbylljen e regjimit të përpunimit aktiv, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor në fuqi;
2-Kryetari i Degës Doganore Shkodër të marrë masa për shqyrtimin, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve doganore/penaliteteve për subjektet që kanë rezultuar me shkelje të autorizimit përkatës, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor në fuqi;
3-Kryetari i Degës Doganore Shkodër të marrë masa për shqyrtimin e diferencave në sasi të konstatuara në eksportet e kryera nga subjektet nën regjimin RLP, si dhe të marrë masa për shqyrtimin, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve doganore apo penaliteteve për subjektet që kanë rezultuar me shkelje, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor në fuqi;
4-Kryetari i Degës Doganore Shkodër të marrë masat për ngritjen e një grupi pune me qëllim analizimin e situatave të konstatuara dhe, në rastet ku ekziston mundësia ligjore, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në shumën 208,483 lekë;
5-Nga Dega Doganore Shkodër të merren masa për nxjerrjen në kohë të Vendimit për Rikuperimin me Forcë të Detyrimeve Doganore, pas mbarimit të afatit 10-ditor nga marrja dijeni mbi njoftimin e vendimit;
6-Kryetari i Degës Doganore Shkodër të marrë masa për të siguruar kryerjen e kontrollit fizik, si dhe kryerjen e verifikimit të koeficientit të shfrytëzimit në të gjitha rastet e regjimit RPA, sipas kartave teknologjike;
7-Autoriteti Vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, në të ardhmen, në të gjitha rastet e përdorimit të diskrecionit në aplikimin e sanksionit, të specifikojë në arsyetimin e aktit administrativ, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar;
8-Autoriteti Vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, në të ardhmen, në të gjitha rastet e vendimmarrjes për zgjidhjen administrative të kontrabandës apo sekuestrimit të mallit objekt kontrabande, të shoqërojë dhe formalizojë këto veprime një vendim të shkruar.

I.1. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT.

Nga auditimi i kryer pranë Degës Doganore Shkodër, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2025, lidhur me përputhshmërinë, rezultuan mangësi kryesisht në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave doganore, masat e marra për rikuperimin e borxhit doganor, procedurat e ndjekura në lidhje me veprimtarinë e regjimeve doganore ekonomike si dhe procedurat e ndjekura mbi vendimet administrative, të nxjerra nga autoriteti.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion mbi auditimin e përputhshmërisë:

Mbështetur në, ISSAI 4000 "Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë", Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, ne audituam përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë së Degës Doganore Shkodër me kriteret e vlerësimit në kuadrin ligjor që përfshin ligjin nr. 102, datë 31.07.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, ligjin nr. 61/2012 datë 24.05.2012 "*Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, ligjin nr. 92 datë 24.07.2014 "*Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, etj dhe aktet nënligjore për rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës, duke u fokusuar në realizimin e të ardhurave doganore, masat e ndërmarra për rikuperimin e borxhit doganor, procedurat e ndjekura mbi vendimet administrative, autorizimet e regjimeve doganore dhe atyre të akcizës, për periudhën 01.01.2020-31.12.2025.

Opinion i kualifikuar[1].

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Degës Doganore Shkodër, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinionin", të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar për përputhshmërinë.

Baza për opinionin e kualifikuar:

- Nga auditimi janë konstatuar problematika lidhur me masat e ndërmarra si për vjeljen ashtu dhe për raportimin e borxhit doganor, duke mos përllogaritur saktë kamatëvonesat; apo mos marrjen në kohë të vendimit administrativ nga autoriteti doganor, pas mbajtjes së procesverbaleve përkatëse për konstatimet e problematikave.
- Janë konstatuar mangësi në vendimmarrjen lidhur me problematikat e konstatuara të vendimeve administrative për subjektet që operojnë pranë kësaj dogane, si dhe në autorizimet e magazinave fiskale, RLP dhe RPA.
- U konstatua mosrespektim i afatit për mbylljen e regjimeve RPA, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi dhe, si rezultat, efekti financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit 120,000 lekë.
- Janë konstatuar 12 subjekte që kanë importuar mallra që do të vendoseshin nën regjimin doganor për t'u përpunuar me kode që nuk janë pjesë e autorizimit RPA për një efekt financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit 990,000 lekë.
-Lidhur me subjektet që operojnë nën regjimin RLP, u konstatua se 4 subjekte kanë diferenca në sasi, pasi kanë eksportuar më tepër nga sa është përcaktuar në autorizim, për një efekt financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit 200,000 lekë.
-Janë konstatuar, në 5 (pesë) raste, mostrajtim i drejtë dhe klasifikim i gabuar i shkeljeve doganore duke mos aplikuar sanksionet apo penalitetin e duhur. Si pasojë, janë shkaktuar të ardhura të munguara në shumën 208,483 lekë.

[1] *Opinioni i kualifikuar, jepet kur:*
-audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura;
-audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

- Nga auditimi i dosjeve të detyrimeve të papaguara për vitet 2020-2025, është konstatuar se: në 8 raste, nuk është kërkuar në kohë pezullimi i aktivitetit ekonomik në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve; në 5 raste, nuk është kërkuar bllokimi i veprimeve në sistemin ASYCUDA WORLD; në 15 raste, ka pasur vonesa në dërgimin e kërkesave për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit; në të gjitha rastet, Vendimi mbi Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor nuk është nxjerrë brenda afatit të parashikuar.
- Lidhur me veprimtarinë e regjimeve RPA që kanë operuar pranë Degës Doganore Shkodër, në 58 raste, nuk është kryer kontroll fizik për verifikimin e koeficientit të shfrytëzimit.
- Lidhur me vendimet administrative, në 24 (njëzet e katër) raste, edhe pse autoriteti vendimmarrës ka përdorur diskrecion në aplikimin e sanksionit, në lidhje me këtë të fundit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", i ndryshuar, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 15/1, datë 15.01.2026 "*Auditim Përputhshmërie*", miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Dega Doganore Shkodër nga data 19.01.2026 deri në datën 24.04.2026, u krye auditimi për periudhën nga data 01.01.2020 deri më datën 31.12.2025 nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. K.T., *përgjegjës grupi;*
2. I.F., *auditues;*
3. A.B., *auditues.*

1. OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

- Objektivat dhe Qëllimi i auditimit.

Në objektivat dhe qëllimi i auditimit të përputhshmërisë në Degën Doganore Shkodër është vlerësimi i rregullshmërisë të subjektit të audituar përgjatë periudhës 01.01.2020 deri në 31.12.2025 për përputhshmërinë e aktivitetit dhe dhënien e opinionit të përputhshmërisë mbi bazën e nivelit të materialitetit dhe vlerësimit të risqeve, si dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI. Gjithashtu objektivat përfshijnë vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij. Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese janë:

- Evidentimi i shmangieve të veprimtarisë me kriteret e vlerësimit, në bazë të kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi, për periudhën objekt auditimi;
- Evidentimi i të metave dhe mangësive në lidhje me zbatimin e proceseve sipas legjislacionit dhe rregullave të funksionimit;
- Vlerësimi i veprimeve, zbulimi i mospërputhjeve me pasojë të ardhura të pa llogaritura, mungesë të ardhurash etj;
- Vlerësimi i transparencës me publikun dhe biznesin, krahasimi i rezultateve të veprimtarisë së institucionit midis viteve objekt i auditimit;
- Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës;
- Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, shlyerjen e dëmeve të mundshme ekonomike dhe parandalimin e mospërputhjeve në të ardhmen;
- Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, gjatë veprimtarisë së tij.

- Identifikimi i çështjes.

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Degës Doganore Shkodër dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve. Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, çështjet e vlerësuara i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH-së në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së këtij institucioni publik, transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Raporti i Auditimit është i strukturuar në disa kapituj ku identifikohet hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit, përfshirë gjetjet dhe rekomandimet së bashku me anekset sqaruese.

- ***Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.***

Strukturat drejtuese të Degës së Doganës Shkodër janë përgjegjëse për realizimin e të ardhurave doganore, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në fushën e vlerësimit doganor, etj. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Degës së Doganës Shkodër janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit për aktivitet kryesore. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.

- ***Përgjegjësitë e audituesve*.**

Audituesit e KLSH janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.; shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikes me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

- Kriteret e vlerësimit.

Përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të DDSh, normat dhe metodat e përcaktuara sipas kërkesave të ligjeve, akteve administrative, rregullores së institucionit dhe përcaktimet në marrëveshjet ndërkombëtare që kanë lidhje me sistemin doganor në Republikën e Shqipërisë. Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kritere përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

Standardet e auditimit: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI/IFPP 100; 400-499; 4000-4899; 4900 etj.; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; (ECA); - Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve.

Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë; Manuali mbi Ndjekjen e Zbatimit të Rekomandimeve të KLSH; - Manuali mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin; Akte ligjore: - Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*"; - Ligji nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar; - Ligji nr. 61, datë 24.05.2012 "*Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; - Ligji nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*"; - Ligjin nr. 8474 datë 14.04.1999 "*Për miratimin e Nomenklaturës dhe të Tarifës Doganore*", i ndryshuar; - Akte nënligjore: - VKM nr. 651 datë 10.11.2017 "*Për dispozitat zbatuese të KD*"; - VKM nr. 612, datë 05.09.2012 "*Për dispozitat zbatuese të ligjit "Për Akcizat*", i ndryshuar. Rregullore: - Rregullore e Brendshme "*Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ KLSH-së*" - Rregullore mbi Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, etj. -Standardet e auditimit ISSAI 100 "*Parimet themelore të Auditimit të Sektorit Publik*", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; - ISSAI 2000-2899 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*"; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); - Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj..

- ***Metodat e auditimit*.**

Audituesit e KLSH-së, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion,

intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e Degës Doganore Shkodër, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuar me akt-konstatimet, projekt raporti dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

- *Dokumentimi i auditimit*.

Mbi bazën e pyetësorëve dhe testeve përkatëse të miratuara në manualet e auditimit të përputhshmërisë, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartua Projekt Rapori i cili u dërgua në Degën Doganore Shkodër, me shkresën nr. 15/5 prot., datë 01.06.2026, protokolluar pranë Degës Doganore Shkodër, me nr. 28/28 prot., datë 04.06.2026.

Pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, të ardhura me shkresën nr. 28/34 prot, datë 30.06.2026, prot., KLSH nr. 15/6 prot., datë 02.07.2026, nga grupi i auditimit të KLSH-së, u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Auditimi i këtij institucioni lidhur me realizimin e të ardhurave kundrejt planit, buxhetit, dhe vlerësimit të përputhshmërisë së veprimtarisë së sektorëve të Degës Doganore Shkodër ka një rëndësi të veçantë, lidhur me transparencën e veprimtarisë në këtë fushë, impaktin financiar në buxhetin e shtetit si dhe zbatimin e parimeve të tregtisë së lirë. Për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, kryerja e këtij auditimi, ka rëndësi lidhur me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe anomalive materiale me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, nga mangësitë në aplikimin e kritereve të duhura ligjore gjatë procesit të vlerësimit doganor. Dega Doganore Shkodër është një institucion buxhetor në varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, e ngarkuar për administrimin dhe mbledhjen e të ardhurave doganore në formën e taksës doganore, taksave kombëtare të ngarkuara me ligj për tu mbledhur, detyrime doganore në formën e TVSh-së, dhe të tjera detyrime për tu paguar në Buxhetin e Shtetit që ja ngarkon legjislacioni fiskal në RSH si dhe përgjegjëse për përgatitjen e planeve dhe objektivave institucional, në funksion të promovimit të transparencës së duhur në marrëdhëniet me subjektet dhe operatoret deklarues, duke siguruar sisteme të kontrollit të brendshëm që minimizojnë riskun e korrupsionit, dhe trajtimin e paanshëm dhe të barabartë për të gjithë importuesit dhe deklaruesit e mallrave. Financimi i institucionit kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) sipas programit buxhetor "Menaxhimi i të ardhurave Doganore", pjesë e programeve buxhetore të administruara nga Ministria e Financave. Kuadri rregullator nga e cila udhëhiqet administrata e Degës Doganore Shkodër, është legjislacioni doganor ku respektivisht detyrat funksionale sipas funksionit organik janë sanksionuar në Rregulloret e Brendshme të miratuara nga Ministria e Financave. Gjithashtu Dega Doganore Shkodër ka si objektiva kryesore: Sigurimin e mbledhjes korrekte dhe të efektshme të detyrimeve dhe taksave nëpërmjet rritjes së efiçencës ne punë të stafit doganor, zbatimin korrekt të legjislacionit, uljen e kohës së përpunimit të deklaratës doganore, duke ulur njëkohësisht dhe kostot shtesë të operatorëve ekonomikë që kryejnë veprime doganore në këtë pikë doganore; Rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj udhëtareve dhe subjekteve që operojnë me këtë Degë Doganore duke krijuar lehtësi në lëvizje dhe kontroll efiçient, duke synuar uljen e evazionit fiskal nëpërmjet zbulimit dhe ndëshkimit të shkeljeve doganore sipas legjislacionit në fuqi.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

2.1. Auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave doganore për periudhën nën auditim.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit nr. 15/1, datë 15.01.2026, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Të dhëna mbi planifikimin dhe realizimin e të AD, sipas strukturës së tyre për vitet 2020-2026;
- Të dhëna mbi realizimin e të AD, në analizë krahasuese për periudhën 2020-2025.

Auditimi mbi të Ardhurat Doganore (AD) u fokusua në drejtimet e mëposhtme:

- Planifikimi i të ardhurave dhe realizimi i tyre, për vitet 2020- 2025, analizë treguesish;
- Ecuria e realizimit të të ardhurave nga DDSh, në analizë krahasuese për periudhën 2020-2025;

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga subjekti DDSh mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave për vitin 2020-2025 ka rezultuar si më poshtë:

Realizimi Planit 2020 (Në 000/lekë)

Periudha	Plani 2020	Fakti 2020	Diferenca plan/fakt	Realizimi në % plan/fakt
2020	3,004,333	2,972,626	-31,708	99

Të dhënat: DDSh, Punoi:KLSH

Siç shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme, në vitin 2020, të ardhurat doganore paraqiten me mosrealizim në masën 1% ose në shumën 31,708 mijë lekë.

Realizimi Plan/Fakt 2021 (Në 000/lekë)

Periudha	Fakti 2020	Plani 2021	Fakti 2021	Diferenca plan/fakt	Realizimi në % plan/fakt	Realizmi në % 2021/2020
2021	2,972,626	3,178,446	3,759,010	580,563	118	126

Të dhënat: DDSh, Punoi:KLSH

Siç shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme, në vitin 2021, të ardhurat doganore paraqiten me tejkalim në masën 18% ose në shumën 580,563 mijë lekë, krahësuar me faktin e vitit 2020 të ardhurat janë realizuar me tejkalim në masën 26% ose në shumën 786,384 lekë.

Realizimi Plan/Fakt 2022 (Në 000/lekë)

Periudha	Fakti 2021	Plani 2022	Fakti 2022	Diferenca plan/fakt	Realizimi në % plan/fakt	Realizmi në % 2022/2021
2022	3,759,010	4,233,528	4,371,575	138,047	103	116

Të dhënat: DDSh, Punoi:KLSH

Siç shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme, në vitin 2022, të ardhurat doganore paraqiten me tejkalim në masën 3% ose në shumën 138,047 mijë lekë, krahësuar me faktin e vitit 2021 të ardhurat janë realizuar me tejkalim në masën 16% ose në shumën 612,566 lekë.

Realizimi Plan/Fakt 2023 (Në 000/lekë)

Periudha	Fakti 2022	Plani 2023	Fakti 2023	Diferenca plan/fakt	Realizimi në % plan/fakt	Realizmi në % 2023/2022
2023	4,371,575	4,927,976	5,002,962	74,986	102	114

Të dhënat: DDSh, Punoi:KLSH

Siç shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme, në vitin 2023, të ardhurat doganore paraqiten me tejkalim në masën 2% ose në shumën 74,986 mijë lekë, krahësuar me faktin e vitit 2022 të ardhurat janë realizuar me tejkalim në masën 14% ose në shumën 631,387 lekë.

Realizimi Plan/Fakt 2024 (Në 000/lekë)

Periudha	Fakti 2023	Plani 2024	Fakti 2024	Diferenca plan/fakt	Realizimi në % plan/fakt	Realizmi në % 2024/2023
2024	5,002,962	5,170,208	5,520,327	350,118	107	110

Të dhënat: DDSh, Punoi:KLSH

Siç shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme, në vitin 2024, të ardhurat doganore paraqiten me tejkalim në masën 7% ose në shumën 350,118 mijë lekë, krahësuar me faktin e vitit 2023 të ardhurat janë realizuar me tejkalim në masën 110% ose në shumën 517,364 lekë.

Realizimi Plan/Fakt 2025 (Në 000/lekë)

Periudha	Fakti 2024	Plani 2025	Fakti 2025	Diferenca plan/fakt	Realizimi në % plan/fakt	Realizmi në % 2025/2024

2025	5,520,327	5,391,737	5,858,926	467,189	109	106

Të dhënat: DDSh, Punoi:KLSH

Siç shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme, në vitin 2025, të ardhurat doganore paraqiten me tejkalim në masën 9% ose në shumën 467,189 mijë lekë, krahësuar me faktin e vitit 2024 të ardhurat janë realizuar me tejkalim në masën 6% ose në shumën 338,599 lekë, konstatohet se për vitin 2025 plani është parashikuar më i ulët se fakti i vitit paraardhës.

Të ardhurat Doganore viti 2020-2025 (sipas llojit të taksave)

(Në 000/lekë)

Llojet e taksave	Plani			Realizimi/Fakt			Realizimi në %		
	2020	2021	2022	2020	2021	2022	2020	2021	2022
Taksë dog.	62,280	74,853	99,117	59,963	80,100	105,979	96%	107%	107%
Akcizë	167,453	249,557	235,595	181,033	249,077	258,390	108%	100%	110%
TVSH	2,757,770	2,845,334	3,889,681	2,719,735	3,420,127	3,999,584	99%	120%	103%
Renta	16,830	8,703	9,135	11,894	9,705	7,623	71%	112%	83%
Totali	**3,004,333**	**3,178,446**	**4,233,528**	**2,972,626**	**3,759,010**	**4,371,575**	**99%**	**118%**	**103%**
	2023	2024	2025	2023	2024	2025	2023	2024	2025
Taksë dog.	100,011	141,265	153,849	107,977	142,963	142,247	108%	101%	92%
Akcizë	259,771	314,799	292,574	325,031	341,770	319,710	125%	109%	109%
TVSH	4,557,951	4,705,248	4,935,171	4,559,580	5,025,676	5,384,843	100%	107%	109%
Renta	10,243	8,896	10,142	10,375	9,917	12,125	101%	111%	120%
Totali	**4,927,976**	**5,170,208**	**5,391,737**	**5,002,962**	**5,520,327**	**5,858,926**	**102%**	**107%**	**109%**

Të dhënat: DDSh, Punoi:KLSH

Sa sipër rezulton se për vitin 2020 DD Shkodër rezulton me mosrealizim të të ardhurave në shumën -1%, ku ndikimin më të madhë në % e ka Renta me -29%, Taksa doganore me -4% si dhe TVSh-ja me -1%, konstatohet se për vitin 2022 kemi një mosrealizim të Rentës me -17%, gjithashtu për vitin 2024 rezulton me mosrealizim Taksa doganore -8%. Ndër faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e këtij zëri është ndryshimi i kursit të këmbimit.
Konstatohet se për vitin 2025 plani është parashikuar më i ulët se fakti i vitit paraardhës në vlerën -128,590 mijë lekë, ose në masën 97% kundrejt faktit të vitit 2024.

Mbi faktorët që kanë ndikuar në realizimin e të ardhurave doganore.

- **Taksa Doganore:**

Të ardhurat nga "Taksa doganore" për vitet 2021, 2022, 2023 dhe 2024 respektivisht rezultojnë me realizim në vlerën 80,100 mijë lekë, 105,979 mijë lekë, 107,977 mijë lekë dhe 142,963 mijë lekë, ose në masën 107%, 107%, 108% dhe 112%, kundrejt planit. Për vitin 2020 konstatohet një mosrealizim në vlerën -2,317 mijë lekë ose në realizim në masën 96%, gjithashtu për vitin 2025 konstatohet një mosrealizim në vlerën - 11,602 mijë lekë ose në realizim në masën 92%, rënia e të ardhurave nga taksat doganore lidhet me ndryshimin e strukturës së importeve drejt mallrave me tarifë të reduktuar ose zero, si dhe me kursin e këmbimit që kanë ndikuar në bazën e tatueshme doganore.
Realizimi i tyre sipas muajve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

(Në 000/lekë)

Viti	2020			2021			2022		
	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %
Janar	4,357	3,569	82	4,348	4,405	101	4,984	3,594	72
Shkurt	3,981	2,724	68	5,406	6,408	119	4,444	4,447	100
Mars	2,670	4,742	178	6,560	6,961	106	10,829	10,831	100
Prill	4,381	4,173	95	6,655	8,208	123	7,354	7,354	100
Maj	5,521	6,703	121	7,054	5,727	81	9,133	9,129	100

Qershor	5,927	7,153	121	6,360	8,268	130	6,825	6,821	100
korrik	6,260	4,558	73	6,781	6,733	99	11,133	11,138	100
Gusht	5,712	4,488	79	6,401	10,577	165	8,866	9,064	102
Shtator	6,818	4,417	65	5,959	4,096	69	8,354	8,753	105
Tetor	5,493	4,391	80	6,168	6,711	109	8,421	11,035	131
Nëntor	5,300	5,975	113	6,329	5,343	84	8,619	12,417	144
Dhjetor	5,860	7,069	121	6,833	6,663	98	10,154	11,396	112
Totali	62,280	59,963	96	74,853	80,100	107	99,117	105,979	107
Viti	**2023**			**2024**			**2025**		
	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %
Janar	7,327	5,344	73	7,555	8,898	118	9,336	8,318	89
Shkurt	6,154	8,128	132	9,051	8,289	92	9,218	11,167	121
Mars	7,734	8,287	107	9,287	11,820	127	10,478	10,277	98
Prill	7,529	7,643	102	11,679	14,760	126	11,552	17,510	152
Maj	9,129	10,645	117	11,574	11,342	98	13,900	8,765	63
Qershor	8,344	10,761	129	12,574	12,362	98	12,768	9,708	76
korrik	9,991	9,362	94	13,751	15,418	112	14,138	13,117	93
Gusht	9,638	9,160	95	12,347	14,563	118	10,978	17,636	161
Shtator	9,560	8,809	92	13,840	10,582	76	12,178	12,357	101
Tetor	7,592	10,360	136	13,384	8,634	65	16,222	10,261	63
Nëntor	7,939	9,083	114	12,674	11,056	87	15,868	10,503	66
Dhjetor	9,073	10,394	115	13,548	15,238	112	17,212	12,629	73
Totali	100,011	107,977	108	141,265	142,963	101	153,849	142,247	92

Të dhënat: DDSh, Punoi:KLSH

- **Të ardhura nga Akciza:**

Të ardhurat nga "Akciza" për vitet 2020-2025 rezultojnë me realizim kundrejtë planit respektivisht në shifrat 108%, 100%, 110%, 125%, 109% dhe 109% kundrejt planit. Realizimi i tyre sipas muajve paraqitet në tabelën e mëposhtme, ku sipas të dhënave rezultojnë gjatë vitit disa muaj rezultojnë me mosrealizim por kjo nuk ka ndikuar në realizimin e planit vjetor të të ardhurave nga Akciza, mosrealizimi gjatë muajve ka ardhë si pasojë e kursit të këmbimit.

(Në 000/lekë)

Viti	**2020**			**2021**			**2022**		
	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %
Janar	1,845	10,652	577	9,243	24,143	261	16,753	6,921	41
Shkurt	10,362	11,621	112	25,937	17,433	67	8,118	8,234	101
Mars	11,389	8,027	70	23,522	12,891	55	18,327	18,379	100
Prill	11,697	12,514	107	19,445	12,061	62	9,172	9,265	101
Maj	14,102	12,558	89	17,564	22,759	130	22,187	22,196	100
Qershor	13,362	21,435	160	20,865	24,026	115	24,212	24,380	101
korrik	16,233	23,882	147	22,428	24,442	109	24,362	24,360	100
Gusht	16,451	17,666	107	23,746	30,694	129	27,632	26,727	97
Shtator	17,574	17,543	100	21,523	17,184	80	20,759	20,783	100
Tetor	17,717	16,158	91	22,444	20,506	91	19,622	16,670	85
Nëntor	18,109	12,545	69	21,063	15,273	73	18,518	50,618	273
Dhjetor	18,612	16,433	88	21,776	27,666	127	25,934	29,858	115
Totali	167,453	181,033	108	249,557	249,077	100	235,595	258,390	110
Viti	**2023**			**2024**			**2025**		
	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %
Janar	19,708	8,145	41	23,834	16,425	69	26,184	15,601	60
Shkurt	8,123	26,284	324	16,159	16,844	104	17,469	13,861	79
Mars	15,942	14,620	92	17,431	23,485	135	19,790	19,994	101
Prill	16,111	20,404	127	20,179	27,937	138	18,277	20,784	114
Maj	21,916	18,726	85	25,759	25,761	100	20,180	27,427	136
Qershor	22,597	25,812	114	27,285	37,080	136	24,209	38,113	157
korrik	23,646	32,036	135	30,762	36,840	120	29,301	32,019	109
Gusht	28,658	35,870	125	36,889	34,512	94	31,061	22,482	72
Shtator	23,505	33,527	143	28,807	25,397	88	25,002	30,314	121

Tetor	25,100	21,673	86	28,312	28,853	102	25,438	34,811	137
Nëntor	26,359	36,273	138	28,850	25,395	88	26,828	27,525	103
Dhjetor	28,106	51,661	184	30,530	43,241	142	28,834	36,777	128
Totali	259,771	325,031	125	314,799	341,770	109	292,574	319,710	109

Të dhënat: DDR, Punoi:KLSH

- **Të ardhura nga TVSH:**

Të ardhurat nga TVSH, paraqiten me mosrealizim për vitin 2020 në vlerën -38,035 mijë lekë në masën -1%, kundrejt planit, vitet 2021-2025 rezultojnë me realizim respektivisht në vlerën 3,420,127 mijë lekë ose realizim nmë masën 120%, 3,999,584 mijë lekë ose me realizim në masën 103%, 4,559,580 mijë lekë ose me realizim në masën 100%, 5,025,676 mijë lekë ose me realizim në masën 107% dhe 5,384,843 mijë lekë ose me realizim në masën 109% kundrejt planit. Realizimi i tyre sipas muajve paraqitet në tabelën e mëposhtme, ku sipas të dhënave rezultojnë gjatë vitit disa muaj rezultojnë me mosrealizim por kjo nuk ka ndikuar në realizimin e planit vjetor të të ardhurave nga TVSH-ja.

(Në 000/lekë)

Viti	**2020**			**2021**			**2022**		
	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %
Janar	173,794	148,658	86	159,521	136,991	86	207,742	219,620	106
Shkurt	109,073	204,111	187	165,707	254,834	154	260,989	261,045	100
Mars	155,982	189,654	122	245,673	266,591	109	352,963	352,908	100
Prill	222,686	221,748	100	263,907	285,568	108	372,199	372,209	100
Maj	228,921	221,641	97	234,653	306,251	131	429,528	429,512	100
Qershor	253,531	246,979	97	252,083	282,886	112	333,832	333,843	100
korrik	260,219	255,200	98	260,079	339,750	131	349,354	349,361	100
Gusht	266,071	230,249	87	239,100	353,309	148	306,294	319,501	104
Shtator	253,799	244,114	96	251,782	273,740	109	320,192	355,851	111
Tetor	264,861	282,719	107	260,505	308,282	118	331,252	346,792	105
Nëntor	304,865	247,006	81	261,705	296,634	113	322,149	299,341	93
Dhjetor	263,968	227,656	86	250,619	315,292	126	303,187	359,600	119
Totali	2,757,770	2,719,735	99	2,845,334	3,420,127	120	3,889,681	3,999,584	103
Viti	**2023**			**2024**			**2025**		
	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %
Janar	215,253	228,675	106	211,452	272,481	129	301,091	316,544	105
Shkurt	324,851	304,352	94	338,739	370,131	109	361,436	397,243	110
Mars	407,681	408,501	100	410,018	477,869	117	370,481	472,412	128
Prill	333,414	328,770	99	373,395	408,864	109	399,395	494,517	124
Maj	422,468	423,923	100	385,200	404,368	105	428,134	501,187	117
Qershor	419,299	413,458	99	418,981	458,989	110	475,013	476,289	100
korrik	415,777	408,321	98	523,005	522,363	100	471,068	513,968	109
Gusht	392,139	385,440	98	397,182	456,967	115	398,718	453,500	114
Shtator	400,068	390,799	98	426,719	413,766	97	413,398	476,771	115
Tetor	410,876	402,154	98	417,746	411,562	99	427,422	447,288	105
Nëntor	394,682	430,630	109	377,785	399,901	106	446,000	405,148	91
Dhjetor	421,444	434,557	103	425,025	428,414	101	443,017	429,974	97
Totali	4,557,951	4,559,580	100	4,705,248	5,025,676	107	4,935,171	5,384,843	109

Të dhënat: DDSh, Punoi:KLSH

Nga auditimi i kryer lidhur me procesin e ndjekur për planifikimin e të ardhurave doganore që pritet të gjenerohen, konstatohet se Dega Doganore Shkodër nuk përfshihet në këtë vendimmarrje, por plani sipas çdo muaji përcillet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, dhe është pikërisht ky autoritet që kryhen dhe ndjekjen e realizimit. Ky planifikim përcillet elektronikisht dhe pëson ndryshime të shpeshta edhe përgjatë muajit, të cilat ndjekin nivelin e

realizimit. Pra, Dega Doganore nuk disponon një plan fillestar vjetor sipas çdo muaji, apo një informacion për metodologjinë e ndjekur për planifikimin e të ardhurave doganore që ndiqet nga DPD. Për këtë arsye nuk mund të kryhej një krahasim mes planit fillestar dhe atij të ndryshuar, dhe për sa kohë plani mujor pëson ndryshime të shpeshta, mbetet një faktor kryesor në finalizimin të realizimit të të ardhurave doganore me mbi realizim apo me realizim pothuajse 100% të planit. Kontributi i DDK në planifikimin e tyre konsiston vetëm në paraqitjen e statistikave në nivel tepër sintetik dhe të pa shoqëruara me analiza të mirëfillta mbi faktorët që kanë ndikuar në realizim apo mosrealizim. Kjo në kundërshtim me Ligjin 102/2014, datë 31.07.2014 "*Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë*"; Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*", i ndryshuar.
Mbi sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar, Dega Doganore Shkodër, nuk janë paraqitur observacione, në trajtën e komenteve dhe/ ose shpjegimeve mbi Projekt Raportin e Auditimit.

2.2. Auditimi i borxhit doganor, gjendja dhe masat e marra për rikuperimin e tij për periudhën nën auditim.

Në zbatim të drejtimit të auditimit nr. 2, të programit të auditimit nr.15/1 prot., datë 15.01.2026 u shqyrtua dokumentacioni për Degen e Doganës Shkodër, si më poshtë:

Auditimi mbi menaxhimin e Borxhit Doganor (BD), u fokusua në drejtimet e mëposhtme:
Gjendja e detyrimeve të subjekteve debitor, krijimi i detyrimeve, gjendja në fillim dhe në fund, kontabilizimi i tyre.
Masat e marra për vjeljen dhe rikuperimin e borxhit doganor.
Rregullshmërinë e dosjeve të borxhit.
Mbi procedurat e ndjekura për mallrat e sekuestruara apo konfiskuara për periudhën nën auditim 01.01.2020-31.12.2025.
Për auditimin e BD, nga ana e grupit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Evidenca të BD, për gjithë periudhën Janar 2020 deri ne dhjetor 2025;
- Vendimet e ekzekutimit të BD, për periudhën 2020-2025;
- Vendimet dhe masat shtrënguese të ndërmarra nga DDSH për vjeljen e BD;
- Kontabilizimi i borxhit doganor, pasqyrat financiare, llogaria 468.

2. Audimi i borxhit doganor, gjendja e detyrimeve të subjekteve debitor, krijimi i detyrimeve, gjendja në fillim të auditimit 01.01.2020 deri në datën 31.12.2025. Masat e marra për rikuperimin e borxhit doganor për periudhën nën auditim.
- Në dosje nuk rezulton të jetë kryer kontroll fizik, për verfikimin e koeficentit sipas udhëzimit nr. 4, datë 28.03.2019 Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv. Kreu XIII pika 5.
- Nga të dhënat e Mbylljes së regjimit, ka rezultuar se nga OE, është dorëzuar sipas modelit nr. 8 "Dokumenti i mbylljes së autorizimit", të RPA nr. 4416/1, datë 01.10.2021, në DDSH me nr. 1573 prot., datë 14.10.2022, nënshkruar nga Kryetari i DDSH dhe doganier mbikëqyrës.
- Nga të dhënat e mbylljes së regjimit, ka rezultuar se ky regjim është mbyllur më datë 26.10.2023, referuar R-137316, brenda afatit të përcaktuar në autorizim.
- Sipas modelit nr. 8 "Mbyllja e regjimit" rezulton se pesha e mallrave IM5, në shumën 17,323 kg është e barabartë më peshën e mallrave të rieksportuara:

Hyrje në regjim më peshë	Dalje nga regjimi në peshë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
17,323	17,323	-	-	-	17,323

Hyrje në regjim në vlerë	Dalje nga regjimi në vlerë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
299,146	299,149	-	-	-	299,149

69. Subjekti “B ” shpk, me NUIS ....,mbajtës i RPA nr. 14348/1, datë 26.09.2022, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 26.09.2023.

- Mallrat që do të vendosen nën regjim “Tela te ndryshëm të izoluar ose jo, diode transistor për tu montuar, izolatorë, armaturë izoluese, rezistenca elektrike, vida, bulona e aksesore montimi, forma prej gome, etiketa, tuba, pipa prej plastike, tela bakri”.
- Sasia 5,000,000 copë
- Vlera 5,000,000 Euro;
- Produktet e përfunduara NK (8544)
- Koeficienti i shfrytëzimit = 1.

Dokumentat në dosje janë:

- Kopja e autorizimit RPA me nr. 14348/1, datë 26.09.2022.
- Deklarata mbi të dhënat për OE.
- Deklarata OE për koeficentin.
- Bilancet 3 mujore.

Nga auditimi i praktikës rezultoi se:

- Në dosje nuk rezulton të jëtë kryer kontroll fizik, për verfikimin e koeficentit sipas udhëzimit nr. 4, datë 28.03.2019 Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv. Kreu XIII pika 5.
- Nga të dhënat e Mbylljes së regjimit, ka rezultuar se nga OE, është dorëzuar sipas modelit nr. 8 “Dokumenti i mbylljes së autorizimit”, të RPA nr. 14348/1, datë 26.09.2022, në DDSH me nr. 169/2 prot., datë 22.01.2024, nënshkruar nga Kryetari i DDSH dhe doganier mbikëqyrës.
- Nga të dhënat e mbylljes së regjimit, ka rezultuar se ky regjim është mbyllur më datë 09.01.2024, referuar R-1408, brenda afatit të përcaktuar në autorizim.
- Sipas modelit nr. 8 “Mbyllja e regjimit” rezulton se pesha e mallrave IM5, në shumën 354,548 kg është e barabartë më peshën e mallrave të rieksportuara:

Hyrje në regjim më peshë	Dalje nga regjimi në peshë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
354,548	354,548	-	-	-	354,548

Hyrje në regjim në vlerë	Dalje nga regjimi në vlerë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
30,286	30,286	-	-	-	30,286

70. Subjekti “B” shpk, me NUIS ..... ,mbajtës i RPA nr. 24358/1, datë 25.09.2023, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 25.09.2024.

- Mallrat që do të vendosen nën regjim “Tela te ndryshëm të izoluar ose jo, diode transistor për tu montuar, izolatorë, armaturë izoluese, rezistenca elektrike, vida, bulona e aksesore montimi, forma prej gome, etiketa, tuba, pipa prej plastike, tela bakri”.
- Sasia 300,000 copë
- Vlera 4,500,000 Euro;
- Produktet e përfunduara NK (8544)
- Koeficienti i shfrytëzimit = 1.

Dokumentat në dosje janë:

- Kopja e autorizimit RPA me nr. 24358/1, datë 25.09.2023.

- Deklarata mbi të dhënat për OE.
- Deklarata OE për koeficentin.
- Bilancet 3 mujore.

Nga auditimi i praktikës rezultoi se:

- Në dosje nuk rezulton të jetë kryer kontroll fizik, për verfikimin e koeficentit sipas udhëzimit nr. 4, datë 28.03.2019 Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv. Kreu XIII pika 5.
- Nga të dhënat e Mbylljes së regjimit, ka rezultuar se nga OE, është dorëzuar sipas modelit nr. 8 "Dokumenti i mbylljes së autorizimit", të RPA nr. 24358/1, datë 25.09.2023, në DDSH me nr. 1940 prot., datë 30.07.2025, nënshkruar nga Kryetari i DDSH dhe doganier mbikëqyrës.
- Nga të dhënat e mbylljes së regjimit, ka rezultuar se ky regjim është mbyllur më datë 26.07.2025, referuar R-101705, brenda afatit të përcaktuar në autorizim.
- Sipas modelit nr. 8 "Mbyllja e regjimit" rezulton se pesha e mallrave IM5, në shumën 25,718 kg është e barabartë më peshën e mallrave të rieksportuara:

Hyrje në regjim më peshë	Dalje nga regjimi në peshë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
25,718	25,718	-	-	-	25,718

Hyrje në regjim në vlerë	Dalje nga regjimi në vlerë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
448,016	448,016	-	-	-	448,016

71. Subjekti "B" shpk, me NUIS .... ,mbajtës i RPA nr. 35103/1, datë 19.09.2024, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 19.09.2025.

- Mallrat që do të vendosen nën regjim "Tela te ndryshëm të izoluar ose jo, diode transistor për tu montuar, izolatorë, armaturë izoluese, rezistenca elektrike, vida, bulona e aksesore montimi, forma prej gome, etiketa, tuba, pipa prej plastike, tela bakri".
- Sasia 5,000,000 copë
- Vlera 4,500,000 Euro;
- Produktet e përfunduara NK (8544)
- Koeficienti i shfrytëzimit = 1.

Dokumentat në dosje janë:

- Kopja e autorizimit RPA me nr. 35103/1, datë 19.09.2024.
- Deklarata mbi të dhënat për OE.
- Deklarata OE për koeficentin.
- Bilancet 3 mujore.

Nga auditimi i praktikës rezultoi se:

- Në dosje nuk rezulton të jetë kryer kontroll fizik, për verfikimin e koeficentit sipas udhëzimit nr. 4, datë 28.03.2019 Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv. Kreu XIII pika 5.
- Autorizimi RPA nr. 35103/1, datë 19.09.2024 është aktualisht ne proces. Subjekti ka dorëzuar cdo tre muaj bilancet tre mujore:

Hyrje në regjim më peshë	Dalje nga regjimi në peshë	Gjëndja e mbetur

IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
45777	43244	-	-	-	2,533

Hyrje në regjim në vlerë	Dalje nga regjimi në vlerë				Gjëndja e mbetur
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
1,390,000	1,336,478	-	-	-	53,522

72. Subjekti "B." shpk, me NUIS ..... ,mbajtës i RPA nr. 44174/1, datë 18.09.2025, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 18.09.2026.

- Mallrat që do të vendosen nën regjim "Tela te ndryshëm të izoluar ose jo, diode transistor për tu montuar, izolatorë, armaturë izoluese, rezistenca elektrike, vida, bulona e aksesore montimi, forma prej gome, etiketa, tuba, pipa prej plastike, tela bakri".
- Sasia 5,000,000 copë
- Vlera 5,000,000 Euro;
- Produktet e përfunduara NK (8544)
- Koeficienti i shfrytëzimit = 1.

Dokumentat në dosje janë:

- Kopja e autorizimit RPA me nr. 44174/1, datë 18.09.2025.
- Deklarata mbi të dhënat për OE.
- Deklarata OE për koeficentin.
- Bilancet 3 mujore.

Nga auditimi i praktikës rezultoi se:

- Në dosje nuk rezulton të jëtë kryer kontroll fizik, për verfikimin e koeficentit sipas udhëzimit nr. 4, datë 28.03.2019 Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv. Kreu XIII pika 5.
- Autorizimi RPA nr. 44174/1, datë 18.09.2025 është aktualisht ne proces. Subjekti ka dorëzuar cdo tre muaj bilancet tre mujore:

Hyrje në regjim më peshë	Dalje nga regjimi në peshë				Gjendja e mbetur
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
62,773	45,985	-	-	-	16,788

Hyrje në regjim në vlerë	Dalje nga regjimi në vlerë				Gjendja e mbetur
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
1,282,150	1,074,195	-	-	-	207,955

73. Subjekti "I" shpk, me NUIS..... , mbajtës i RPA nr. 41242/1, datë 09.05.2025, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 09.05.2026.

- Mallrat që do të vendosen nën regjim "Lëndë druri e sharruar dhe elemente druri. ".
- Sasia 950 m3 dru i sharruar 200 m3 elemente druri;

- Vlera 279,000 Euro;
- Produktet e përfunduara NK (4401, 4407, 4417, 9401, 9403)
- Koeficienti i shfrytëzimit është i ndryshëm nga 1, zyra doganore mbikqyrëse të bëjë verifikimet gjatë procesit të përpunimit dhe sipas kartave teknologjike.

Nga auditimi i praktikës rezultoi se dokumentacioni në dosjen e subjektit për këtë rregjim është:

- Kopja e autorizimit RPA me nr. 41242/1, datë 09.05.2025.
- Deklarata mbi të dhënat për OE.
- Bilancet 3 mujore.
- Deklaratë mbi koeficentin e shfrytëzimit 0.88-1
- Kontroll fizik per koeficentit dhe proces verbali datë 03.06.2025 ku specifikohet koefiçenti K=89-98%
- Autorizimi është në proces
- Të dhënat nga regjimi janë si më poshtë vijon :

Hyrje në regjim më peshë	Dalje nga regjimi në peshë				Gjendje e mbetur
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM4 Zhdoganim 4051	
547,990	70,455		-		477,535

Hyrje në regjim në vlerë	Dalje nga regjimi në vlerë				Gjendje e mbetur
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM4 Zhdoganim 4051	
121,023	28,268	-	-	1	92,755

74. Subjekti “C 2025” shpk, me NUIS....., mbajtës i RPA nr. 38998/1, datë 24.02.2025 , periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 24.02.2026.

- Mallrat që do të vendosen nën regjim “Lëkurë, ngjyrues, aksesorë, materiale ndihmëse për prodhim veshje këmbësh ”.
- Sasia 600,000 palë;
- Vlera 8,000,000 Euro;
- Produktet e përfunduara NK (6403, 6406)
- Koeficienti i shfrytëzimit është i ndryshëm nga 1, zyra doganore mbikqyrëse të bëjë verifikimet gjatë procesit të përpunimit dhe sipas kartave teknologjike.

Nga auditimi i praktikës rezultoi se dokumentacioni në dosjen e subjektit për këtë rregjim është:

- Kopja e autorizimit RPA me nr. nr. 38998/1, datë 24.02.2025.
- Deklarata mbi të dhënat për OE.
- Bilancet 3 mujore.
- Deklaratë mbi koeficentin e shfrytëzimit 0.88-1
- Kontroll fizik për koeficentit dhe proces verbali datë 03.06.2025 ku specifikohet koefiçenti K=89-98%

- Autorizimi është akoma në proces.
- Dokumentacioni në lidhje me asgjësimet është pjesë e DAV Doganor dhe ndodhet në dosjen e subjektit.
- Të dhënat nga regjimi janë si më poshtë vijon :

Hyrje në regjim më peshë	Dalje nga regjimi në peshë				Gjendje e mbetur
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM4 Zhdoganim 4051	
2,189,470	797,097	176,770	-		1,215,603

Hyrje në regjim në vlerë	Dalje nga regjimi në vlerë				Gjendje e mbetur
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM4 Zhdoganim 4051	
314,962	169,475	-	-	-	145,487

75. Subjekti "C.Sh." shpk, me NUIS ..... , mbajtës i RPA nr. 2675/1, datë 21.07.2021, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 21.07.2022.

- Mallrat që do të vendosen nën regjim "Lëkurë, ngjyrues, aksesorë, materiale ndihmëse për prodhim veshje këmbësh ".
- Sasia 600,000 faqe këpucësh 400,000 veshje këmbësh;
- Vlera 7,500,000 Euro;
- Produktet e përfunduara NK (6401-6406, 4103-07, 4114, 4302, 5903, 4808, 8308, 4008, 9606)
- Koeficienti i shfrytëzimit është i ndryshëm nga 1, zyra doganore mbikqyrëse të bëjë verifikimet gjatë procesit të përpunimit dhe sipas kartave teknologjike.

Nga auditimi i praktikës rezultoi se dokumentacioni në dosjen e subjektit për këtë rregjim është:

- Kopja e autorizimit RPA me nr. nr. 1675/1, datë 21.07.2021.
- Deklarata mbi të dhënat për OE.
- Bilancet 3 mujore.
- Deklaratë mbi koeficentin e shfrytëzimit 0.88-1

Nga auditimi i praktikës rezultoi se:

- Në dosje nuk rezulton të jëtë kryer kontroll fizik, për verfikimin e koeficentit sipas udhëzimit nr. 4, datë 28.03.2019 Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv. Kreu XIII pika 5.
- Nga të dhënat e Mbylljes së regjimit, ka rezultuar se nga OE, është dorëzuar sipas modelit nr. 8 "Dokumenti i mbylljes së autorizimit", të RPA nr. nr. 1675/1, datë 21.07.2021, në DDSH me nr. 40 prot., datë 05.01.2023, nënshkruar nga Kryetari i DDSH dhe doganier mbikëqyrës.
- Nga të dhënat e mbylljes së regjimit, ka rezultuar se ky regjim është mbyllur më datë 23.12.2022, referuar R-4301, brenda afatit të përcaktuar në autorizim.

Sipas modelit nr. 8 "Mbyllja e regjimit" rezulton se pesha e mallrave IM5, në shumën 269,849.48 kg është e barabartë më peshën e mallrave të rieksportuara. Dokumentacioni në lidhje me asgjësimet është pjesë e DAV Doganor dhe ndodhet në dosjen e subjektit.

- Të dhënat nga regjimi janë si më poshtë vijon :

Hyrje në regjim më peshë	Dalje nga regjimi në peshë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9	IM4	

			(humbje-firo)	Zhdoganim 4051	
269,849.48	248,583.21	21,266.27	-	-	269,849.48

Hyrje në regjim në vlerë	Dalje nga regjimi në vlerë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM4 Zhdoganim 4051	
4,131,239.61	4,131,239.69	-	-	-	4,131,239.61

Nga auditimi konstatohet se sipas deklaratave me R-72411, datë 12.06.2022, subjekti ka importuar në kodin NK 7302, kod i cili rezulton i pa përfshirë në pikën 7 të autorizimit të sipërcituar. Nga ana e subjektit nuk ka paraqitur kërkesë për shtim kodi. Këto veprime janë jo në përputhje me kërkesat e nenit 250.1/a, 250.2 dhe 250.4 të KD. Referuar neneve të sipërcituara për shkeljen doganore të kryer, subjekti përveç detyrimeve doganore, për kodin tarifor që nuk është përfshirë në autorizim ku në rastin konkret, duhej të penalizohej me gjobë 20,000 lekë për çdo deklaratë, referuar nenit 251, pika 1 dhe nenin 256, pika 1, shkronja "b" të KD.
Efekti financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit është 20,000 lekë.

Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezuton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe nr. 4, datë 28.03.2019, "Për zbatimin praktik të RPA, ngarkohet me përgjegjësi: Doganieri i mbikëqyrjes së regjimit Z. R.M., Znj F.D. me detyrë specialist në sektorin e mbikqyrjes Doganore dhe znj. A.D. me detyrë Kryetar i Degës Doganore Shkodër.

76. Subjekti "C.Sh." shpk, me NUIS M**********C, mbajtës i RPA nr. 22484/1, datë 07.07.2023, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 07.07.2024.
- Mallrat që do të vendosen nën regjim "Lëkurë, ngjyrues, aksesorë, materiale ndihmëse për prodhim veshje këmbësh".
- Sasia 600,000 faqe këpucësh 300,000 veshje këmbësh;
- Vlera 8,000,000 Euro;
- Produktet e përfunduara NK (6401-06, 4103-07, 4114, 4008, 4302, 4808, 5903, 8308, 9606-07)
- Koeficienti i shfrytëzimit është i ndryshëm nga 1, zyra doganore mbikqyrëse të bëjë verifikimet gjatë procesit të përpunimit dhe sipas kartave teknologjike.

Nga auditimi i praktikës rezultoi se dokumentacioni në dosjen e subjektit për këtë rregjim është:
- Kopja e autorizimit RPA me nr. 22484/1, datë 07.07.2023.
- Deklarata mbi të dhënat për OE.
- Bilancet 3 mujore.
- Deklaratë mbi koeficentin e shfrytëzimit 0.88-1.

Nga auditimi i praktikës rezultoi se:
- Në dosje nuk rezulton të jetë kryer kontroll fizik, për verfikimin e koeficentit sipas udhëzimit nr. 4, datë 28.03.2019 Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv. Kreu XIII pika 5.
- Nga të dhënat e Mbylljes së regjimit, ka rezultuar se nga OE, është dorëzuar sipas modelit nr. 8 "Dokumenti i mbylljes së autorizimit", të RPA nr. 22484/1, datë 07.07.2023, në DDSH me nr. 2322 prot., datë 13.12.2024, nënshkruar nga Kryetari i DDSH dhe doganier mbikëqyrës.
- Nga të dhënat e mbylljes së regjimit, ka rezultuar se ky regjim është mbyllur më datë 06.12.2024, referuar R-3920, brenda afatit të përcaktuar në autorizim.

Sipas modelit nr. 8 “Mbyllja e regjimit” rezulton se pesha e mallrave IM5, në shumën 77,258 kg është e barabartë më peshën e mallrave të rieksportuara. Dokumentacioni në lidhje me asgjësimet është pjesë e DAV Doganore dhe ndodhet në dosjen e subjektit
Të dhënat nga regjimi janë si më poshtë vijon:

Hyrje në regjim më peshë	Dalje nga regjimi në peshë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM4 Zhdoganim 4051	
77,258	70,983	6,275	-	-	77,258

Hyrje në regjim në vlerë	Dalje nga regjimi në vlerë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM4 Zhdoganim 4051	
1,636,804	1,636,797	-	-	-	1,636,797

Nga auditimi konstatohet se sipas deklaratës me R-87853, datë 25.06.2024 subjekti ka eksportuar në kodin 5407 kod i cili rezulton i pa përfshirë në pikën 8 të autorizimit të sipërcituar, këto veprime janë jo në përputhje me kërkesat e nenit 250.1/a, 250.2 dhe 250.4 të KD. Referuar neneve të sipërcituara për shkeljen doganore të kryer, subjekti përveç detyrimeve doganore, për kodin tarifor që nuk është përfshirë në autorizim ku në rastin konkret, duhej të penalizohej me gjobë 20,000 lekë për çdo deklaratë, referuar nenit 251, pika 1 dhe nenin 256, pika 1, shkronja “b” të KD. ***Efekti financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit është 20,000 lekë***.

Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezuton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe nr. 4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të RPA, ngarkohet me përgjegjësi: Doganieri i mbikëqyrjes së regjimit Z. R.M., Z F.D. me detyrë specialist në sektorin e mbikqyrjes Doganore dhe znj. A.D. me detyrë Kryetar i Degës Doganore Shkodër.

77. Subjekti “C.Sh.” shpk, me NUIS M**********C, mbajtës i RPA nr. 33042/1, datë 02.07.2024 , periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 02.07.2025.
- Mallrat që do të vendosen nën regjim “Lëkurë, ngjyrues, aksesorë, materiale ndihmëse për prodhim veshje këmbësh ”.
- Sasia 250,000 faqe këpucësh 50,000 palë veshje këmbësh;
- Vlera 3,500,000 Euro;
- Produktet e përfunduara NK (6403, 6406, 4103-07, 4114, 4302, 4821, 5903, 8308, 4008, 9606-07)
- Koeficienti i shfrytëzimit është i ndryshëm nga 1, zyra doganore mbikqyrëse të bëjë verifikimet gjatë procesit të përpunimit dhe sipas kartave teknologjike.

Nga auditimi i praktikës rezultoi se dokumentacioni në dosjen e subjektit për këtë rregjim është:
- Kopja e autorizimit RPA me nr. 33042/1, datë 02.07.2024.
- Deklarata mbi të dhënat për OE.
- Bilancet 3 mujore.
- Deklaratë mbi koeficentin e shfrytëzimit 90%.

Nga auditimi i praktikës rezultoi se:
- Në dosje rezulton të jetë kryer kontroll fizik, për verfikimin e koeficentit sipas udhëzimit nr. 4, datë 28.03.2019 Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv. Kreu XIII pika 5.

- Nga të dhënat e Mbylljes së regjimit, ka rezultuar se nga OE, nuk është dorëzuar "Dokumenti i mbylljes së autorizimit", të RPA nr. 33042/1, datë 02.07.2024, nga ana e DDSH, doganierit mbikëqyrës nuk është mbajtur procesverbali për konstatimin e shkeljes.
- Nga të dhënat e mbylljes së regjimit, ka rezultuar se ky regjim është mbyllur më datë 19.02.2025, referuar R-21123.
- Sipas modelit nr. 8 "Mbyllja e regjimit" rezulton se pesha e mallrave IM5, në shumën 41,510 kg është e barabartë më peshën e mallrave të rieksportuara. Dokumentacioni në lidhje me asgjësimet është pjesë e DAV Doganor dhe ndodhet në dosjen e subjektit.

Të dhënat nga regjimi janë si më poshtë vijon:

Hyrje në regjim më peshë	Dalje nga regjimi në peshë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
41,510	31,915	1,652	-	7,943	41,510

Hyrje në regjim në vlerë	Dalje nga regjimi në vlerë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
886,791	727,286	-	-	159,505	886,791

Nga auditimi konstatohet se regjimi rezulton i mbyllur jashtë afatit kohor prej 30 ditësh për mbylljen e regjimit veprim ky, jo në përputhje me kërkesat e nenit 251/2/1 të Kodit Doganor "Mosrespektimi nga mbajtësi i regjimit të përpunimit aktiv të detyrimit për mbylljen e regjimit doganor brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 230", pasi regjimi duhej mbyllur 30 ditë pas dhënies së destinacionit të produkteve parësore kompensuese, pra jo më vonë se data. Nga autoriteti përgjegjës nuk është mbajtur procesverbal konstatimi referuar nenit 273.3 të KD. Nga mosveprimi referuar nenit 256, pika 1, shkronja "b"; nenit 273,pika 3,si dhe nenit 260, të KD ***efekti financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit është 20,000 lekë.***

Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezuton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe nr. 4, datë 28.03.2019, "Për zbatimin praktik të RPA, ngarkohet me përgjegjësi: Doganieri i mbikëqyrjes së regjimit Z. R.M., Z F.D. me detyrë specialist në sektorin e mbikqyrjes Doganore dhe znj. A.D. me detyrë Kryetar i Degës Doganore Shkodër.

78. Subjekti "E . D S" shpk, me NUIS ..... ,mbajtës i RPA nr. 42399/1, datë 26.06.2025, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 26.06.2026.

- Mallrat që do të vendosen nën regjim "Solucion pastrami , çarçafë, këllëfe jastëku, peshqir, mbulesa shtrati, perde, mbulesa jorgani".
- Sasia 100,000 copë;
- Vlera 2,000,000 Euro;
- Produktet e përfunduara NK (6302, 6303, 9404)
- Koeficienti i shfrytëzimit = 1.

Nga auditimi i praktikës rezultoi se dokumentacioni në dosjen e subjektit për këtë rregjim është:

- Kopja e autorizimit RPA me nr.42399/1, datë 26.06.2025
- Deklarata mbi të dhënat për OE.
- Bilancet 3 mujore.

- Autorizimi RPA nr. 42399/1, datë 26.06.2025, është aktualisht ne proces .Subjekti ka dorezuar cdo tre muaj bilancet tre mujore.
- Të dhënat per Hyrjet dhe Daljet në këtë regjim si me poshte vijon:

Hyrje në regjim më peshë	Dalje nga regjimi në peshë				Gjendje e mbetur
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM4 Zhdoganim 4051	
89,063	49,389	-	-		39,674

Hyrje në regjim në vlerë	Dalje nga regjimi në vlerë				Gjendje e mbetur
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM4 Zhdoganim 4051	
20,369	11,218	-	-	-	9,151

79. Subjekti "E . D S" shpk, me NUIS .... ,mbajtës i RPA nr. 28816/1, datë 29.01.2024, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 29.01.2025.

- Mallrat që do të vendosen nën regjim "Çarçafë, këllëfe jastëku,peshqir, mbulesa shtrati, perde, mbulesa jorgani.".
- Sasia 1.000.000 copë;
- Vlera 2.000.000 Euro:
- Produktet e përfunduara NK (6302, 6303, 9404)
- Koeficienti i shfrytëzimit = 1.

Nga auditimi i praktikës rezultoi se dokumentacioni në dosjen e subjektit për këtë rregjim është:

- Kopja e autorizimit RPA me nr. nr. 28816/1, datë 29.01.2024.
- Deklarata mbi të dhënat për OE.
- Bilancet 3 mujore.
- Subjekti ka dorezuar cdo tre muaj bilancet tre mujore.
- Shtesë afati rieksportimi datë deri me datë 28.07.2025 referuar aplikimit nr DPD-2025-00040890 datë 25.05.2025; Shtese kodi nr ref DPD-2025-00042828 Shkodër, më 11.07.2025
- Nga të dhënat e mbylljes së regjimit, ka rezultuar se ky regjim është mbyllur më datë 24.07.2025 nr protoklli 1877, referuar R-29067, brenda afatit të përcaktuar në autorizim, nënshkruar nga Kryetari i DDSH dhe doganier mbikëqyrë.
- Të dhënat per Hyrjet dhe Daljet në këtë regjim si me poshte vijon:

Hyrje në regjim më peshë	Dalje nga regjimi në peshë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM4 Zhdoganim 4051	
21,570	21,570	-	-		21,570

Hyrje në regjim në vlerë	Dalje nga regjimi në vlerë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM4 Zhdoganim 4051	
19,087	19,087	-	-	-	19,087

80. Subjekti "A. Sh" shpk, me NUIS ..... ,mbajtës i RPA nr. 31771/1, datë 15.01.2020, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 15.01.2021.

- Mallrat që do të vendosen nën regjim "Lëkurë e prere për faqe këpucësh, lëkurë, astar, matëriale ndihmëse dhe aksesorë për prodhim faqe këpucësh dhe veshje këmbe të përfunduara".
- Sasia 114,684 palë;
- Vlera 1,435,152 Euro:
- Produktet e përfunduara NK (6401-6406)
- Koeficienti i shfrytëzimit është i ndryshëm nga 1, zyra doganore mbikqyrëse të bëjë verifikimet gjatë procesit të përpunimit dhe sipas kartave teknologjike.
- Lëkurë = 20-23 %
- Materiale sintetike = 16-20 %
- Fill = 5-10 %
- Gamopiuma sfungjer = 10-14 %
- Zam = 10-15 %
- Lastik = 5-10 %

Nga auditimi i praktikës rezultoi se:

- Në dosje nuk rezulton të jetë kryer kontroll fizik, për verfikimin e koeficentit sipas udhëzimit nr. 4, datë 28.03.2019 Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv. Kreu XIII pika 5.
- Shkresa me datë 16.02.2022 miratim shtesë në Autorizimin nr. 31771/1, datë 15.01.2020, shtyrje afati rieksportimi, i cili do të bëhet 15.03.2022.
- Dokumentacioni në lidhje me asgjësimet është pjesë e DAV-it doganore dhe ndodhet në dosjen e subjektit.
- Nga të dhënat e Mbylljes së regjimit, ka rezultuar se nga OE, është dorëzuar sipas modelit nr. 8 "Dokumenti i mbylljes së autorizimit", të RPA nr. 31771/1, datë 15.01.2020, në DDSH me nr. 588/1 prot., datë 04.04.2022, nënshkruar nga Kryetari i DDSH dhe doganier mbikëqyrës.
- Nga të dhënat e mbylljes së regjimit, ka rezultuar se ky regjim është mbyllur më datë 04.04.2022, referuar R-40495, brenda afatit për mbylljen e regjimit.
- Sipas modelit nr. 8 "Mbyllja e regjimit" rezulton se pesha e mallrave IM5, në shumën 97,198 kg është e barabartë më peshën e mallrave të rieksportuara:

Hyrje në regjim më peshë	Dalje nga regjimi në peshë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
97,198	79602	1,065	-	16,531	97,198

Hyrje në regjim në vlerë	Dalje nga regjimi në vlerë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
795,053	592,404	-	-	202,668	795,034

81. Subjekti "A. Sh" shpk, me NUIS ..... ,mbajtës i RPA nr. 12320/1, datë 07.01.2021, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 07.01.2022.

- Mallrat që do të vendosen nën regjim "Lëkurë e prere për faqe këpucësh, lëkurë, astar, matëriale ndihmëse dhe aksesorë për prodhim faqe këpucësh dhe veshje këmbe të përfunduara".
- Sasia 400,000 palë;
- Vlera 4,000,000 Euro:
- Produktet e përfunduara NK (6401-6406)

- Koeficienti i shfrytëzimit është i ndryshëm nga 1, zyra doganore mbikqyrëse të bëjë verifikimet gjatë procesit të përpunimit dhe sipas kartave teknologjike.
- Lëkurë = 20-23 %
- Materiale sintetike = 16-20 %
- Fill = 5-10 %
- Gamopiuma sfungjer = 10-14 %
- Zam = 10-15 %
- Lastik = 5-10 %

Nga auditimi i praktikës rezultoi se:

- Në dosje nuk rezulton të jetë kryer kontroll fizik, për verfikimin e koeficentit sipas udhëzimit nr. 4, datë 28.03.2019 Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv. Kreu XIII pika 5.
- Nga të dhënat e Mbylljes së regjimit, ka rezultuar se nga OE, është dorëzuar sipas modelit nr. 8 "Dokumenti i mbylljes së autorizimit", të RPA nr12320/1, datë 07.01.2021, në DDSH me nr. 273 prot., datë 31.01.2023, nënshkruar nga Kryetari i DDSH dhe doganier mbikëqyrës.
- Dokumentacioni në lidhje me asgjësimet është pjesë e DAV-it doganore dhe ndodhet në dosjen e subjektit.
- Nga të dhënat e mbylljes së regjimit, ka rezultuar se ky regjim është mbyllur më datë 10.10.2022, referuar R-3379, jashtë afatit prej 30 ditësh për mbylljen e regjimit.
- Sipas modelit nr. 8 "Mbyllja e regjimit" rezulton se pesha e mallrave IM5, në shumën 134,302 kg është e barabartë më peshën e mallrave të rieksportuara:

Hyrje në regjim		Total hyrje	Dalje nga regjimi				Total dalje
IM5	Mallra shqiptare		EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
121,860	12,442	134,302	128,299	1806	-	4,197	134,302

Hyrje në regjim në vlerë	Dalje nga regjimi në vlerë				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
1,306,230	1,209,725	-	-	96,505	1,306,230

Nga auditimi konstatohet se regjimi rezulton i mbyllur jashtë afatit kohor prej 30 ditësh për mbylljen e regjimit veprim ky, jo në përputhje me kërkesat e nenit 251/2/1 të Kodit Doganor "Mosrespektimi nga mbajtësi i regjimit të përpunimit aktiv të detyrimit për mbylljen e regjimit doganor brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 23", pasi regjimi duhej mbyllur 30 ditë pas dhënies së destinacionit të produkteve parësore kompensuese, pra jo më vonë se data. Nga autoriteti përgjegjës nuk është mbajtur procesverbal konstatimi referuar nenit 273.3 të KD. Nga mosveprimi referuar nenit 256, pika 1, shkronja "b"; nenit 273,pika 3,si dhe nenit 260, të KD.
Nga auditimi konstatohet se sipas deklaratës me R-425, datë 15.02.2021, deklaratës me R-1553, datë 17.05.2021, subjekti ka importuar në kodin NK 6403, kod i cili rezulton i pa përfshirë në pikën 7 të autorizimit të sipërcituar.
Nga auditimi konstatohet se sipas deklaratës me R-1306, datë 26.04.2021, subjekti ka importuar në kodin NK 8207, kod i cili rezulton i pa përfshirë në pikën 7 të autorizimit të sipërcituar.
Nga auditimi konstatohet se sipas deklaratës me R-468, datë 12.02.2023 subjekti ka eksportuar në kodin 4806 kod i cili rezulton i pa përfshirë në pikën 8 të autorizimit të sipërcituar.
Këto veprime janë jo në përputhje me kërkesat e nenit 250.1/a, 250.2 dhe 250.4 të KD. Referuar neneve të sipërcituara për shkeljen doganore të kryer, subjekti përveç detyrimeve doganore, për

kodin tarifor që nuk është përfshirë në autorizim ku në rastin konkret, duhej të penalizohej me gjobë 20,000 lekë për çdo deklaratë, referuar nenit 251, pika 1 dhe nenin 256, pika 1, shkronja "b" të KD, ***efekti financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit është 100,000 lekë***.

Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezuton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe nr. 4, datë 28.03.2019, "Për zbatimin praktik të RPA, ngarkohet me përgjegjësi: Doganieri i mbikëqyrjes së regjimit Znj. M.N., Znj. F.D. me detyrë specialist në sektorin e mbikqyrjes Doganore dhe znj. A.D. me detyrë Kryetar i Degës Doganore Shkodër.

82. Subjekti "A. SH" shpk, me NUIS ..... , mbajtës i RPA nr. 7162/1, datë 07.01.2022, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 07.01.2023.
- Mallrat që do të vendosen nën regjim "Lëkurë, pëlhurë, astare, material ndihmëse dhe aksesorë për prodhim faqe këpucësh për veshje këmbësh të ndryshme dhe shtroje".
- Sasia 400,000 palë;
- Vlera 4,000,000 Euro;
- Produktet e përfunduara NK (6401-6406);
- Koeficienti i shfrytëzimit është i ndryshëm nga 1, zyra doganore mbikqyrëse të bëjë verifikimet gjatë procesit të përpunimit dhe sipas kartave teknologjike.

Koeficienti për materialet e tjera:
Artikulli (Kodi NK 4-shifror) 4107 Mbeturinë Lëkurë = 88-90 %
Artikulli (Kodi NK 4-shifror) 5903 mbeturinë materiali sindetik = 87-90
Artikulli (Kodi NK 4-shifror) 6406 mbeturina aksesorësh dhe materiale ndihmëse = 85-90.

- Kopja e autorizimit RPA me nr. 7162/1, datë 07.01.2022.
- Deklarata mbi të dhënat për OE.
- Bilancet 3 mujore.
- "Dokumenti i mbylljes së autorizimit sipas modelit nr. 8 "Mbyllja e regjimit".

Nga auditimi i praktikës rezultoi se :
- Në dosje nuk rezulton të jetë kryer kontroll fizik, për verfikimin e koeficentit sipas udhëzimit nr. 4, datë 28.03.2019 Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv. Kreu XIII pika 5.
- Nga të dhënat e Mbylljes së regjimit, ka rezultuar se nga OE, është dorëzuar sipas modelit nr. 8 "Dokumenti i mbylljes së autorizimit", të RPA nr.7162/1, datë 07.01.2022, në DDSH me nr. 384 prot., datë 19.02.2024, nënshkruar nga Kryetari i DDSH dhe doganier mbikëqyrës.
- Nga të dhënat e mbylljes së regjimit, ka rezultuar se ky regjim është mbyllur më datë 05.02.2024, referuar R-301, brenda afatit të përcaktuar në autorizim.
- Sipas modelit nr. 8 "Mbyllja e regjimit" rezulton se pesha e mallrave IM5, në shumën 119,076 kg është e barabartë më peshën e mallrave të rieksportuara:

Hyrje në regjim		Total hyrje	Dalje nga regjimi				Total dalje
IM5	Mallra shqiptare		EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	
113,303	5,773	119,076	116,281	2,796	-	-	119,076

Hyrje në regjim në vlerë Euro	Dalje nga regjimi në vlerë Euro				Total dalje
IM5	EX3	IM9 (asgjesuar)	IM9 (humbje-firo)	IM5 Transferuar në IM5	

1,142,381	1,142,381	-	-	-	1,142,381

Nga auditimi konstatohet se sipas deklaratës me R-93, datë 14.01.2022, R-304, datë 31.01.2022, subjekti ka importuar në kodin NK 5407, kod i cili rezulton i pa përfshirë në pikën 7 të autorizimit të sipërcituar.
Nga auditimi konstatohet se sipas deklaratës me R-12473, datë 05.02.2022, R-925, datë 17.03.2022, R-43415, datë 11.04.2022, subjekti ka importuar në kodin NK 5407, kod i cili rezulton i pa përfshirë në pikën 7 të autorizimit të sipërcituar.
Nga auditimi konstatohet se sipas deklaratës me R-587, datë 21.02.2022, R-720, datë 01.03.2022, R-44154, datë 12.04.2022, R-52915, datë 01.05.2022 dhe R-1888, datë 01.06.2022 subjekti ka eksportuar në kodin NK 4112, NK 4113, NK 4819, NK 5407, NK 5401 kode të cilat rezultojnë të pa përfshirë në pikën 8 të autorizimit të sipërcituar.
Këto veprime janë jo në përputhje me kërkesat e nenit 250.1/a, 250.2 dhe 250.4 të KD. Referuar neneve të sipërcituara për shkeljen doganore të kryer, subjekti përveç detyrimeve doganore, për kodin tarifor që nuk është përfshirë në autorizim ku në rastin konkret, duhej të penalizohej me gjobë 20,000 lekë për çdo deklaratë, referuar nenit 251, pika 1 dhe nenin 256, pika 1, shkronja "b" të KD, ***efekti financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit është 200,000 lekë***.

Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezuton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe nr. 4, datë 28.03.2019, "Për zbatimin praktik të RPA, ngarkohet me përgjegjësi: Doganieri i mbikëqyrjes së regjimit Znj. M.N., Znj. F.D. me detyrë specialist në sektorin e mbikqyrjes Doganore dhe znj. A.D. me detyrë Kryetar i Degës Doganore Shkodër.

Për sa është trajtuar për Projektraportin e auditimit, nga subjekti i audituar Dega Doganore Shkodër, është paraqitur observacion me shkresën nr. 28/29 prot., datë 11.06.2026, nr. 28/30 prot., datë 11.06.2026, protokolluar në KLSH me nr. 15/6 prot., datë 02.07.2026, ku janë shprehur shkurtimisht objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit: *Në Pikën 8 të autorizimit vendoset kodi NK të produkteve të përpunuara. (jo i lëndëve të para) kjo është arsyeja pse nuk ka shteshë autorizimi, për rastet kur kemi kthim të lëndëve të para.*
Nga DPD me shkresën me nr. 6031 prot., datë 11.03.2020, ka ardhur urdhëri nr.06, ku ndër të tjera urdhërohet pezullimi i të gjithë kontrolleve të planifikuara pranë ambienteve të operatoreve (periudhë e COVID-19)
Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Grupi i Auditimit pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të audituar, në lidhje më pretendimet e paraqitura në observacionet, sqaron se nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë nga ato të trajtuara në fazën e auditimit në terren, për pasojën nuk merren në konsideratë.

REGJIMI I LEJIMIT TË PËRKOHSHËM

Regjimi i lejimit të përkohshëm bën të mundur përdorimin në territorin doganor shqiptar, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit dhe pa iu nënshtruar masave të politikave tregtare, të mallrave jo shqiptare të destinuara për t'u rieksportuar, pa pësuar ndryshime, përveç zhvleftësimit normal për shkak të përdorimit të tyre. Autoritetet doganore përcaktojnë afatin brenda të cilit mallrat e importit duhet të rieksportohen ose t'u caktohet një destinacion i ri doganor. Ky afat duhet te zgjasë për aq kohë sa të arrihet qëllimi për të cilin është lëshuar autorizimi. Afati gjatë të cilit mallrat mund të qëndrojnë nën regjimin e lejimit të përkohshëm është 12 muaj, me një maksimum shtyrje deri në 10 vjet, me qëllim që të bëhet i

mundur përmbushja e qëllimit të autorizimit. Regjimi i lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimet e importit është një regjim ekonomik që mundëson lehtësimin dhe kryerjen e operacioneve të caktuara, nga subjektet Shqiptare duke përdorur mallrat jo shqiptarë me destinacion rieksportimin e tyre pas realizimit të qëllimit për të cilin ishin autorizuar. Përdorimi i regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimet e importit jepet për mallrat të cilat, ndërsa mbeten në pronësi të një personi të vendosur në një vend të huaj, nuk i plotësojnë te gjitha kushtet e parashikuara për dhënien e regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimet e importit. Afatet janë të përcaktuara në VKM nr. 651, datë 10.11.2017 "Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor". Baza ligjore: Ligji 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë", nenet 191 deri 202, 223 deri 226. VKM nr. 651, datë 10.11.2017 "Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor", nenet 533 deri 534, 649 deri 685.

Lidhur me mbikëqyrjen e RLP.

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se: Dega Doganore Shkodër funksionon si zyrë hyrëse dhe dalëse e mallrave, miraton Autorizime për Lejim të përkohshë me përjashtim të plotë. Për periudhën nën auditim sipas informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur, kjo degë doganore është mbikqyrëse e 57 autorizimeve te RLP–ve, të lëshuara nga DPD. Nga këto 40 autorizime janë të mbyllura dhe 17 jane akoma në proces. Për vitin 2020, janë dhënë 8 autorizime, nga të cilët 5 tashme janë mbyllur dhe 3 janë akoma në proces. Për vitin 2021 janë dhënë 14 autorizime, nga te cilët 12 tashme janë mbyllur dhe 2 janë akoma në proces. Për vitin 2022 janë dhënë 12 autorizime, nga të cilët 10 janë mbyllur dhe 2 janë akoma në proces. Për vitin 2023, janë dhënë 6 autorizime, nga të cilët 5 janë mbyllur dhe 1 është akoma në proces. Për vitin 2024, janë dhënë 5 autorizime, nga të cilët 3 tashme janë mbyllur dhe 2 janë akoma në proces. Për vitin 2025, janë dhënë 12 autorizime, nga të cilët 5 janë mbyllur dhe 7 janë akoma në proces. Për 17 autorizimet e dhena nga viti 2020 deri me 2025 dhe që janë akoma në proces, subjektet kanë marrë shtesë për afat rieksportimi.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur nga auditimi për procedurat e ndjekura për mbikëqyrjen e këtyre regjimeve konstatohet moskryerje të kontrolleve të regjimeve lidhur me identifikimin e mallrave të vendosura nën atë regjim, statusin e tyre doganor dhe lëvizjet e tyre.

Veprime në kundërshtim me Kodin Doganor, Neni 194 Regjistrimet.

Nga ana e grupit të auditimit u përzgjodhën për auditim RLP-të si më poshtë:

Emri i subjektit	Nr .	Viti
C	15593/1	16.11.2022
K fish	22531/1	11.07.2023
I Pro	12549/1	12.07.2022
K 12	10581/1	11.05.2022
E	125/1	19.01.2021
U	291/1	17.02.2020
U	7715	25.01.2022
M A	6492	08.12.2021
M A	27543	12.12.2023
Sh T	2514/1	15.12.2020
P M G	3311	13.08.2021
P M G	3976	16.09.2021
C.Sh.	16681	15.12.2022
C.Sh.	27805	30.12.2023
"Ro" shpk	16589	09.12.2022
"F G W" shpk	126/1	12.01.2020
"R. G" shpk	38319/1	31.01.2025
"P" shpk	32453	06.06.2024

1. Subjekti "K. F" shpk, me NUIS L**********I, mbajtës i RLP-së me nr.DPD-2023-00022531/1 datë 11.07.2023, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, deri më 11.07.2024. Kodet në pikën 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 3923, NK 4415, NK 7309. Autorizimi RLP-së është mbyllur me datë 15.06.2024 me R-20592, brenda afateve të përcaktuara në autorizim.
Subjekti ka realizuar të dhënat sipas tabelës së poshë shënuar:

Hyrje në RLP më peshë	Dalje nga RLP në peshë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
92,513	92,513	0

Hyrje në RLP më vlerë	Dalje nga RLP në vlerë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
74,218	74,218	0

Nga auditimi rezulton se sasia e importuar është 67,316 copë dhe janë të eksportuara 67,316 copë, në këtë rast nuk ka diferenca si në sasi, vlerë, peshë.

2. Subjekti "E" shpk, me NUIS K**********G, mbajtës i RLP-së me nr. 125/1 datë 19.01.2021, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 19.01.2022.
Kodet nr piken 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 4415. Autorizimi RLP-së është mbyllur me datë 25.09.2021 me R-24524 brenda afateve të përcaktuara në autorizim.
Subjekti ka realizuar të dhënat sipas tabelës së poshë shënuar:

Hyrje në RLP më peshë	Dalje nga RLP në peshë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
465	465	0

Hyrje në RLP më vlerë	Dalje nga RLP në vlerë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
212	212	0

Nga auditimi rezulton se sasia e importuar është 31 copë dhe janë të eksportuara 31 copë në këtë rast nuk ka diferenca si në sasi, vlerë, peshë.

3. Subjekti "I" shpk, me NUIS L**********T, mbajtës i RLP-së nr.DPD-2022-00012549/1, datë 12.07.2022, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, deri më 12.07.2023. Kodet në pikën 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 3926, NK 9611, NK 8208, NK 7117. Shtesë afati nr.ref. 22549, datë 10.07.2023 deri me datë 12.07.2024. Autorizimi RLP-së është mbyllur me datë 27.06.2024 me R-1970, brenda afateve të përcaktuara në autorizim.
Subjekti ka realizuar të dhënat sipas tabelës së poshë shënuar:

Hyrje në RLP më peshë	Dalje nga RLP në peshë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
128	128	0

Hyrje në RLP më vlerë	Dalje nga RLP në vlerë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	

5,440	5,440	0

Nga auditimi rezulton se sasia e importuar është 128 copë dhe janë të eksportuara 128 copë, në këtë rast nuk ka diferenca në sasi, vlerë, peshë.

4. Subjekti "C.Sh." shpk, me NUIS .... , mbajtës i RLP-së nr.DPD-2022-00016681/1, datë 14.12.2022, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, deri më 14.12.2023. Kodet në pikën 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 7326, NK 8207, NK 8208.
Subjekti ka realizuar të dhënat sipas tabelës së poshë shënuar:

Hyrje në RLP më peshë	Dalje nga RLP në peshë	IMP 4	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	IMP4	
1,799	2,389	40	-630

Hyrje në RLP më vlerë	Dalje nga RLP në vlerë	IMP 4	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	IMP4	
20,133	20,379	50	-295

Nga auditimi rezulton se sasia e importuar është 1799 kg dhe nga ana e subjektit janë eksportuar 2,389 kg dhe janë zhdoganuar 40 kg, në këtë rast rezulton se ka diferenca në sasi, vlerë, peshë. Këto veprime të subjektit për diferencën në sasi si dhe mbyllja jashtë afateve të përcaktuar në autorizim e RLP, përbëjnë shkelje doganore referuar nenit 250, 252/c dhe 257/1 gërma b të KD dhe për këtë rast duhet vendoset **penalitet sipas nenit 257/1 gërma b, 50,000 lekë**

Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezuton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor, për zbatimin praktik të RLP, ngarkohet me përgjegjësi: Doganieri i mbikëqyrjes së regjimit Z. R.M., Znj F.D. me detyrë specialist në sektorin e mbikqyrjes Doganore dhe znj. A.D. me detyrë Kryetar i Degës Doganore Shkodër.

5. Subjekti "U" shpk, me NUIS ..... , mbajtës i RLP nr. 291/1 prot.datë 17.02.2020, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 17.02.2021.
Subjekti ka shtese afati me shkresën nr. 854/1 prot., datë 16.02.2021, deri në datën 17.02.2022. Kodet në pikën 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 8480. Autorizimi RLP-së është mbyllur me datë 05.02.2022, me R-384, brenda afateve të përcaktuara në autorizim.
Subjekti ka realizuar të dhënat sipas tabelës së poshë shënuar:

Hyrje në RLP më peshë	Dalje nga RLP në peshë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
1,022	1,022	0

Hyrje në RLP më vlerë	Dalje nga RLP në vlerë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
5,899	5,899	0

Nga auditimi rezulton se sasia e importuar është 2 copë dhe janë të eksportuara 2 copë, në këtë rast nuk ka diferenca në sasi, vlerë, peshë.

6. Subjekti "U" shpk, me NUIS .... , mbajtës i RLP nr. DPD-2022-00007715 datë 25.01.2022, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 25.01.2023. Subjekti ka shtese afati me shkresën nr. 334/1 prot., datë 06.02.2023 dhe shkresën me nr.269/1 prot., datë 02.02.2024 deri në datën 25.01.2024.
Kodet në pikën 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 8480. Autorizimi RLP-së është mbyllur me datë 10.01.2025, me R-40, brenda afateve të përcaktuara në autorizim.
Subjekti ka realizuar të dhënat sipas tabelës së poshë shënuar:

Hyrje në RLP më peshë	Dalje nga RLP në peshë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
772	772	0

Hyrje në RLP më vlerë	Dalje nga RLP në vlerë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
13,063	13,063	0

Nga auditimi rezulton se sasia e importuar është 2 copë dhe janë të eksportuara 2 copë, në këtë rast nuk ka diferenca në sasi, vlerë, peshë.

7. Subjekti "M" shpk, me NUIS, mbajtës i RLP nr. DPD-2021-00006492 datë 08.12.2021, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 24 muaj, pra deri më 08.12.2023. Subjekti ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit me shkresën nr. 2002/1 prot., datë 14.12.2023, deri në datën 07.12.2024. Autorizimi RLP-së është mbyllur me datë 30.09.2024 me R-33280, brenda afateve të përcaktuara në autorizim.
Kodet në pikën 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 3923
Subjekti ka realizuar të dhënat sipas tabelës së poshë shënuar:

Hyrje në RLP më peshë	Dalje nga RLP në peshë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
126,513	126,513	0

Hyrje në RLP më vlerë	Dalje nga RLP në vlerë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
63,460	63,460	0

Nga auditimi rezulton se sasia e importuar është 65,386 copë dhe ka eksportuar 65,386 copë, në këtë rast nuk ka diferenca në sasi, vlerë, peshë.

8. Subjekti "M A" shpk, me NUIS ..... , mbajtës i RLP nr. DPD-2023-00027543 datë 13.12.2023, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 13.12.2024. Kodet në pikën 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 3923. Autorizimi RLP-së është mbyllur me datë 03.09.2024, me R-22926, brenda afateve të përcaktuara në autorizim.
Subjekti ka realizuar të dhënat sipas tabelës së poshë shënuar:

Hyrje në RLP më peshë	Dalje nga RLP në peshë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
117,321	117,321	0

Hyrje në RLP më vlerë	Dalje nga RLP në vlerë	Gjendja e mbetur

IM5	EX3	
53,786	53,786	0

Nga auditimi rezulton se sasia e importuar është 57,319 copë dhe ka eksportuar 57,319 copë, në këtë rast nuk ka diferenca në sasi, vlerë, peshë.

9. Subjekti "SH T" shpk, me NUIS .... , mbajtës i RLP nr. 2514/1 datë 15.12.2020, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 15.12.2021. Kodet nr piken 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 4415. Autorizimi RLP-së është mbyllur me datë 02.12.2021, me R-4048, brenda afateve të përcaktuara në autorizim
Subjekti ka realizuar të dhënat sipas tabelës së poshë shënuar:

Hyrje në RLP më peshë	Dalje nga RLP në peshë	IMP 4	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	IMP4	
4,768	3,072	1,696	0

Hyrje në RLP më vlerë	Dalje nga RLP në vlerë	IMP 4	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	IMP4	
2,235	1,440	795	0

Nga auditimi rezulton se sasia e importuar është 149 copë dhe ka eksportuar 96 copë për diferencën 53 rezulton se nga ana e subjektit janë zhdoganuar, në këtë rast nuk ka diferenca në sasi, vlerë, peshë.

10. Subjekti "P M G" shpk, me NID..... , mbajtës i RLP nr. DPD-2021-00003976 datë 16.09.2021, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 6 muaj, pra deri më 16.03.2022. Kodet në piken 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 4415. Nga ana e DDSH është mbajtur procesverbali i datës 25.10.2021 për verifikimin e kundravajtjes ku rezulton se sasia e importuar është 18 copë dhe subjekti ka eksportuar 25 copë me një diferencë prej 7 copësh më tepër. Për shkeljen e kostatuar ndaj subjektit është nxjerrë vendimi nr.111, datë 18.11.2021 i cili ka vendosur shpalljen debitor subjektin në vlerën 5,173 lekë, (gjobë 2-fishin e detyrimit doganor). Autorizimi RLP është mbyllur me datë.24.12.2021 me R-4369, brenda afateve të përcaktuara.
Subjekti ka realizuar të dhënat sipas tabelës së poshë shënuar:

Hyrje në RLP më peshë	Dalje nga RLP në peshë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
1,680	2,240	-560

Hyrje në RLP më vlerë	Dalje nga RLP në vlerë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
144	200	-56

Nga auditimi dosjes rezulton se sipas deklaratave import dhe eksport për këtë RLP, rezulton se subjekti ka diferenca në sasi, pasi ka eksportuar 7 copë më shumë trajtuar edhe në procesverbalin e konstatimit të shkeljes. Këto veprime të subjektit për diferencën në sasi, të përcaktuar në autorizim e RLP, përbëjnë shkelje doganore referuar nenit 250, 252/c dhe 257/1 gërma b të KD dhe për këtë rast duhet vendoset **penalitet sipas nenit 257/1 gërma b, 50,000 lekë**.
Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezuton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor, për zbatimin praktik të RLP, ngarkohet me

përgjegjësi: Doganieri i mbikëqyrjes së regjimit Z. Gj.Ç, Znj F.D. me detyrë specialist në sektorin e mbikqyrjes Doganore dhe znj. A.D. me detyrë Kryetar i Degës Doganore Shkodër.

11. Subjekti "F G W" shpk, me NUIS.... , mbajtës i RLP nr. 126/1 datë 12.01.2020, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, deri më 12.01.2021
Kodet nr piken 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 8208. Autorizimi RLP-së është mbyllur me datë 27.02.2021, me R-594, brenda afateve të përcaktuara në autorizim.
Subjekti ka realizuar të dhënat sipas tabelës së poshë shënuar:

Hyrje në RLP më peshë	Dalje nga RLP në peshë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
532	532	0

Hyrje në RLP më vlerë	Dalje nga RLP në vlerë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
14.717	14.717	0

Nga auditimi rezulton se sasia e importuar është 532 kg dhe ka eksportuar 532 kg, në këtë rast nuk ka diferenca në sasi, vlerë, peshë.

12. Subjekti "R" shpk, me NUIS ..... , mbajtës i RLP nr. DPD-2022-000016589 datë 09.12.2022, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 09.12.2022. Kodet nr piken 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 7326, NK 3923. Autorizimi RLP-së është mbyllur me datë 13.02.2023, me R-421, brenda afateve të përcaktuara në autorizim.
Subjekti ka realizuar të dhënat sipas tabelës së poshë shënuar:

Hyrje në RLP më peshë	Dalje nga RLP në peshë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
2,391.2	2,391.2	0

Hyrje në RLP më vlerë	Dalje nga RLP në vlerë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
740	740	0

Nga auditimi rezulton se sasia e importuar është 2,391 kg dhe ka eksportuar 2,391 kg, në këtë rast nuk ka diferenca në sasi, vlerë, peshë.

13. Subjekti "R. G" shpk, me NIPT ..... , mbajtës i RLP nr. DPD-2025-000038319/1 datë 31.01.2025, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 31.01.2026. Kodet nr pikën 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 7326.
Autorizimi RLP-së është mbyllur me datë 18.03.2025, me R-863, brenda afateve të përcaktuara në autorizim.
Subjekti ka realizuar të dhënat sipas tabelës së poshë shënuar:

Hyrje në RLP më peshë	Dalje nga RLP në peshë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
240	240	0

Hyrje në RLP më vlerë	Dalje nga RLP në vlerë	Gjendja e mbetur

IM5	EX3	
590	590	0

Nga auditimi rezulton se sasia e importuar është 240 kg dhe ka eksportuar 240 kg, në këtë rast nuk ka diferenca në sasi, vlerë, peshë.

14. Subjekti "P" shpk, me NUIS ..... , mbajtës i RLP nr. DPD-2024-00032453 datë 06.06.2024, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 06.06.2025. Kodet nr piken 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 3923. Autorizimi RLP-së është mbyllur me datë 06.06.2024, me R-32453, brenda afateve të përcaktuara në autorizim.
Subjekti ka realizuar të dhënat sipas tabelës së poshë shënuar:

Hyrje në RLP më peshë	Dalje nga RLP në peshë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
2,800	2,800	0

Hyrje në RLP më vlerë	Dalje nga RLP në vlerë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
2,340	2,340	0

Nga auditimi rezulton se sasia e importuar është 2,800 kg dhe ka eksportuar 2,800 kg, në këtë rast nuk ka diferenca në sasi, vlerë, peshë.

15. Subjekti "P M G" shpk, me .... , mbajtës i RLP nr. DPD-2021-00003311 datë 13.08.2021, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 6 muaj, pra deri më 13.02.2022. Kodet në pikën 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 7326. Autorizimi RLP është mbyllur me datë 21.10.2021 me R-3459, brenda afateve të përcaktuara.
Subjekti ka realizuar të dhënat sipas tabelës së poshë shënuar:

Hyrje në RLP më peshë	Dalje nga RLP në peshë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
1520	1600	-80

Hyrje në RLP më vlerë	Dalje nga RLP në vlerë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
140	176	-36

Nga auditimi dosjes rezulton se sasia e importuar është 1,520 kg dhe subjekti ka eksportuar 1,600 kg me një diferencë prej 80 kg më tepër. Sipas deklaratave import dhe eksport për këtë RLP, rezulton se subjekti ka diferenca në sasi, pasi ka eksportuar 80 kg më shumë. Këto veprime të subjektit për diferencën në sasi, të përcaktuar në autorizim e RLP, përbëjnë shkelje doganore referuar nenit 250, 252/c dhe 257/1 gërma b të KD dhe për këtë rast duhet vendoset **penalitet sipas nenit 257/1 gërma b, 50,000 lekë**.

Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezuton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor, për zbatimin praktik të RLP, ngarkohet me përgjegjësi: Doganieri i mbikëqyrjes së regjimit Z. Gj.Ç, Znj F.D. me detyrë specialist në sektorin e mbikqyrjes Doganore dhe znj. A.D. me detyrë Kryetar i Degës Doganore Shkodër.

16. Subjekti "C" shpk, me NUIS K**********R, mbajtës i RLP-së me nr. DPD-2022-00015593/1, datë 16.11.2022, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, deri më 16.11.2023. Kodet në pikën 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 3923, NK 4415, NK 7010, NK 7310. Subjekti ka përfituar dy shtesa afati me shkresën me nr. 217/1 prot., datë 26.11.2024 dhe shkresën me nr. 454/1 prot., datë 10.02.2025, zgjatur afati deri me 07.03.2025. Autorizimi RLP rezulton se është mbyllur me datë 30.10.2024 me R-36936, brenda afateve të përcaktuara në autorizim.
Subjekti ka realizuar të dhënat sipas tabelës së më poshtë:

Hyrje në RLP më peshë	Dalje nga RLP në peshë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
711,285	711,108	177

Hyrje në RLP më vlerë	Dalje nga RLP në vlerë	Gjendja e mbetur
IM5	EX3	
1,188,661	1,188,610	51

Nga auditimi dosjes rezulton se sasia e importuar është 1,273,961 copë dhe subjekti ka eksportuar 1,273,977 copë me një diferencë prej 16 copësh më tepër. Sipas deklaratave import dhe eksport për këtë RLP, rezulton se subjekti ka diferenca në sasi, pasi ka eksportuar 16 copë më shumë. Këto veprime të subjektit për diferencën në sasi, të përcaktuar në autorizim e RLP, përbëjnë shkelje doganore referuar nenit 250, 252/c dhe 257/1 gërma b të KD dhe për këtë rast duhet vendoset **penalitet sipas nenit 257/1 gërma b, 50,000 lekë**.

Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezuton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor, për zbatimin praktik të RLP, ngarkohet me përgjegjësi: Doganieri i mbikëqyrjes së regjimit Znj. A.D., Znj F.D. me detyrë specialist në sektorin e mbikqyrjes Doganore dhe znj. A.D. me detyrë Kryetar i Degës Doganore Shkodër.

17. Subjekti "K 12" shpk, me NUIS ..... , mbajtës i RLP nr.DPD-2022-00010581/1 datë 11.05.2022, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 11.05.2023. Kodet në pikën 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 8208. Nga auditimi dosjes rezulton se subjekti nuk ka realizuar asnjë import apo eksport me këtë numër RLP-je.
18. Subjekti "C.Sh. " shpk, me NUIS ..... , mbajtës i RLP nr. DPD-2023-00027805/1 datë 28.12.2023, periudha e vlefshmërisë së autorizimit 12 muaj, pra deri më 28.12.2024. Kodet nr piken 7 të autorizimit "Mallrat që do vendosen nën regjimin doganor janë: NK 3926, NK 9611, NK 8208, NK 7326, NK, 4810. Nga auditimi dosjes rezulton se subjekti nuk ka realizuar asnjë import apo eksport me këtë numër RLP-je.

2.5. Auditimi i procedurave të ndjekura mbi vendimet administrative, të nxjerra nga autoriteti doganor, për periudhën nën auditim.

Në zbatim të pikës 5 (pesë) "*Mbi procedurat e ndjekura mbi vendimet administrative, të nxjerra nga autoriteti doganor, për periudhën nën auditim*", të programit të auditimit nr. 15/1, datë 15.01.2026, u shqyrtua dokumentacioni/informacioni si më poshtë:
Vendimet administrative, të nxjerra nga autoriteti doganor, Dega e Doganës Shkodër, për vitet 2020, 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025.

Nga informacioni i paraqitur, nga Dega Doganore Shkodër, për periudhën e audituar, janë nxjerrë në total 433 vendime, përkatësisht:

- Në vitin 2020 nga Dega Doganore Shkodër janë nxjerrë në total 130 vendime;
- Në vitin 2021 nga Dega Doganore Shkodër janë nxjerrë në total 121 vendime;
- Në vitin 2022 nga Dega Doganore Shkodër janë nxjerrë në total 60 vendime;
- Në vitin 2023 nga Dega Doganore Shkodër janë nxjerrë në total 47 vendime;
- Në vitin 2024 nga Dega Doganore Shkodër janë nxjerrë në total 56 vendime;
- Në vitin 2025 nga Dega Doganore Shkodër janë nxjerrë në total 19 vendime.

Grupi i Auditimit ka përqendruar punën audituese në procedurat doganore të ndjekura në lidhje me vendimet administrative, të nxjerra nga Dega Doganore Shkodër, kryesisht mbi ato vendime të cilat kanë vlerë të lartë detyrimi dhe/ose gjobe si dhe duke e kombinuar vlerësimin e riskut edhe me përzgjedhje statistikore apo rastësore.

Kriteret mbi të cilat është audituar përputhshmëria e veprimeve administrative së njësisë janë:

-Ligji nr. 102 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i RSh", i ndryshuar;

-Ligji nr. 61, datë 24.05.2012 "Për Akcizat në RSh", i ndryshuar;

-VKM nr. 651, datë 10.11.2017 "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor të RSh", i ndryshuar;

-VKM nr. 612, datë 05.09.2012 "Për dispozitat zbatuese të ligjit "Për Akcizat...", i ndryshuar;

-Ligji nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i RSH", i ndryshuar;

-Urdhëri nr. 146, datë 07.05.2018 i MFE "Për miratimin e Rregullores së Brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave" dhe të Rregullores së brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin e Degëve Doganore";

-Urdhëri nr. 05, datë 12.01.2024 i DPD "Për miratimin e Manualit udhëzues "Mbi zbatimin e dispozitave për shkeljet në fushën doganore dhe të akcizës në Republikën e Shqipërisë".

Në mënyrë të përgjithshme, nga grupi i auditimit, janë konstatuar:

Së pari, mangësi në ndjekjen e procedurave të verifikimit të shkeljeve doganore dhe mosdokumentim i plotë i praktikës së shkeljes doganore. Mosplotësim korrekt i procesverbaleve të verifikimit/konstatimit të shkeljeve doganore, dokumentimit të njoftimit të tyre (nuk janë vendosur nenet për përcaktimin e kundërvajtjeve administrative të kryera, nenet për sanksionet e vendosura apo nuk është dokumentuar njoftimi i shkelësit), veprime në kundërshtim me nenet 273, 274 dhe 276 të Kodit Doganor sipas të cilave:

Neni 273 Procedura e verifikimit

1. Shkeljet doganore verifikohen dhe dënohen, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi dhe legjislacionin në fuqi.

2. Për qëllime të këtij kreu, "autoritete doganore kompetente" do të thotë autoritetet doganore që ushtrojnë mbikëqyrje dhe kontrolle në zonën ku është kryer dhe verifikuar shkelja apo në zonën ku ajo është kompetente në një territor të caktuar.

3. Për të gjitha shkeljet e dispozitave të këtij Kodi dhe akteve nënligjore, nga ana e strukturave doganore që kanë konstatuar shkeljen mbahet një procesverbal me shkrim, i cili duhet të nënshkruhet nga punonjësit doganorë që kryejnë verifikimin e kontrollin, si dhe shkelësi, kur shkelja është evidentuar në prani të tij.

4. Në rastet kur shkelja nuk është konstatuar në prani të shkelësit, procesverbali i nënshkruar nga punonjësit doganorë të strukturave kontrolluese, që ushtruan verifikimin dhe kontrollin, i njoftohet shkelësit nga kjo strukturë brenda 5 ditëve kalendarike. Në procesverbal përcaktohet edhe e drejta e shkelësit për të paraqitur pretendimet e tij me shkrim, brenda 10 ditëve kalendarike nga e nesërmja e marrjes së njoftimit, pranë strukturës përkatëse.

5. Strukturat kontrolluese, pas shqyrtimit të pretendimeve, u dërgojnë autoriteteve doganore kompetente procesverbalin përfundimtar së bashku me pretendimet e shkelësit.

Neni 274 Forma e procesverbalit të verifikimit e të sekuestrimit

1. Procesverbali i verifikimit duhet të përmbajë:

a) vendin, datën dhe kohën kur verifikohet shkelja;
b) emrat e personave që nënshkruajnë dhe autoritetin/strukturën që përfaqësojnë;
c) të dhëna identifikuese të shkelësit/shkelësve;
ç) llojin e shkeljes së kryer; d) mënyrën me të cilën është kryer shkelja;
dh) identifikimin e mjetit/mjeteve të transportit;
e) treguesit që lidhen me sasinë, llojin, vlerën dhe origjinën e mallrave që janë objekt i shkeljes;
ë) shumën e detyrimeve të importit ose eksportit që duhen paguar;
f) nenet e shkelura, nenet, në bazë të të cilave përcaktohen sanksionet, si dhe sanksionet e parashikuara për çdo shkelje;
g) nënshkrimin e punonjësve të doganës të strukturave kontrolluese dhe, kur është i pranishëm, nënshkrimin e shkelësit. Kur shkelësi nuk pranon të nënshkruajë, në procesverbal shënohet se atij i është lexuar kërkesa për të nënshkruar dhe se i është dorëzuar një kopje.

Neni 276 Marrja e vendimit dhe njoftimi

1. Autoritetet doganore kompetente, për shkeljen e konstatuar, përgatitin dosjen e plotë, në lidhje me shkeljen, dhe marrin vendimin përkatës.

Së dyti, klasifikim i gabuar i kundërvajtjeve administrative, në procesverbalet për verifikimin e shkeljeve doganore si dhe vendimet përkatëse. Konstatohen në raste kur nga kontrolli fizik kanë rezultuar mallra më tepër se deklarimi veprime në kundërshtim me nenet 251 deri 255 Kundërvajtjet administrative dhe nenet 256 deri 261 sanksionet për kundërvajtjet e Kodit Doganor.

Konkretisht, nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

- **Për vitin 2020**, nga 21 (njëzet e një) vendimet e audituara me përzgjedhje, në bazë risku, konkretisht vendimet nr. 10, 18, 19, 21, 23, 30, 38, 40, 44, 50, 60, 62, 70, 71, 80, 90, 100, 110, 120, 129 dhe 130, me përjashtim të vendimeve të cilat kanë rezultuar si të marra në zbatim të kritereve përkatëse, konstatohet që:

1-Nga auditimi i vendimit nr. 10, datë 06.02.2020, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore me nr. 240 prot, datë 05.02.2020, hartuar nga doganierët e Zyrës Doganore Hani i Hotit, lidhur me konstatimet e shkeljeve administrative doganore të bërë nga deklaruesit z. N.I. , përfaqësues i agjencisë doganore "S-A" SHPK.
Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Subjekti "N" ShPK, me NIPT.... , nëpërmjet deklaruesit z. "N. I", përfaqësues i agjencisë doganore "S-D" ShPK ka depozituar në sistem, deklaratën Imp 4 - R 2238 datë 04.02.2020 dhe ka deklaruar artikullin "*artikulli 1 - Kërpurdhë e konservuar në kanace; artikulli 2 - kërpurdhë e konservuar në kova plastike*". Deklarimi i mallit është konform deklarimit të subjektit importues, përshkrimi i ambalazhit për artikullin e 2-të, në kutinë 31 të DAV-it është vendosur nga deklaruesi 31 "lidhje". Bazuar në pikën 5, të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 08, datë 30.12.2013 "*Mbi Zbatimin në praktikë të taksës së ambalazhit të plastikës dhe qelqit*", kodi i paketimit që duhej deklaruar nga importuesi duhet të ishte "71", kod i cili përdoret në rastin e importeve të mallrave të cilat janë të ambalazhuara me ambalazh plastik (dhe përbën të paktën 51% te masës se përgjithshme të ambalazhit) dhe nuk ndodhen në paleta.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, në zbatimin e germës "a", të pikës 1, të nenit 250, pikën 1, të nenit 251 dhe germën b, të pikës 1, të nenit 256, të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, ka vendosur: "*Për subjektit z. Ndicim Ibraj, përfaqësues i agjencisë doganore "S-A" SHPK. me kod J046, që operon pranë zyrën doganore Hani i Hotit, të zbatohen sanksionet në shumën 20.000 (njëzet mijë) lekë*".

Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:

a) Proces verbali i konstatimit nuk është nënshkruar nga shkelësi si dhe nuk është dokumentuar njoftimi i këtij të fundit;

b) Në vendimin nr. 10, datë 06.02.2020, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 256 KD) parashikon një sanksion në masën nga 20 000 lekë deri në 50 000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, autoriteti vendimmarrës, në arsyetimin e vendimit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Z. E.Sh., me detyrë, ish-kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;

2-Nga auditimi i vendimit nr. 70, datë 13.10.2020, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore me nr. 2048 prot, datë 06.10.2020, hartuar nga doganierja e regjimeve dhe përgjegjësja e Zyrës së Regjimeve Shkodër, lidhur me konstatimet e shkeljeve administrative doganore doganore të shoqërisë "C E" SHPK.

Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:

Shoqëria "C E" SHPK me NIPT ..... , gjatë vitit 2020 e në vijim, ka punuar nën "Regjimin e Përpunimit Aktiv", me autorizimin nr. 10655/1, datë 06.05.2020 lëshuar nga DPD. Në kundërshtim me autorizimin e miratuar, subjekti ka importuar artikuj me kodet e klasifikimit tarifor të nomenklaturës së kombinuar 6204, 6205, 6206, 6217 dhe ka sjellë copa të prera për prodhimin e konfeksioneve të ndryshme. Copa të cilat në import i ka deklaruar me kodin e produktit të gatshëm (kod të cilin nuk e ka në pikën 7 të autorizimit).

Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, në zbatim të nenit 252 dhe 257 pika 1 germa "b", të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, ndër të tjera, ka vendosur: "*Për subjektin "C E" SHPK me NIPT L**********J të paguajë penalitet në shumën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë*".

Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:

a) Në vendimin nr. 70, datë 13.10.2020, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 257 KD) parashikon një sanksion në masën nga 50 000 lekë deri në 500 000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, autoriteti vendimmarrës, në arsyetimin e vendimit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim, mosveprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Z. E.Sh., me detyrë, ish-kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;

2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;

3-Nga auditimi i vendimit nr. 50, datë 10.08.2020, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore me nr. 1604 prot., datë 05.08.2020, hartuar nga doganieri i kontrollit fizik pranë Zyrës Doganore Hani i Hotit, lidhur me konstatimet e shkeljeve të bërë nga "B. Sis për Çati" SHPK.

Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:

Me deklaratën doganore IM4, R 3948 datë 24.02.2020, janë deklaruar mallrat "Tjegulla betoni për çati 3360 copë", me kod tarifor 68101900, me vlerë 225.256 euro, së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur. Nga procesverbali i konstatimit të shkeljes rezulton të jetë kryer kontroll fizik nga doganieri i kontrollit fizik, dhe ka rezultuar gabim në deklarimin e peshës së mallit por që nuk ndikon në pagesën e detyrimeve doganore, pasi zhdoganimi i këtij malli bëhet me copë.

Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, në zbatim të nenit 251 dhe germën b, të pikës 1, të nenit 256, të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i*

Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të shoqërisë "B. Sis për Çati" SHPK me NIPT ... , aplikimin e sanksioneve me gjobë në shumën 20.000 (njëzetmijë) lekë*".

Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:

a) Proces verbali i konstatimit nuk është nënshkruar nga shkelësi si dhe nuk është dokumentuar njoftimi i këtij të fundit;

b) Në vendimin nr. 50, datë 10.08.2020, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 256 KD) parashikon një sanksion në masën nga 20 000 lekë deri në 50 000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, autoriteti vendimmarrës, në arsyetimin e vendimit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Z. D. K, me detyrë, p. turni zyra doganore Hani i Hotit, në cilësinë e konstatuesit;

2) Z. E.Sh., me detyrë, ish-kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;

3) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;

4-Nga auditimi i vendimit nr. 30, datë 11.05.2020, mbi shqyrtimin e procesverbalit nr. 579/1 prot, datë 09.04.2020, hartuar nga Kontrolli pas Zhdoganimit pranë Degës Doganore Shkodër, lidhur me rivlerësimin e deklaratave të P.F.

Nga vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se, nga dokumentacioni i paraqitur nuk justifikohet vlera e transaktuar.

Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, në zbatim të nenit 70, të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, VKM-së nr. 651, datë 10.11.2017 "*Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor të RSh*", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të Drejtorit të Përgjithshm të Doganave, ndër të tjera, ka vendosur: "*Detyrimi shtesë që duhet paguar referuar procesverbalit nr. 579/1 prot, datë 09.04.2020 është në vlerën 695,894 lekë*".

Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:

a) Procesverbali nr. 579/1 prot, datë 09.04.2020, referuar të cilit është marrë vendimi nr. 30, datë 11.05.2020, nuk administrohet apo nuk është pjesë e dosjes (praktikës), mosveprim në kundërshtim me pikën 1 të nenit 276 të *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, i cili përcakton se: "*Autoritetet doganore kompetente, për shkeljen e konstatuar, përgatitin dosjen e plotë, në lidhje me shkeljen, dhe marrin vendimin përkatës*".

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Z. E.Sh., me detyrë, ish-kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;

2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e administruesit të dok.;

Konkretisht, nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

- **<u>Për vitin 2021</u>**, nga 22 (njëzet e dy) vendimet e audituara me përzgjedhje, në bazë risku, konkretisht vendimet nr. 10, 11, 12, 20, 30, 40, 45, 50, 52, 60, 64, 70, 78, 80, 86, 87, 90, 95, 100, 106, 110 dhe 120, me përjashtim të vendimeve të cilat kanë rezultuar si të marra në zbatim të kritereve përkatëse, konstatohet që:

1-Nga auditimi i vendimit nr. 106, datë 28.10.2021, mbi shqyrtimin e procesverbalit me nr. 2493 datë 11.10.2021, hartuar nga doganierja mbikëqyrëse e autorizimit nr.10947/1 datë 25.08.2020.

Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:

Subjekti "N.C." SHPK, me NIPT .... ka punuar me Autorizimin e RPA-së nr. 10947/1 datë 25.08.2020, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Nga verifikimet e bëra nga doganierja mbikëqyrëse, vërehet se subjekti "N.C." SHPK, gjatë punës nën këtë autorizim ka kryer disa import/eksporte, ku sasisë së mallit të importuar i ka dhënë një destinacion doganor në sasi e në peshë por vlera e rieksportuar është 270 euro më tepër se ajo e importuar. Në analizim dhe shyrtim të të gjithë situatës së krijuar, u mbajt procesverbali, për të cilën subjekti ka marrë dijeni me datë 15.10.2021 dhe nuk ka paraqitur observacion.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, në zbatim të gërmës "i", të nenit 251, gërmës "b", pikës 1, të nenit 256, gërmës "c", të nenit 252, gërmës "b", të nenit 257 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të subjektit "N.C." SHPK, për shkeljet e konstatuara nën autorizimin e RPA-së nr. 10947/1, datë 25.08.2020 si vijon: • Për mos paraqitjen e dokumentit të mbylljes së regjimit të RPA-së 10947/1, datë 25.08.2020, në kundërshtim me pikën (i), të nenit 251 dhe aplikimin e sanksioneve bazuar në germën (b), pika 1, të nenit 256 të Kodit Doganor, në shumën 20.000 (njëzet mijë) lekë; • Për mos dhënien destinacion doganor të mallrave nën RPA, në kundërshtim me germën (c), të nenit 252 dhe aplikimin e sanksioneve bazuar në germën (b) të nenit 257 të Kodit Doganor në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë...*".
Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:
a) Në vendimin nr. 106, datë 28.10.2021, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 256 KD) parashikon një sanksion në masën nga 20 000 lekë deri në 50 000 lekë dhe (germa "b", pika 1, neni 257 KD) parashikon një sanksion në masën nga 50 000 lekë deri në 500 000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, autoriteti vendimmarrës, në arsyetimin e vendimit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".
Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:
1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;
2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;
2-Nga auditimi i vendimit nr. 120, datë 31.12.2021, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjes me nr. 2986 prot., datë 30.12.2021, mbajtur nga Zyra Doganore Hani i Hotit (z. F.N, P/Turni, z. J.L, Doganier dhe z. E.K, Doganier).
Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Nga sistemi TIMS, rezulton se Kamioni i markës "S", me targë PG*****/PG****B ka hyrë në territorin shqiptar, nga pika kufitare Hani i Hotit me datën 25.12.2021, ora 16:11 dhe deri në momentin e mbajtjes së procesverbalit të sipërcituar (data 27.12.2021, ora 06:00) nuk është paraqitur pranë autoriteteve doganore në terminal, për të njoftuar arsyet e mosparaqitjes. Veprim ky i klasifikuar si kundërvajtje administrative e parashikuar në nenin 251, pika 1 dhe 2/e, *"Kundërvajtje me përgjegjësi objektive".*
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, në zbatim të nenit 126, pika 1, nenit 251, pika 1 dhe pika 2, germa "e", të nenit 259, pika 1, gërma "a", të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të shtetasit Z. S, me numër personal identifikimi 9********* dhe penalizimin me gjobë në shumën 20.000 (njëzetmijë) lekë...*".
Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:
a) Në vendimin nr. 120, datë 31.12.2021, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur parashikon një sanksion në masën nga 20 000 lekë deri në 50 000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, autoriteti vendimmarrës, në arsyetimin e vendimit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi*

i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar".

b) Edhe pse vendimi nr. 120 është marrë në datën 31.12.2021 mbi procesverbalin nr. 2986 prot., datë 30.12.2021, rezulton se ky i fundit (procesverbali) është mbajtur në datën 27.12.2021 dhe protokollimi i tij është kryer pas 3 ditëve. Kjo situatë ka sjellë marrjen e një vendimi në tejkalim të afateve të përcaktuara për rastin konkret, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 276 të KD, sipas të cilit: "*Vendimi i autoriteteve doganore kompetente për pagimin e detyrimeve të importit ose eksportit dhe/ose të sanksioneve përkatëse, të përcaktuara në këtë Kod, merret në rastet e flagrancës/urgjencës, brenda 24 orëve nga momenti i mbajtjes të procesverbalit të verifikimit të shkeljes dhe i njoftohet shkelësit brenda 24 orëve nga marrja e vendimit*".

c) Gjithashtu, në mospërputhje me dispozitën e cituar në pikën "c", nuk është dokumentuar njoftimi i procesverbalit dhe vendimit të autoritetit vendimmarrës.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;

2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;

3) Z. F.N., P/Turni, z. J.L., Doganier dhe z. E.K., Doganier, zyra doganore Hani i Hotit, në cilësinë e punonjësve konstatues;

3-Nga auditimi i vendimit nr. 110, datë 10.11.2021, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjes me nr. 2697 prot., datë 10.11.2021.

Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:

Shtetasi Z.M, përfaqësuar agjencia doganore "F" Agency, me shkresën e datës 02.11.2021, lënda "Kërkesë për pajisje me kodin 4053 Import për konsum pas RLP", (protokolluar me tonën me nr.2650 prot., datë 02.11.2021) ka kërkuar që të bëhet e mundur hapja e Regjimit Import për konsum pas RLP (4053) mjetit DAIMLER AG G 320 CDI, V. Prodhimit 2007, me targa CTAU**** dhe numër shasie ËDB4633411X169879, si dhe bashkëngjitur kësaj kërkese ka paraqitur për autoritetin doganor dhe dokumentacionin e nevojshëm si Leje qarkullimi, Akt shitje, Vertetim TIMS, ID e blerësit.

Makina e sipërshënuar, sipas të dhënave nga sistemi TIMS rezulton të ketë hyrë në territorin shqiptar me datë 24.08.2021 nga shtetasi N.T me numër personal identifikimi 9********* nga pika kufitare e Hanit të Hotit. Gjatë kësaj periudhe, makina i është shitur një shtetasi shqiptar, gjë e cila bie ndesh me kushtet e këtij rregjimi.

Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, në zbatim të gërmës "b", pikës 1, të nenit 257 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të shtetasit Zef Marashi, dhe penalizimin me gjobë në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë...*".

Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:

a) Në vendimin nr. 110, datë 10.11.2021, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 257 KD) parashikon një sanksion në masën nga 50 000 lekë deri në 500 000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, autoriteti vendimmarrës, në arsyetimin e vendimit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;

2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;

4-Nga auditimi i vendimit nr. 70, datë 09.07.2021, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjes me nr. 2042 prot., datë 09.07.2021.

Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:

Autobusi i përdorur i markës "Evobuz Setra S431", me numër shasie ËKK4100000310xxxx, me targë targa 0*****L ka hyrë dhe ka qëndruar në Republikën e Shqipërisë përtej afatit të lejuar. Më datën 02.07.2021, subjektit "B. T. ShPK", me numër NIPT-ti ... , është paraqitur në Zyrën Doganore Kufitare Hani i Hotit për të kryer veprimet e zhdoganimit të mjetit. Nga përllogaritja e afateve të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë rezulton se automjeti ka thyer afatin e regjimit të lejimit të përkohshëm.

Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se gjen të drejtë zbatim e gërmës "b", të pikës 1, të nenit 259 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të subjektit "B. T." ShPK, dhe penalizimin me gjobë në shumën 20.000 (njëzet mijë) lekë...*".

Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:

a) Në vendimin nr. 70, datë 09.07.2021, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 259 KD) parashikon një sanksion në masën nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, autoriteti vendimmarrës, në arsyetimin e vendimit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".

b) Proces verbali i konstatimit dhe vendimi përkatës, janë marrë si pasojë e një keqklasifikimi apo keqvlerësimi i fakteve dhe rrethanave. Konkretisht, mosrespektimi i afateve kohore të përcaktuara të një regjimi doganor parashikohet nga neni 252 KD. Në këto kushte, sanksioni në lidhje me situatën duhet të merrej duke u mbështetur në nenin 257.1/b dhe jo 259.1/b të KD. Si rezultat i keqklasifikimit, rezulton shmangie e detyrimeve doganore.

Minimalisht, për sa më sipër, vlera **30,000 lekë** përbën të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit, si diferenca e sanksioneve minimale të përcaktuara në dispozitat përkatëse (neni 257.1/b përcakton penalitetin nga 50,000 lekë deri në 500,000 lekë, ndërsa neni 259.1/b përcakton penalitetin nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë).

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;

2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;

3) Z. N.G., P/Turni, z. J.L., Doganier, në cilësinë e punonjësve konstatues;

5-Nga auditimi i vendimit nr. 10, datë 08.02.2021, mbi shqyrtimin e procesverbalit të verifikimit dhe sekuestrimit të mbajtur më datë 06.02.2021 protokolluar me nr. 251 prot., datë 08.02.2021 dhe procesverbalit për verifikimin e kontrabandës sipas aneksit 2, datë 06.02.2021 protokolluar me nr. 252 prot., datë 08.02.2021, të mbajtur nga doganierët e Zyrës Doganore Shkodër, në bashkëpunim me grupin e AK, lidhur me konstatimet e shkeljeve doganore të shtetasit I.D. , me numër personal identifikimi ..... , me adresë vendbanimi në Tiranë.

Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:

Në deklaratën tranzit 21ALAL21000000001683 datë 04.02.2021, nisur nga Italia për në Shqipëri, nëpërmjet doganës Vlorë, nga doganieri i praktikës doganore ishte lënë shënim që të verifikohej malli në doganën e destinacionit, pasi kishte rezultuar me diferencë peshe rreth 3 ton më shumë. Si rrjedhim, nga grupi i doganierëve të kontrollit fizik është konstatuar diferencë peshe e cila u evidentua dhe u saktësua në Doganën Shkodër, në bashkëpunim me sektorin e Monitorimit dhe grupin e AK. Pesha e deklaruar në tranzit është 29219 kg, ndërsa e shënuar, me nr. fletë peshe 0672811 është 32380 kg. Doganierët e kontrollit fizik, gjatë kontrollit të hollësishëm fizik të ngarkesës së mjetit me targa A*****T/A*****4, të importuar nga Italia, nga subjekti "A.G." me Nipt ....., verifikuan sasinë e mallit që ishte i vendosur në 2 paleta me mall të padeklaruar, me peshë 340 kg secila, njëra me pjesë ashensori dhe paleta tjetër me

materiale reklame, zarfe PPL, çanta letre për verë dhe kuti kartoni. Sa më sipër, si pasojë e mosllogaritjes së peshës së artikujve të 2 paletave ka sjellë këtë ndryshim në peshë. Pas konstatimit, sipas llogaritjeve të bëra nga DVQ pranë DPD-së, artikulli "Pjesë për ashensorë 340 kg, vlerësuar me 1.9 euro/kg, me kod tarifor 8431 31 00 i është shmangur detyrimit doganor në shumën 15,970 lekë ndërsa artikulli "Çanta prej letre 340 kg, vlerësuar me 1.5 euro/kg, me kod tarifor 4819 30 00 i është shmangur detyrimit doganor në shumën 12,608 lekë.

Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se gjen të drejtë zbatim e nenit 265 pika 1, nenit 266, pika 2 dhe nenit 268, pika 2 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*1-Shpalljen debitor të shtetasit "I.D.", për shkeljen e konstatuar dhe aplikimin e sanksioneve bazuar në pikën 2, të nenit 268 të Kodit Doganor, penalizimin me gjobë 3-fish i detyrimit doganor 85,734 lekë, detyrim doganor 28,578 lekë..., 2-Sekuestrimin e mallrave të padeklaruar sipas procesverbalit deri sa të depozitohet një garanci ose të paguhet shuma e sanksioneve dhe detyrimeve përkatëse...*".

Në lidhje me situatën e sipërcituar, rezulton se për mallin e padeklaruar përgjegjësia është marrë nga vetë transportuesi, i cili ka paraqitur kërkesë për zgjidhjen administrative të kontrabandës. Në këto kushte, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se gjen të drejtë zbatim e nenit 272 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe duke qenë se plotësohen njëkohësisht të gjitha kushtet e kërkuara, ndër të tjera, ka vendosur: "*Zgjidhjen administrative të vendimit nr. 10, datë 08.02.2021 (nr. 252/1 prot., datë 08.02.2021) dhe anullimin e menjëhershëm të sekuestrimit të mallrave të padeklaruar*".

Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:

a) Edhe pse autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër ka vendosur për zgjidhjen administrative të kontrabandës, nuk rezulton që dosja (praktika) t'i jetë dërguar organit të prokurorisë. Një shkresë e tillë nuk administrohet apo nuk është pjesë e dosjes (praktikës), mosveprim në kundërshtim me pikën 1 të nenit 276 të *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, i cili përcakton se: "*Autoritetet doganore kompetente, për shkeljen e konstatuar, përgatitin dosjen e plotë, në lidhje me shkeljen, dhe marrin vendimin përkatës*". Gjithashtu, mosdërgimi i praktikës pranë organit të prokurorisë është mosveprim në kundërshtim me pikën 2 të nenit 277 të *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, i cili përcakton se: "*Në rastet kur zbatohet neni 272, dosjes së sipërpërmendur i bashkëngjitet vendimi i autoriteteve për zgjidhjen administrative të çështjes, e cila i dërgohet menjëherë organit të prokurorisë*".

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;

6-Nga auditimi i vendimit nr. 11, datë 08.02.2021, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kontrabandës, sipas aneksit 2 datë 08.02.2021 protokolluar me nr. 253 prot., datë 08.02.2021 të mbajtur nga doganierët e Zyrës Doganore Shkodër, në bashkëpunim me grupin e AK, lidhur me konstatimet e shkeljeve doganore të subjektit "A. Group", me NIPT L********F, me administrator z. A.D.

Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:

Në deklaratën tranzit 21ALAL21000000001683 datë 04.02.2021, nga dogana Vlorë, doganierët e kontrollit fizik pranë Degës së Doganës Shkodër, gjatë kontrollit të hollësishëm fizik të ngarkesës së mjetit me targa AAxxxMT/ADRxxx, evidentuan diferencë peshë e cila u saktësua në Doganën Shkodër. Pesha e deklaruar në tranzit është 29219 kg, ndërsa e shënuar, me nr. fletë peshe 0672811 është 32380 kg (por si dokumet nuk është as i skanuar dhe as i dorëzuar në dokumentet e ardhura në Doganën Shkodër).

Nga agjencia doganore në Vlorë nuk është bashkëngjitur asnjë dokument i skanuar, dokumente të cilat subjekti i disponon të plota. Gjatë kontrollit të deklaratave doganore, në R 323 u konstatua

një gabim në deklarim, e cila konstatohet dhe në faturën që ka lidhje me Kafen L. e cila është deklaruar në 205 koli, por me lidhje katërshe, në paketa 250 g, gjë të cilën edhe subjekti e konfirmon në mënyrë verbale që porosia dhe çmimi për këtë sasi është 205 x 4 pako/ 250 g x 1.03 euro/paketa ose 4.12 euro/kg.
Doganierët e kontrollit fizik pranë Degës së Doganës Shkodër, në bashkëpunim me grupin e AK, verifikuan sasinë e mallit që ishte i vendosur në koli me nga 5 lidhje x 4 paketa me nga 250 g secila, në total 1025 kg duke mos deklaruar 820 kg Kafe L.
Si rrjedhim, si pasojë e mosllogaritjes së peshës së artikullit Kafe "L" ka sjellë këtë ndryshim në peshë. Pas konstatimit, sipas llogaritjeve të bëra nga DVQ pranë DPD-së, artikulli kafe e pjekur dhe e bluar "L" 820 kg, vlerësuar sipas të dhënave të disponueshme 4.8 euro kg me kod tarifor 0901 22 00 është shmangur detyrimit doganor në 214,730 lekë.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se gjen të drejtë zbatim e nenit 268, pika 2 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të subjektit "A. Group", për shkeljen e konstatuar dhe aplikimin e sanksioneve bazuar në pikën 2, të nenit 268 të Kodit Doganor, penalizimin me gjobë 3-fish i detyrimit doganor 644,190 lekë, detyrim doganor 214,730 lekë...*".
Në lidhje me situatën e sipërcituar, rezulton se subjekti "A.G." ka paraqitur kërkesë për zgjidhjen administrative të kontrabandës. Në këto kushte, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se gjen të drejtë zbatim e nenit 272 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe duke qenë se plotësohen njëkohësisht të gjitha kushtet e kërkuara, ndër të tjera, me shkresën "vendim" nr. 253/3 prot., datë 08.02.2021, ka vendosur: "*Zgjidhjen administrative të vendimit nr. 11, datë 08.02.2021 (nr. 253/1 prot., datë 08.02.2021) dhe anullimin e menjëhershëm të sekuestrimit të mallrave të padeklaruar*".
Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:
a) Autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër nuk rezulton të ketë marrë (formalizuar) një vendim për sekuestrimin e përkohshëm të mallit objekt kontrabande apo mjetit të transportit. Nga ana tjetër, edhe pse në mungesë të një vendimi për sekuestro, në dispozitivin e "vendimit" nr. 253/3 prot., datë 08.02.2021 "*Për zgjidhjen administrative të kontrabandës*" citon "...anullimin e menjëhershëm të sekuestrimit të mallrave të padeklaruar". Në rastin konkret, mungesa e një vendimi për sekuestrimin e përkohshëm të mallit objekt kontrabande është mosveprim në kundërshtim me pikën 1 të nenit 268 të *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, i cili përcakton se: "*Autoritetet doganore vendosin sekuestro të përkohshme për mallrat që janë objekt i kontrabandës, përfshirë edhe mallrat që nuk tatohen*".
b) Edhe pse autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër ka vendosur për zgjidhjen administrative të kontrabandës, nuk rezulton që dosja (praktika) t'i jetë dërguar organit të prokurorisë. Një shkresë e tillë nuk administrohet apo nuk është pjesë e dosjes (praktikës), mosveprim në kundërshtim me pikën 1 të nenit 276 të *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, i cili përcakton se: "*Autoritetet doganore kompetente, për shkeljen e konstatuar, përgatitin dosjen e plotë, në lidhje me shkeljen, dhe marrin vendimin përkatës*". Gjithashtu, mosdërgimi i praktikës pranë organit të prokurorisë është mosveprim në kundërshtim me pikën 2 të nenit 277 të *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, i cili përcakton se: "*Në rastet kur zbatohet neni 272, dosjes së sipërpërmendur i bashkëngjitet vendimi i autoriteteve për zgjidhjen administrative të çështjes, e cila i dërgohet menjëherë organit të prokurorisë*".
Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:
1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;
7-Nga auditimi i vendimit nr. 12, datë 08.02.2021, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kontrabandës, sipas aneksit 1 datë 08.02.2021 protokolluar me nr. 254 prot., datë

08.02.2021 të mbajtur nga doganierët e Zyrës Doganore Shkodër, në bashkëpunim me grupin e AK, lidhur me konstatimet e shkeljeve doganore të subjektit "A. Group", me NIPT ....., me administrator z. A.D.
Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Në deklaratën tranzit 21 ALAL21000000001683 datë 04.02.2021, nga dogana Vlorë, doganierët e kontrollit fizik pranë Degës së Doganës Shkodër, gjatë kontrollit fizik të ngarkesës së mjetit me targa AAxxxMT/ADRxxx, evidentuan diferencë peshe, e cila u saktësua në Doganën Shkodër. Pesha e deklaruar në tranzit është 29219 kg, ndërsa e shënuar, me nr. fletë peshe 0672811 është 32380 kg. Gjatë kontrollit të hollësishëm të dokumentacionit u pa mungesa totale në tranzit e një fature të kafes me peshë 1065.648 kg Bruto, 1005.648 kg Neto, e cila ishte e deklaruar në deklaratën e eksportit italiane por agjencia doganore e Vlorës nuk e ka pasqyruar në tranzitin e sipërcituar, e cila rezulton të jetë e dorëzuar nga subjekti dhe e deklaruar në R 317 datë 05.02.2021 në Degën e Doganën Shkodër nga ana e tij.
Si pasojë e mosllogaritjes së peshës së artikullit Kafe e bluar në kapsulë ka sjellë këtë ndryshim në peshë, pas konstatimit me kontrollin e plotë fizik. Sipas llogaritjeve të bëra nga DVQ pranë DPD-së, artikulli kafe e bluar në kapsulë 1000 kg, vlerësuar sipas të dhënave të disponueshme 4.8 euro kg me kod tarifor 0901 22 00 dhe 0.10/euro cp për kapsulat, çmimi i akcizës për kafenë 60 lekë/kg, i është shmangur detyrimit doganor në total 262,735 lekë.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e nenit 253 dhe nenit 258, pika 1, gërma a, të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të subjektit "A. Group", për shkeljen e konstatuar dhe aplikimin e sanksioneve bazuar në gërmën a, pikën 1, të nenit 258, të Kodit Doganor, në shumën 788,205 lekë...*".
Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:
a) Edhe pse subjekti "A.G." ka paraqitur kërkesë për zgjidhjen administrative, Autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër nuk rezulton të ketë marrë (formalizuar) një vendim për trajtimin e rastit, sekuestrimin e përkohshëm të mallit apo mjetit objekt kontrabande, në mosveprim dhe kundërshtim me pikën 1, të nenit 268 të *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, i cili përcakton se: "*Autoritetet doganore vendosin sekuestro të përkohshme për mallrat që janë objekt i kontrabandës, përfshirë edhe mallrat që nuk tatohen*".
Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:
1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;

Për sa trajtuar në vendimin nr. 11 dhe nr. 12 datë 08.02.2021, pas dërdimit të projekt raportit të auditimit, nga subjekti i audituar (z. V.D), nëpërmjet shkresës (nr. 28/31 prot., datë 22.06.2026) administruar në KLSH me nr. 15/6 prot., datë 02.07.2026, është paraqitur observacioni dhe janë shprehur objeksionet, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:
Pretendimi i subjektit: *Theksojmë se detyrimi doganor i munguar në masën 214,730 lekë është paguar direkt me deklaratën doganore me Nr. R317 datë 05.02.2021, konkretisht në artikullin Nr. 5 (kafe e pjekur e bluar 820 kg), pra nuk kemi të bëjmë me të ardhura të munguara në dëm të buxhetit të shtetit.*
Sasia prej 1005.648 kg neto kafeje e deklaruar në dokumentin e eksportit, por jo në deklaratën e tranzitit. Kjo sasi është pasqyruar në DAV 317. Sasia prej 820 kg kafeje e padeklaruar e evidentuar nga Dega Doganore si artikull shtesë. Kjo sasi është pasqyruar në DAV323, ku është shtuar artikulli 5.
Në lidhje me sa më sipër bashkëlidhet kopje dokumentacioni: DAV 317, DAV 323, Vendim nr, 11 dhe nr. 12, 5 (pesë) copë mandat pagesa, fletë shpjeguese dhe kopje e llogarisë rrjedhëse.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observacionin e paraqitur, pas rivlerësimit të situatës, duke shqyrtuar të gjitha kopjet e dokumentacionit bashkëlidhur observacionit, vlerësojmë se, pretendimi i subjektit është i drejtë dhe i bazuar.

Si përfundim, pretendimi merret në konsideratë duke u reflektuar edhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

- **<u>Për vitin 2022</u>**, nga 20 (njëzet) vendimet e audituara me përzgjedhje, në bazë risku, konkretisht vendimet nr. 1, 3, 7, 9, 12, 14, 16, 19, 23, 28, 29, 30, 34, 39, 46, 49, 53, 54, 57 dhe 58, me përjashtim të vendimeve të cilat kanë rezultuar si të marra në zbatim të kritereve përkatëse, konstatohet që:

1-Nga auditimi i vendimit nr. 19, datë 28.02.2022, mbi shqyrtimin e procesverbalit të kontrollit pas zhdoganimit/Aposterior me Nr. 246 Prot., datë 08.02.2022.
Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Personi Fizik "A.H." me NIPT ..... , ka depozituar pranë Zyrës Doganore Shkodër (AL010000), deklaratën IMP 4 4086 datë 04.12.2021, malli i deklaruar "shumë", kodi tarifor 1905 (vetëm për artikullin 9 "Biskota Crakers"), vendi origjinës IT, me peshë totale 18888.9 kg dhe vlerë totale të faturës 35743.18 euro, në kushtet e lëvrimit EXË/IT.
Nga ana e Degës Doganore Shkodër me shkresën Nr. 2836 Prot., datë 04.12.2021 është dërguar mostra për analizim pranë laboratorit Doganor Tiranë. Pas analizimit të mostrës në laborator, me shkresën Nr. 22255/1 Prot., datë 19.01.2022 janë dërguar fletë analizat e mostrës, ku subjekti ka deklaruar artikullin "Biskota Crakers" me kodin tarifor 19059040, sipas NKM-së.
Si rrjedhim, klasifikimi tarifor i artikullit, sipas DLD-së, rezulton të jetë 19059045 "Biskota (të kripura)" sipas NKM-së, i ndryshëm në 4/shifrorin e dytë në krahasim me atë deklaruar, sipas NKM-së për vitin 2021.
Sa më sipër, subjekti është njoftuar me shkresën nr. 2836/2 prot., datë 25.01.2022 në lidhje me përgjigjet e analizave laboratorike, për të cilat ka marrë dijeni me datë 27.01.2022 dhe nuk ka paraqitur ankimim mbrenda afatave kohore për mosdakortësinë e tyre.
Kodifikimi gabim nga ana e subjektit nuk sjell shmangie nga detyrimet doganore, por përbën parregullsi në deklarim të produktit.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e nenit 250 pika 1, gërma "a", nenit 251 pika 1, nenit 256, pika 1, gërma b, të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të Personit Fizik "A.H", me NIPT K********P, për shkeljen e konstatuar dhe aplikimin e sanksioneve në shumën 20.000 lekë (njëzet mijë) lekë...*".
Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:
a) Në vendimin nr. 19, datë 28.02.2022, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 256 KD) parashikon një sanksion në masën nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, në arsyetimin e vendimit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".
Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:
1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;
2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;
2-Nga auditimi i vendimit nr. 49, datë 10.10.2022, mbi shqyrtimin e procesverbalit, për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore, nr. 1122 prot., datë 13.07.2022, për të cilin ka marrë njoftim me datë 30.09.2022, të mbajtur nga doganierja e regjimeve dhe përgjegjësja e Zyrës së Regjimeve Shkodër.
Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Shoqëria "U.I." ShPK, me NIPT .... , gjatë vitit 2022 e në vijim, ka punuar nën "Regjimin e Përpunimit Aktiv" me autorizimin nr. 8385/1, datë 18.02.2022 lëshuar nga DPD.
Në kundërshtim me autorizimin, subjekti ka eksportuar artikuj me praktikat doganore për të cilat nuk lejohet në autorizim. Konkretisht ishin zbatuar të gjitha pikat e autorizimit përveç pikës 8

ku në eksport ishte përdorur Kodi 8431 i cili ishte i lejuar në pikën 7 për mallra që hyjnë nën regjim, por nuk ishte lejuar në pikën 8 për mallra që përpunohen. Në praktikat ref. 71972 datë 12.06.2022 dhe ref. 78659 datë 25.06.2022 subjekti ka eksportuar në kodin 8302 të cilin nuk e ka në pikën (8) të autorizimit.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e nenit 252 germa "c" dhe 257 pika 1, germa "b", të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Për subjektin "U.I." ShPK, me ..... të paguajë penalitet në shumën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë...*".
Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:
a) Në vendimin nr. 49, datë 10.10.2022, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 257 KD) parashikon një sanksion në masën nga 50,000 lekë deri në 50,000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, në arsyetimin e vendimit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".
b) Proces verbali i konstatimit dhe vendimi përkatës, janë marrë si pasojë e një keqklasifikimi apo keqvlerësimi i fakteve dhe rrethanave. Konkretisht, shkelja e regjimit doganor është konstatuar në dy praktika (ref. 71972 datë 12.06.2022 dhe ref. 78659 datë 25.06.2022). Në këto kushte, autoriteti vendimmarrës duhet të aplikonte sanksione për secilën prej tyre dhe jo vetëm për një. Si rezultat i mosaplikimit të sanksionit, minimalisht, për sa më sipër, vlera **50,000 lekë** përbën të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit, si vlera e sanksionit minimal të përcaktuar në dispozitën e përdorur nga autoriteti doganor (germa "b", pika 1, neni 257 KD).
Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:
1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;
2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;
3) Znj. F.D., P/Sek., znj. M.N., Doganiere, në cilësinë e punonjësve konstatues (hartues të procesverbalit);
3-Nga auditimi i vendimit 54, datë 16.11.2022, mbi shqyrtimin e procesverbalit me numër serial 0010277 datë 15.11.2022 (nr. 1766 prot, datë 16.11.2022), të mbajtur nga grupi i doganierëve në shërbim pranë Zyrës Doganore Muriqan.
Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Shtetasi, O.G. , i identifikuar me numër personal ..... , drejtues i mjetit me targa ABxxxIC, është paraqitur në pikën Doganore Muriqan për të kryer veprime në hyrje të Republikës së Shqipërisë. Bazuar në analizën e riskut automjeti i këtij shtetasi nga ana e doganierëve të shërbimit, u dërgua në vijën e dytë të kontrollit (garazh). Shtetasi i kishte deklaruar punonjësve të doganës se kishte me vetë rroba të përdorimit personal të përdorura. Gjatë kontrollit të plotë fizik, në mjeti u gjetën edhe mallrat të reja, të padeklaruara, me qëllim tregtarë, si: Parfume 102 copë, kremra kozmetik 90 copë, këpucë pune 11 palë, atlete sportive 28 palë dhe vegla punë 19 copë/kuti.
Bazuar në KD, veprimet dhe mosveprimet e deklaruesit përbëjnë shkelje doganore, kontrabandë në kufijtë shtetëror, për mos deklarimin e mallrave të importuar, pasi këto mallra kanë natyrë tregtare dhe produktet duheshin deklaruar për t'u paguar detyrimet doganore.
Rezulton që shkelësi të këtë dijeni për procesverbalin e konstatimit edhe ka kërkuar zgjidhjen administrative dhe heqjen dorë nga ankimimi.
Nga sa më sipër, plotësohen kushtëzimet e nenit 272, pika 1 e Kodit Doganor, për zgjidhjen administrative të kontrabandës.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e nenit 250 pika 2, 3 dhe 4, nenit 266, pika 2 dhe 4, nenit 267, pika 2, nenit 268, pika 2 dhe nenit 272, të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të shtetasit O.G. , i identifikuar*

*me numër personal J*********R..... , për shkeljet doganore të kontrabandës sipas specifikimeve të mëposhtme: shmangien nga pagesa e detyrimeve doganore për mallrat e padeklaruar në shumën prej: Detyrim doganor i shmangur 24.613 lekë, gjobë 3 –fish i detyrimit doganor 73.839 lekë, Totali 98.452 lekë...*".

Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:

a) Autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër nuk rezulton të ketë marrë (formalizuar) një vendim për "*Për zgjidhjen administrative të kontrabandës*".

b) Edhe pse autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër ka vendosur (praktikisht dhe jo formalisht) për zgjidhjen administrative të kontrabandës, nuk rezulton që dosja (praktika) t'i jetë dërguar organit të prokurorisë. Një shkresë e tillë nuk administrohet apo nuk është pjesë e dosjes (praktikës), gjithashtu nuk rezulton të jetë as veprim i kërkuar në dispozitivin e vendimit, mosveprim në kundërshtim me pikën 1 të nenit 276 të *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, i cili përcakton se: "*Autoritetet doganore kompetente, për shkeljen e konstatuar, përgatitin dosjen e plotë, në lidhje me shkeljen, dhe marrin vendimin përkatës*" dhe me pikën 2 të nenit 277, i cili përcakton se: "*Në rastet kur zbatohet neni 272, dosjes së sipërpërmendur i bashkëngjitet vendimi i autoriteteve për zgjidhjen administrative të çështjes, e cila i dërgohet menjëherë organit të prokurorisë*".

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;

2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;

- **<u>Për vitin 2023</u>**, nga 20 (njëzet) vendimeve të përzgjedhura, në bazë risku, konkretisht vendimet nr. 2, 3, 5, 10, 11, 15, 16, 18, 22, 23, 26, 27, 28, 29, 30, 32, 38, 41, 43 dhe 45, me përjashtim të vendimeve të cilat kanë rezultuar si të marra në zbatim të kritereve përkatëse, konstatohet që:

1-Nga auditimi i vendimit nr. 10, datë 27.02.2023, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore, të mbajtur nga doganierët e Zyrës Muriqan me datë 27.02.2023.

Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:

Shtetasi A.H. i identifikuar me pasaportë Angleze, me numër 556908xxx, u paraqit pranë Zyrës Doganore Muriqan për të kryer procedurën e hedhjes në qarkullim të lirë të automjetit të markës "Mercedes Benz C***D", kodi tarifor 8703, sasia 1 copë, me numër shasie ËDD2053092F57xxxx, me targë LDxxFUM në pronësi të tij.

Gjatë verifikimit të sistemit TIMS të Policisë Kufitare, rezultoi se ka shkelje të afateve të qëndrimit të RLP-së të automjetit në territorin Shqiptar, në kundërshtim me nenet 195 dhe 223 të Kodit Doganor dhe nenit 662 të VKM-së nr. 651 datë 10.11.2017 "*Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*".

Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e germës "b", pikës 1 të nenit 256, të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të shtetasit z. A.H., i identifikuar me pasaportë Angleze, me numër 556908xxx dhe penalizimin me gjobë në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë...*".

Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:

a) Në vendimin nr. 10, datë 27.02.2023, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur si bazë ligjore germën "b", të pikës 1 të nenit 256, ndërkohë që, kundërvajtjet e kryera në neglizhencë parashikohen nga neni 252 i KD dhe sanksioni në lidhje me situatën parashikohet në nenin 257.1/b të KD.

b) Autoriteti vendimmarrës, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozitat e aplikuara, (si neni 256.1/b ashtu edhe neni 257.1/b i KD) parashikojnë një sanksion variabël (nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë dhe nga 50,000 lekë deri në 500,000 lekë). Pavarësisht dispozitës ligjore të aplikuar, në lidhje me përdorimin e diskrecionit, në arsyetimin e vendimit, nuk ka dhënë asnjë

shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;

2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;

2-Nga auditimi i vendimit nr. 15, datë 20.03.2023, mbi shqyrtimin e procesverbalit nr. 495 prot., datë 01.03.2023, të mbajtur nga grupi i punës pranë Degës së Doganës Shkodër, për shoqërinë "C. MA." ShPK.

Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:

Autorizimi për përdorimin e "Regjimit të Lejimit të Përkohshëm" (me përjashtim të pjesshëm) nr. 4383/1, datë 16.03.2018, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Tiranë, rezulton se, bazuar në pikën 13, është përcaktuar 12 muaj.

Subjekti "C.MA." ShPK, me shkresën nr. 6239/1 prot., datë 20.05.2019, ka aplikuar për shtyrje të afatit të këtij rregjimi, i cili është miratuar edhe për 12 muaj të tjerë. Për këtë shtesë rezulton se nuk është respektuar afati i përcaktuar në autorizim për rieksportim, për të cilin është penalizuar sipas vendimit administrativ nr. 111 datë 21.10.2020 të Degës së Doganës Shkodër.

Me shkresën nr. 12182/1 prot., datë 03.07.2020, të DPD-së, subjekti ka aplikuar përsëri për shtyrje të afatit të këtij rregjimi, i cili është miratuar deri me datën 16.03.2021. Me shtesën e dhënë me shkresë nr. 12182/1 prot., datë 03.07.2020 të Drejtorisë së përgjithshme të Doganave afati i rieksportimit ishte deri me datë 16.03.2021.

Subjekti ka aplikuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për marrjen e një shtese tjetër, me shkresën nr. 518 prot., datë 17.03.2022, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk është miratuar dhënia e një shtese tjetër për këtë autorizim. Deri tani subjekti nuk është pajisur me shtesë për këtë autorizim.

Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e nenit 252, gërma "c", të nenit 257, pika 1, gërma b, të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Për subjektin "C.MA." ShPK të paguajë penalitet në shumën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë...*".

Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:

a) Autoriteti vendimmarrës, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e aplikuar, (neni 257.1/b i KD) parashikon një sanksion variabël (nga 50,000 lekë deri në 500,000 lekë). Pavarësisht dispozitës ligjore të aplikuar, në lidhje me përdorimin e diskrecionit, në arsyetimin e vendimit, nuk është dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;

2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;

3-Nga auditimi i vendimit nr. 23, datë 09.05.2023, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore të mbajtur nga Zyra Doganore Hani i Hotit me datë 09.05.2023.

Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:

Automjeti i markës BMË, me numër shasie ËBAFV31030DË17xxxx, me targë KUNKxxx ka hyrë në Republikën e Shqipërisë me datën 08.05.2023, ora 18:24.

Me datën 08.05.2023, shtetasi K.A. , shoferi i Bizarkes, në të cilin ndodhet i ngarkuar mjeti i sipërcituar është paraqitur pranë Zyrës Doganore Hani i Hotit për të kryer procedurën e daljes nga territori doganor Shqiptar.
Nga të dhënat e sistemit TIMS, rezulton se automjeti i markës BMW ka hyrë në Republikën e Shqipërisë me datën 23.08.2022 dhe nuk ka dalje, si dhe është paraqitur për të kryer procedurën e daljes nga territori doganor Shqiptar me datën 08.05.2023.
Nga përllogaritja e afateve të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë rezulton se automjeti ka thyer afatin e regjimit të lejimit të përkohshëm në kundërshtim me nenin 195 dhe 223 të Kodit Doganor dhe nenit 662 të VKM-së nr. 651 datë 10.11.2017 "*Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e germës "b", pikës 1 të nenit 256, të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të shtetases H.C. me numër personal identifikimi BG5607834xxx dhe penalizimin me gjobë në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë ë...*".
Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:
a) Në vendimin nr. 23, datë 09.05.2023, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur si bazë ligjore germën "b", të pikës 1 të nenit 256, ndërkohë që, kundërvajtjet e kryera në neglizhencë parashikohen nga neni 252 i KD dhe sanksioni në lidhje me situatën parashikohet në nenin 257.1/b të KD, dispozitë kjo e fundit e cila është cituar saktë në procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve por jo në vendimin përkatës.
b) Autoriteti vendimmarrës, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozitat e aplikuara, (si neni 256.1/b ashtu edhe neni 257.1/b i KD) parashikojnë një sanksion variabël (nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë dhe nga 50,000 lekë deri në 500,000 lekë). Pavarësisht dispozitës ligjore të aplikuar, në lidhje me përdorimin e diskrecionit, në arsyetimin e vendimit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".
Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:
1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;
2) Z. F.N. , me detyrë, Doganier D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;

- **<u>Për vitin 2024</u>**, nga 20 (njëzet) vendimet e audituara me përzgjedhje, në bazë risku, konkretisht vendimet nr. 1, 3, 7, 9, 10, 11, 12, 15, 16, 25, 26, 29, 40, 42, 44, 47, 50, 53, 54 dhe 56, me përjashtim të vendimeve të cilat kanë rezultuar si të marra në zbatim të kritereve përkatëse, konstatohet që:

1-Nga auditimi i vendimit nr. 03, datë 21.02.2024, mbi shqyrtimin e procesverbalit me numër nr. 401/1 prot., datë 21.02.2024, të mbajtur nga grupi i punës pranë Degës së Doganës Shkodër, i hartuar në bashkëpunim me strukturën e grupit të monitorimit pranë DPD-së.
Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Shoqëria "G.S." ShPK, me NIPT ..... , ka deklaruar pranë Degës së Doganës Shkodër deklaratën R 442 datë 19.02.2024 me këto të dhëna: "pjesë këmbimi për autovetura" kodi tarifor 87089997 dhe "konstruksione metalike të përdorura" me kod tarifor 73089098.
Deklarata doganore DAV 442 datë 19.02.2024 u rikanalizuar në kanal të kuq nga struktura e Monitorimit pranë DPD-së për kontroll fizik të ngarkesës dhe evidentim të peshës sipas artikujve. Ky kontroll u bë me prezencën e grupit AK07. Nga doganieri i kontrollit fizik pranë Degës së Doganës Shkodër në bashkëpunim me grupin AK07 u bë kontrolli fizik në ambientet e subjektit me kërkesë të këtij të fundit për arsye të ngarkesës delikate të pjesëve të makinës, të cilat ishin të vendosura pjesërisht në kosha metalik dhe pjesërisht rifuxho.

Pas kërkesës se subjektit për specifiken e artikujve në ngarkesë kontrolli u zhvillua në mjediset e subjektit nën vëzhgimin e grupit AK dhe doganierit kontrollit fizik të doganës Shkodër. Pas kontrollit peshat rezultuan me diferencë + - me deklarimin. Konkretisht Artikulli 01 nga 5150 kg në 7190 kg dhe Artikulli 02 nga 5350 kg ne 3310 kg (peshat bruto) për ketë arsye u njoftua DVQ për rivlerësim të situatës dhe u nxor diferenca e detyrimeve të shmangura doganore.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e nenit 250 pika 1 gërma "a" dhe pika 4, nenit 251 dhe nenit, 256, pika 1, gërma "a", të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të shoqërisë "G.S." ShPK, për shmangien nga detyrimi doganor në shumën 68,483 lekë, gjoba 1–fish i detyrimit doganor në shumën 68,483 lekë, Totali 136,966 lekë...*".
Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:
a) Proces verbali i konstatimit dhe vendimi përkatës, janë marrë si pasojë e një keqklasifikimi apo keqvlerësimi i fakteve dhe rrethanave. Konkretisht, kjo vendimmarrje e autoritetit doganor është klasifikuar në nenet 250/1/a; 251/1/a dhe 256/1/a por klasifikimi për këtë lloj shkelje duhet të ishte bazuar në nenin 252/d dhe sanksioni sipas nenit 257/1/a të Kodit Doganor, duke aplikuar masën dyfish të detyrimit. Si rezultat i mangësive të konstatuara rezulton penalitet i munguar në shumën **68,483 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.
Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:
1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;
2) Znj. T.Q., z. V.D. , Doganier, z. E.S. , z. B.M. (AK) në cilësinë e punonjësve konstatues (hartues të procesverbalit);
2-Nga auditimi i vendimit nr. 09, datë 12.03.2024, mbi shqyrtimin e procesverbalit të kontrollit pas zhdoganimit/aposterior me nr. 469 prot., datë 02.03.2024.
Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Subjekti "V.M." ShPK, me NIPT .... , ka depozituar pranë Zyrës Doganore Hani Hotit, deklaratën IMP 4 11495 datë 28.04.2023, malli i deklaruar "bërsi luledielli", kodi tarifor 23063000, vendi origjinës Serbi, me peshë 24.800 kg, me vlerë totale të faturës 9424 euro, në kushtet e lëvrimit CPT/Berat.
Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit rezulton që subjekti të jetë deklaruar gabim, sepse subjekti nuk është "E" ShPK me, me adresë në Durrës por është "V.M", me adresë në Berat. Në këtë rast deklarimi gabim, nuk sjell efekte financiare.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e nenit 250, pika 1, gërma "a", të nenit 251, pika 1, të nenit 256, pika 1, germa "b", të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të shoqërisë "V.M." ShPK, me NIPT ..... për shkeljen e konstatuar dhe aplikimin e sanksioneve në shumën 20.000 (njëzet mijë) lekë...*".
a) Në vendimin nr. 09, datë 12.03.2024, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 256 KD) parashikon një sanksion në masën nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, në arsyetimin e vendimit, nuk është dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".
Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:
1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;
2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;
3-Nga auditimi i vendimit nr. 10, datë 29.03.2024, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore nr. 437/1 prot., datë 104.03.2024, të mbajtur nga doganierja e regjimeve dhe përgjegjësja e Zyrës së Regjimeve Shkodër.

Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Subjekti "K.I." ShPK, me NIPT ..... , ka punuar nën "Regjimin e Përpunimit Aktiv" dhe me datë 27.02.2024, ka paraqitur formatin tip për mbylljen e regjimit (protokolluar me nr. 437prot., datë 04.03.2024 DDSH).
Doganierja e mbajtjes së regjimit pas kësaj kërkese ka shqyrtuar autorizimin dhe ka konstatuar se, subjekti nuk ka respektuar afatin e paraqitjes së dokumentit të mbylljes së regjimit, përcaktuar në Kreun XIV, pika 2, të Udhëzimit Nr. 4 datë 28.03.2019 "*Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv*".
Në zbatim të pikës 4 të nenit 273 të KD, konstatuesit e shkeljes kanë bërë njoftimin, subjekti është njoftuar më datë 04.03.2024 dhe nuk ka paraqitur observacion brenda afatit ligjor.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e nenit 251, gërma "i", të nenit 256, pika 1, germa "b", të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të subjektit "K.I." ShPK për shkeljen e konstatuar në autorizimin e RPA-së Nr. 12942/1, datë 29.07.2022, dhe penalizmin me gjobë në shumën 20,000 (njezet mijë) lekë...*".
a) Në vendimin nr. 10, datë 29.03.2024, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 256 KD) parashikon një sanksion në masën nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, në arsyetimin e vendimit, nuk është dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".
Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:
1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;
2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;
4-Nga auditimi i vendimit nr. 26, datë 06.09.2024, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore të mbajtur me datë 02.09.2024 protokolluar me nr. 1630 prot., datë 04.09.2024 nga doganierët e Zyrës Doganore Hani i Hotit.
Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Personi Fizik "T.Z.", me NIPT .... , me deklaratën IM4 R30132 datë 02.09.2024 ka deklaruar artikullin "lëndë druri, bredhi e sharruar" = 40.81 m3 / 25500 kg / 14 paleta me peshë 25.500 kg. Gjatë peshimit të mjeti kishte një diferencë peshe 2800 kg. Nga doganieret e kontrollit fizik u bë verifikimi i sasisë dhe rezulton komform deklarimit në sasi dhe në metër kub 40,81 m3. Kjo diferencë sipas shoferit vjen nga punimet shtesë që i janë bërë karrocerisë së kamionit. Për këtë arsye i lihet si detyrë subjektit peshimi bosh i mjetit dhe pasqyrimi i saktë i peshës në librezën e mjetit.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e nenit 251, pika 1, të nenit 256, pika 1, germa "b", të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të Personit Fizik "T.Z.", për shkeljen e konstatuar dhe aplikimin e sanksioneve në shumën 20,000 lekë (njëzet mijë) lekë...*".
a) Në vendimin nr. 26, datë 06.09.2024, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 256 KD) parashikon një sanksion në masën nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, në arsyetimin e vendimit, nuk është dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".
Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;
2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;
5-Nga auditimi i vendimit nr. 47, datë 15.11.2024, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore të mbajtur nga Zyra Doganore Hani Hotit, me nr. 2055 prot., datë 11.11.2024.
Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Subjektit "S. DOO, me adresë: Montenegro 81000 Podgorica, në cilësinë e transportuesit, me mjetin kamion, me targa NKDK/NKxxxAB, ka marrë përsipër kryerjen e transportit ngarkuar me artikullin ADBLUE për tranzit ndërkombëtar T 1 #1022 me hyrje nga Zyra Doganore Kapshticë dhe dalje nga Zyra Doganore Hani I Hotit.
Ky mjet duhej të mbërrinte nga dogana Kapshticë, në destinacion në zyra doganore Hani i Hotit, në orën 02'18 datë 08.11.2024, me tranzit ndërkombëtar me Nr. D 24ALAL19000000103994, por u paraqit pranë kësaj zyre në orën 12:30 datë 09.11.2024 pa njoftim paraprak tek autoritetet përkatëse për këtë vonesë.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e nenit 251, pika 1, të nenit 256, pika 1, germa "b", të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të subjektit "SI. DOO, dhe penalizimin me gjobë në shumën 20,000 (njëzet mijë) lekë...*".
a) Në vendimin nr. 47, datë 15.11.2024, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 256 KD) parashikon një sanksion në masën nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, në arsyetimin e vendimit, nuk është dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".
Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:
1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;
2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;
6-Nga auditimi i vendimit nr. 05, datë 29.02.2024, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore nr. 459 prot., datë 29.02.2024, të mbajtur nga grupi i punës pranë Degës së Doganës Hani i Hotit.
Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Shtetasi R.S. , me numër personal ... , ka deklaruar pranë Degës së Doganës Hani i Hotit deklaratën R 5771 datë 28.02.2024 me këto të dhëna: "pjesë këmbimi për autovetura" me kod tarifor 87089997, vendi i origjinës Britani e Madhe, me peshë 1395 kg.
Grupi i punës ka ushtruar kontroll dokumentar dhe fizik, për deklaratën doganore R 5771, datë 28.02.2024 dhe ka konstatuar që malli në deklaraten e eksportit është ne kodin tarifor 87033290, i cili nuk përkon me deklaratën doganore të deklaruar nga deklaruesi i cili ka vendosur kodin tarifor 87089997.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e nenit 250, nenit 251 dhe nenit 256, pika 1, gërma "b", të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të shtetasit R.S. me numër personal K00813052M, për keq deklarim të kodit tarifor dhe penalizmin me gjobë në masën 20,000 (njëzetmijë) lekë...*".
a) Në vendimin nr. 05, datë 29.02.2024, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 256 KD) parashikon një sanksion në masën nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, në arsyetimin e vendimit, nuk është dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera,

përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".
b) Për sa më sipër, përveç sanksionimit të keqdeklarimit të kodit tarifor, autoriteti doganor nuk është shprehur në lidhje me efektet financiare të mundshme si pasojë e aplikimit të kodit tarifor përkatës. Konkretisht, pas konstatimit të keqdeklarimit të kodit tarifor, autoriteti doganor duhet të verifikonte vlerën e detyrimit doganor mbi bazën e kodit të saktë tarifor dhe në rast se do të rezultonte diferencë në vlerë të aplikonte sanksionin e parashikuar nga pika 1/ "a", neni 256 KD.
c) Nuk është dokumentuar njoftimi i vendimit.
Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:
1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;
2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;
3) Z. F.N. dhe z. J.L. , me detyrë, doganierë në D.D. Shkodër, në cilësinë e konstatuesit dhe konceptuesit të procesverbalit;
7-Nga auditimi i vendimit nr. 06, datë 29.02.2024, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore nr. 460 prot., datë 29.02.2024, të mbajtur nga grupi i punës pranë Degës së Doganës Hani i Hotit.
Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Shtetasi K.Sh. , me numër personal ..... , ka deklaruar pranë Degës së Doganës Hani i Hotit deklaratën R 5774 datë 28.02.2024 me këto të dhëna: "pjesë këmbimi për autovetura" me kod tarifor 87089997, vendi i origjinës Britani e Madhe, me peshë 1395 kg.
Grupi i punës ka ushtruar kontroll dokumentar dhe fizik, për deklaratën doganore R 5774, datë 28.02.2024 dhe ka konstatuar që malli në deklaratën e eksportit është në kodin tarifor 87033290, i cili nuk përkon me deklaratën doganore të deklaruar nga deklaruesi i cili ka vendosur kodin tarifor 87089997.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e nenit 250, nenit 251 dhe nenit 256, pika 1, gërma "b", të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të shtetasit K.Sh. me numër personal ..... , për keq deklarim të kodit tarifor dhe penalizmin me gjobë në masën 20,000 (njëzetmijë) lekë...*".
a) Në vendimin nr. 06, datë 29.02.2024, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 256 KD) parashikon një sanksion në masën nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, në arsyetimin e vendimit, nuk është dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".
b) Për sa më sipër, përveç sanksionimit të keqdeklarimit të kodit tarifor, autoriteti doganor nuk është shprehur në lidhje me efektet financiare të mundshme si pasojë e aplikimit të kodit tarifor përkatës. Konkretisht, pas konstatimit të keqdeklarimit të kodit tarifor, autoriteti doganor duhet të verifikonte vlerën e detyrimit doganor mbi bazën e kodit të saktë tarifor dhe në rast se do të rezultonte diferencë në vlerë të aplikonte sanksionin e parashikuar nga pika 1/ "a", neni 256 KD.
c) Nuk është dokumentuar njoftimi i vendimit.
Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:
1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;
2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;
3) Z. F.N.dhe z. J.L., me detyrë, doganierë në D.D. Shkodër, në cilësinë e konstatuesit dhe konceptuesit të procesverbalit;

- **<u>Për vitin 2025</u>**, nga 10 (dhjetë) vendimet e audituara me përzgjedhje, në bazë risku, konkretisht vendimet nr. 1, 5, 6, 7, 12, 15, 16, 17, 18 dhe 19, me përjashtim të vendimeve të cilat kanë rezultuar si të marra në zbatim të kritereve përkatëse, konstatohet që:

1-Nga auditimi i vendimit nr. 6, datë 13.03.2025, mbi shqyrtimin e procesverbalit nr. 577/3 datë 25.02.2025 të mbajtur nga grupi i punës pranë Degës së Doganës Shkodër.
Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Me e-mail e datës 19.2.2025 agjencia doganore "A & C" ShPK, me NIPT .... , me kod J144, nëpërmjet e-mail a.s@gmail.com, ka bërë kërkesë për hapjen e përkoshme të NIPT-it të shoqërisë "C. SH." ShPK, me NIPT M*********C.... , e cila punon në regjimin e përpunimit aktiv me përshkrimin "*vetëm për të mbyllur deklarimet në sistem nga ana doganës të eksporteve Durrës*" për deklaratën e eksportit të depozituar më datë 16.02.2025.
Nëpërmjet e-mail-it, nga ana e Degës së Doganës Shkodër, i është bërë kërkesë DPD-së për hapje të përkohshme të shoqërisë, vetëm për mbylljen në sistem të deklaratës së eksportit të shoqërisë së sipërcituar, për të cilën është njoftuar edhe agjencia doganore me motivacionin "…*vetëm për procedurën e eksportit të pambyllur dhe agjenti të njoftojë nëpërmjet email mbi përfundimin e procedurës*."
Sipas verifikimeve në sistem rezulton që agjencia doganore të ketë depozituar për llogari të subjektit "C. SH." ShPK, menjëherë pas hapjes së niptit, në sistemin AË deklaratën doganore IMP5 R 21123, datë 19.02.2025, në orën 12:16, për të cilën nuk ishte e lejuar nga autoritete doganore.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e nenit 79 dhe nenit 259, pika 1, gërma b, të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor solidar të shoqërisë "C.SH." ShPK, me NIPT ..... dhe agjencinë doganore "A & CO" ShPK, përfaqësuar nga agjenti doganor zj. N.K. me kod identifikimi në AË xxxx, dhe aplikimin e sanksioneve në masën 50.000 (pesëdhjetë) lekë...*".
Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:
a) Në vendimin nr. 6, datë 13.03.2025, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 259 KD) parashikon një sanksion në masën nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë. Edhe pse autoriteti doganor ka vendosur vlerën më të lartë të sanksionit, sipas dispozitës së cituar, në lidhje me përdorimin e diskrecionit, në arsyetimin e vendimit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".
Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:
1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;
2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;
2-Nga auditimi i vendimit nr. 19, datë 30.12.2025, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore, të mbajtur më datë 29.12.2025, protokolluar me nr. 3239 datë 29.12.2025, nga doganierët e Zyrës Doganore Hani i Hotit.
Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Shoqëria transportuese "K.D" TRANSPORT ka deklaruar për subjektin M.H. person fizik me Nipt M*********T, me deklaratën R 43721 datë 29.12.2025 ardhur me mjetin kamioni me Targë J96-E-xxx / O39-E-xxx artikullin "lëndë druri e sharruar 38534 m3 (e tharë termikisht) = 12 koli, origjina Bosnjë Herzegovin, me vlerë 5,575.70 euro.
Nga kontrolli i ushtruar në deklaratën R 43721 datë 29.12.2025. Ky subjekt është kanalizuar në kanal të kuq.
Nga doganieret e kontrollit fizik u bë kontrolli i mjetit dhe më pas kontrolli fizik i plotë. Rezulton diferencë në peshë 2185 kg. Kjo diferencë vjen nga libreza e mjetit.
Si rrjedhim, kjo pasaktësi e peshës që nuk është e pasqyruar në librezë të mjetit përbën kundërvajtje doganore.

Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e nenit 251 pika 1, nenit 256, pika 1, gërma b, të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të subjekti Myzejen Harremi person fizik me Nipt M14308405T, për shkeljen e konstatuar dhe aplikimin e sanksioneve në shumën 20.000 lekë (njëzetmijë) lekë...*".

Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:

a) Në vendimin nr. 19, datë 30.12.2025, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 256 KD) parashikon një sanksion në masën nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, në arsyetimin e vendimit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;

2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;

3-Nga auditimi i vendimit nr. 1, datë 11.02.2025, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore Nr. 207, datë 22.01.2025, të mbajtur nga Kontrolli Aposterior pranë Zyrës Doganore Shkodër.

Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:

Me shkresën datë 10.06.2024, agjenti doganor M.Xh., ka paraqitur kërkesë për anulimin e deklaratës doganore IMP4 R 19181, datë 06.06.2024 të hartuar në Degën e Doganës Durrës, por depozitimi në sistemin doganor është bërë në zyrën doganore AL0200000 Hani i Hotit dhe jo në Zyrën Doganore Durrës që mban kodin AL140000. Sipas dokumentacionin bashkëlidhur, kërkesës rezulton se, në Degën e Doganës Durrës është hartuar deklarata tjetër doganore IMP4 R 78178, datë 06.06.2024 për shtetasin E.B. , me numër identifikimi personal ..... , me të njëjtën përshkrim malli si në deklaratën doganore R 19181, datë 06.06.2024.

Nisur nga kërkesa e agjentit doganor, kontrolli Aposterior, ka ushtruar kontroll dokumentar në deklaratën doganore R 19181, datë 06.06.2024, dokumentacionin bashkëlidhur kërkesës dhe konstaton se: veprimet e agjenti doganor, si person i specializuar në kryerjen e përfaqësimit doganor të subjekteve deklaruese, përbejnë kundërvajtje administrative për shkak të depozitimit të gabuar të deklarimit në një Zyrë Doganore tjetër në të cilën nuk ndodhej malli për të kryer veprimet doganore.

Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e nenit 250 pika 1, nenit 259, pika 1, gërma b, të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Për agjentin doganor M.Xh. , përfaqësues i agjencisë doganore "D.. Spe...", me Kod J110 të aplikohen sanksionet në vlerën 20.000 (njëzetmijë) lekë...*".

Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:

a) Në vendimin nr. 1, datë 11.02.2025, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 259 KD) parashikon një sanksion në masën nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, në arsyetimin e vendimit, nuk është dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;

2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;

4-Nga auditimi i vendimit nr. 10, datë 24.07.2025, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore të mbajtur nga doganierët e Zyrës Doganore Shkodër me nr.1865/1 prot., datë 23.07.2025.
Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Shtetasi S.Dh. , me numër personal identifikimi ..... u paraqit pranë Zyrës Doganore Shkodër të kryej procedurën e daljes nga territori shqiptar me mjetin autoveture, me targë LERXD999, me shasi ËDB2110201A829062xxxx.
Sipas të dhënave të sistemin TIMS rezultoi se ka shkelje të afateve të qëndrimit të RLP-së, për automjetin me targë LERXDxxx. Nga të dhënat e sistemit TIMS, konstatohet se ky automjet ka hyrë me datë 12.07.2024 në territorin shqiptar dhe ka qëndruar për më shumë se 6 muaj. Si rrjedhim, ka shkelur afatet e RLP-së për mjetin, në kundërshtim me nenin 195 dhe 223 të Kodit Doganor dhe nenit 662 të VKM-së nr. 651 datë 10.11.2017 "*Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014 te Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar.
Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se gjen të drejtë zbatim e germës "a", të nenit 250, germës "c" të nenit 252, germës "b" të nenit 257 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe Udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave Nr. 5, datë 12.01.2024 për Miratimin e manualit udhëzues "*Mbi zbatimin e dispozitave për shkeljet doganore dhe të Akcizës në Republikën e Shqipërisë*", dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të shtetasit Saimir Dhijaku, me numër personal identifikimi I4080404B dhe penalizimin me gjobë në shumën 20.000 (njëzet mijë) lekë...*".
Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:
a) Në vendimin nr. 10, datë 24.07.2025, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 257 KD) parashikon një sanksion në masën nga 50,000 lekë deri në 500,000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, autoriteti vendimmarrës, në arsyetimin e vendimit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".
b) Proces verbali i konstatimit dhe vendimi përkatës, janë marrë si pasojë e një keqklasifikimi apo keqvlerësimi i fakteve dhe rrethanave. Konkretisht, mosrespektimi i afateve kohore të përcaktuara të një regjimi doganor parashikohet nga neni 252 KD. Në këto kushte, sanksioni në lidhje me situatën, duke u mbështetur në nenin 257.1/b të KD, është nga 50,000 lekë deri në 500,000 lekë dhe jo nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë. Minimalisht, për sa më sipër, vlera **30,000 lekë** përbën të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit, si diferenca midis sanksionit dhe dhënë dhe atij të përcaktuar (50,000-20,000 lekë).
Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:
1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;
2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;
3) Zj. A.D. , Doganiere, në cilësinë e punonjësit konstatues;
5-Nga auditimi i vendimit nr. 9, datë 23.07.2025, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore të mbajtur nga doganierët e Zyrës Doganore Muriqan me nr.1868 prot., datë 23.07.2025.
Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
Shtetasi Kujtim Baci, me numër personal identifikimi F*********I, u paraqit pranë Zyrës Doganore Muriqan të kryej procedurën e daljes nga territori shqiptar me mjetin, marka AUDI Q5, me targë CYHTxxx, me shasi ËAIËFCFPXFA09xxxx.
Gjatë verifikimit në sistemin TIMS të Policisë Kufitare rezultoi se ka shkelje të afateve të qëndrimit të RLP-së, për automjetin me targë CYHT282 në territorin shqiptare. Nga të dhënat e

sistemit TIMS, konstatohet se ky automjet ka hyrë me datë 19.10.2024 në territorin shqiptar dhe ka qëndruar për më shumë se 6 muaj. Si rrjedhim, ka shkelur afatet e RLP-së për mjetin, në kundërshtim me nenin 195 dhe 223 të Kodit Doganor dhe nenit 662 të VKM-së nr. 651 datë 10.11.2017 "*Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014 te Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar.

Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se gjen të drejtë zbatim e germës "a", të nenit 250, germës "c" të nenit 252, germës "b" të nenit 257 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe Udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave Nr. 5, datë 12.01.2024 për Miratimin e manualit udhëzues "*Mbi zbatimin e dispozitave për shkeljet doganore dhe të Akcizës në Republikën e Shqipërisë*", dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të shtetasit K.B. , me numër personal identifikimi ..... dhe penalizimin me gjobë në shumën 20.000 (njëzet mijë) lekë...*".

Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:

a) Në vendimin nr. 9, datë 23.07.2025, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 257 KD) parashikon një sanksion në masën nga 50,000 lekë deri në 500,000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, autoriteti vendimmarrës, në arsyetimin e vendimit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".

b) Proces verbali i konstatimit dhe vendimi përkatës, janë marrë si pasojë e një keqklasifikimi apo keqvlerësimi i fakteve dhe rrethanave. Konkretisht, kundërvajtjet e kryera në neglizhencë parashikohen nga neni 252 KD. Në këto kushte, sanksioni në lidhje me situatën, duke u mbështetur në nenin 257.1/b të KD, është nga 50,000 lekë deri në 500,000 lekë dhe jo nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë. Minimalisht, për sa më sipër, vlera **30,000 lekë** përbën të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit, si diferenca midis sanksionit dhe dhënë dhe atij të përcaktuar (50,000-20,000 lekë).

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;

2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;

3) Z. Gj.Ç dhe I.K., Doganier, në cilësinë e punonjësve konstatues;

6-Nga auditimi i vendimit nr. 14, datë 01.11.2025, mbi shqyrtimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore nr. 2749/2 datë 31.10.2025 të mbajtur nga doganierët e Zyrës Doganore Hani i Hotit.

Nga procesverbali dhe vendimi i sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:

Subjekti deklarues personi fizik E.P. , me nipt ..... , me mjetin kamion, me targa PGLLxxx, ka paraqitur deklaratën IM 4R 36795 datë 30.10.2025 dhe ka deklaruar artikullin "bidona plastik".

Nga kontrolli dokumentar i ushtruar gjatë përpunimit të deklaratës doganore IM 4R 36795 datë 30.10.2025 rezulton se, pesha e deklaruar e mallit është 8800 kg, siç është deklaruar në CMR, ndërsa pesha në faturën shoqëruese është 856 kg. Nisur nga ky konstatim, praktika është rikanalizuar në të kuqe nga zyra e DVQ-së, që të kryhet kontrolli i plotë fizik i mallit.

Me shkresë nr. 2753/1 datë 31.10.2025 subjekti ka bërë kërkesë pranë Degës së Doganës Shkodër për rregullimin e dokumentacionit plotësues të praktikës. Bashkëlidhur së cilës është edhe dokumenti i transportit CMR 04752, në të cilën pasqyrohet pesha bruto e mallit 856 kg.

Nisur nga rikanalizimi i praktikës doganore, nga doganieret e kontrollit fizik u bë kontrolli i plotë fizik i mallit, i cili sipas procesverbalit datë 31.10.2025, rezultoi se pesha reale e mallit ishte 980 kg.

Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër shprehet se, gjen të drejtë zbatimin e nenit 250 pika 2, nenit 256, pika 1, gërma b, të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014

"*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe ndër të tjera, ka vendosur: "*Shpalljen debitor të personit fizik E.P. me nipt ..... , për shkeljen e konstatuar dhe aplikimin e sanksioneve në shumën 20,000 lekë (njëzet mijë) lekë...*".

Nga auditimi i praktikës (dosjes) së sipërcituar u konsatatua se:

a) Në vendimin nr. 14, datë 01.11.2025, autoriteti vendimmarrës, Dega Doganore Shkodër, ka përdorur diskrecion, për sa kohë dispozita e përdorur (germa "b", pika 1, neni 256 KD) parashikon një sanksion në masën nga 20,000 lekë deri në 50,000 lekë. Në lidhje me përdorimin e diskrecionit, në arsyetimin e vendimit, nuk është dhënë asnjë shpjegim, veprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se: "*Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:...ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar*".

b) Për sa më sipër, përveç mangësive kundrejt detyrimit për të siguruar saktësinë dhe plotësimin e informacioneve të dhëna në deklaratën doganor, konstatohet një diferencë e sasisë së mallit të deklaruar me atë realisht të importuar. Konkretisht, pas kërkesës për rregullimin e dokumentacionit plotësues të praktikës, sasia e deklaruar është 856 kg ndërsa ajo reale e rezultuar pas kontrollit fizik 980 kg. Në lidhje me diferencën prej 124 kg, germa "a", pika 1, neni 257 KD parashikon një sanksion në masën e 2-fishit të detyrimit të munguar.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Znj. A.D., me detyrë, kryetar në D.D. Shkodër, në cilësinë e vendimmarrësit;

2) Znj. A.D., me detyrë, juriste në D.D. Shkodër, në cilësinë e konceptuesit të vendimit;

3) Z. A.G. dhe z. I.M. , Doganier, në cilësinë e punonjësve konstatues;

Për sa trajtuar në këtë pikë (2.5) të Raportit Përfundimtar të Auditimit, pas dërgimit të Projektraportit, përveç sa është observuar dhe trajtuar mbi akt konstatimin përkatës, nga subjekti i audituar (znj. A.D), nëpërmjet shkresës nr. 28/32 prot., datë 22.06.2026 administruar në KLSH me nr. 15/6 prot., datë 02.07.2026, është paraqitur observacioni dhe janë shprehur objeksionet, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:... *Jem e mendimit se vlera e shtuar e auditimit qëndron në identifikimin objektiv të çështjeve që kërkojnë përmirësim dhe në orientimin e administratës drejt zgjidhjeve më të mira, duke evidentuar njëkohësisht edhe masat pozitive të ndërmarra dhe rezultatet e arritura. Një qasje e tillë do të kontribuonte më tej në forcimin e bashkëpunimit institucional dhe në rritjen e efektivitetit të rekomandimeve të dhëna.*

Së pari, lidhur me konkluzionin se "nuk janë paraqitur argumente, prova ligjore apo dokumentacion për të ndryshuar qëndrimin e grupit të auditimit", vlerësoj se ky konstatim nuk qëndron në raport me natyrën e observacionit të paraqitur. Observacioni im është ngritur mbi argumente ligjore dhe mbi interpretimin e kompetencave funksionale që lidhen me procesin e vendimmarrjes. Në cilësinë e juristit, unë nuk prodhoj dhe as nuk kam detyrim ligjor të siguroj prova apo dokumentacion shtesë, por administroj dokumentacionin e paraqitur nga strukturat përgjegjëse për konstatimin dhe referimin e shkeljeve. Për rrjedhojë, nuk është e qartë se çfarë lloj prove apo dokumentacioni shtesë do të duhej të paraqitej për të mbështetur një argumentim që lidhet ekskluzivisht me kompetencat funksionale dhe interpretimin e dispozitave përkatëse.

Së dyti, në lidhje me referimin e Rregullores së Brendshme, konstatohet se në përgjigjen ndaj observacionit është cituar i njëjti përcaktim që është referuar edhe prej meje. Konkretisht, detyrat funksionale lidhen me administrimin e dokumentacionit dhe përgatitjen profesionale të akteve administrative. Megjithatë, në asnjë prej konstatimeve të auditimit nuk evidentohet se dokumentacioni nuk është administruar në mënyrë të rregullt, se ka pasur mangësi në elementet e nevojshme për vendimmarrje, apo se vendimet nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurave Administrative. Së treti, lidhur me çështjen e diskrecionit administrativ, vlerësoj se përgjigja e dhënë nuk adreson thelbin e observacionit të paraqitur. Në observacion nuk është vënë në diskutim ekzistenca apo ushtrimi i diskrecionit administrativ, por është referuar

Manuali Udhëzues nr. 05, datë 31.03.2016, ku përcaktohet qartë se verifikimi i elementeve që lidhen me përcaktimin e masës së gjobës kryhet nga struktura të tjera funksionale.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observacionin e paraqitur vlerësojmë se:
Pretendimet e subjektit, përtej stilit të retorikës, në thelb, janë të njëjta me ato të paraqitura dhe trajtuara nga grupi i auditimit në fazën e akt konstatimeve.
Si përfundim, pretendimet e paraqitura nuk merren në konsideratë dhe qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

IV. REKOMANDIME.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave doganore për periudhën 2020-2025 rezultoi se Dega Doganore Shkodër nuk është e përfshirë në procesin e planifikimit të të ardhurave, pasi plani i të ardhurave hartohet dhe i përcillet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke pësuar ndryshime të shpeshta gjatë vitit buxhetor. Gjithashtu, Dega Doganore Shkodër nuk disponon planin fillestar vjetor të detajuar sipas muajve, si dhe nuk ka në administrim metodologjinë mbi bazën e së cilës përcaktohen objektivat e planifikimit të të ardhurave.
Nga auditimi u konstatua gjithashtu se analizat mbi faktorët që ndikojnë në realizimin ose mosrealizimin e të ardhurave janë të pjesshme, jo të plota dhe nuk ofrojnë një vlerësim të argumentuar mbi shkaqet e devijimeve nga plani. Për më tepër, për vitin 2025 plani i të ardhurave është miratuar në një nivel më të ulët se realizimi faktik i vitit 2024, konkretisht në masën 97% të realizimit të vitit paraardhës, ose 128,590 mijë lekë më pak, pa një analizë dhe argumentim të dokumentuar që të justifikojë këtë ulje.
Sa më sipër tregon mangësi në procesin e planifikimit, monitorimit dhe analizës së të ardhurave doganore, duke kufizuar mundësinë për një planifikim real dhe për një vlerësim të saktë të performancës së mbledhjes së të ardhurave, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014, "*Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë*", si dhe të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-17 të Raportit të Auditimit).
1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në bashkëpunim me Degën Doganore Shkodër, të marrë masa për: dokumentimin dhe administrimin e metodologjisë mbi bazën e së cilës hartohet plani i të ardhurave doganore, administrimin dhe ruajtjen e planit fillestar vjetor të të ardhurave, si dhe të çdo ndryshimi të miratuar gjatë vitit buxhetor, duke garantuar gjurmueshmërinë e tyre; Gjithashtu, të marrë masa për përfshirjen e Degës Doganore Shkodër në procesin e analizës dhe vlerësimit të faktorëve që ndikojnë në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, hartimin e analizave periodike, të plota dhe të dokumentuara mbi realizimin ose mosrealizimin e planit të të ardhurave, duke identifikuar shkaqet e devijimeve dhe duke propozuar masa konkrete për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të të ardhurave doganore.

Në vijimësi

2. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të detyrimeve të papaguara, për rastet e përzgjedhura për t'u audituar nga vendimet e vitit 2020-2025, është konstatuar se nuk ka gjurmë dokumentare që të vërtetojnë se subjekti nuk ka marrë dijeni për njoftimin e vendimit,

pasi mungojnë shënimet lidhur me kthimin e njoftimit, refuzimin e marrjes në dorëzim ose çdo dokument tjetër që provon pamundësinë e njoftimit. Mos mbajtja e njoftimeve mbi marrjen dijeni të vendimit është në kundërshtim me pikën 3.b) të Udhëzimit nr. 15, "*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 17-51 të Raportit të Auditimit).
2.1 Rekomandimi: Nga Dega Doganore Shkodër (struktura përkatëse), të merren masa për dokumentimin e plotë të procedurës së njoftimit të akteve administrative për lindjen e borxhit doganor, duke administruar në dosjen përkatëse provat që vërtetojnë marrjen ose mosmarrjen dijeni nga subjekti, përfshirë konfirmimin e marrjes, kthimin e njoftimit, refuzimin e marrjes ose çdo dokument tjetër që provon përmbushjen e procedurës së njoftimit, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

Në vijimësi

3. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të detyrimeve të papaguara për vitet 2020-2025, është konstatuar se, në 8 raste me vlerë detyrimi 10,304 mijë lekë, nga Dega Doganore Shkodër nuk është kërkuar në kohë pezullimi i aktivitetit ekonomik në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Ky veprim bie në kundërshtim me Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet DPD dhe DPT, me nr. 14355 prot., datë 19.06.2018 në DPT, dhe nr. 12819 prot., datë 19.06.2018 në DPD, nenin 6 "*Mbledhja e detyrimeve të papaguara dhe të tjera" pika 7*.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 17-51 të Raportit të Auditimit).
3.1 Rekomandimi: Nga Dega Doganore Shkodër (struktura përkatëse) të merren masa për dërgimin në kohë të listave të debitorëve për të cilët është lëshuar urdhri i ekzekutimit, në mënyrë që të bëhet pezullimi i aktivitetit ekonomik nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me qëllim rritjen e efektivitetit të masave të marra për rikuperimin e detyrimeve doganore të papaguara.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të detyrimeve të papaguara për vitet 2020-2025, është konstatuar se, në 5 raste me vlerë 30,608 mijë lekë, nga Dega Doganore Shkodër nuk është kërkuar bllokimi i veprimeve në sistemin ASYCUDA WORLD, veprim i cili është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 15, datë 03.12.2018, "*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 17-51 të Raportit të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: Nga Dega Doganore Shkodër (struktura përkatëse) të merren masa për dërgimin pranë DPD të të gjitha vendimeve të shpalljes debitor, si dhe për zbatimin e masave garantuese duke kërkuar bllokimin e menjëhershëm të veprimeve në sistem, me qëllim rritjen e efektivitetit të masave të marra për rikuperimin e detyrimeve doganore të papaguara.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të detyrimeve të papaguara për vitet 2020-2025, është konstatuar se, në 15 raste me vlerë borxhi në shumën 79,846 mijë lekë, nga ana e Degës Doganore Shkodër ka pasur vonesa në dërgimin e kërkesave për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, veprim i cili është në kundërshtim me Udhëzimi nr. 15, datë 03.12.2018 "*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës*", kapitullin VIII.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 17-51 të Raportit të Auditimit).
5.1 Rekomandimi: Nga Dega Doganore Shkodër (struktura përkatëse) të merren masa për rastet debitore, të dërgohen në kohë kërkesat për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve në proces gjyqësor ka rezultuar se, në lidhje me kontabilizimin e detyrimeve të papaguara, referuar nenit 95 e vijues të Kodit Doganor, nuk është bërë kalimi nga llogaria 7115210 "Gjoba" tek llogaria 4665100 "Mjete në ruajtje", pasi, në rast se çështjet që janë në ankimim nuk rezultojnë në favor të Degës Doganore Shkodër, kjo e fundit është e detyruar t'i kthejë shumën e paguar subjektit përkatës. Kjo mund të realizohet në periudhat e ardhshme ushtrimore vetëm nga llogaria e mjeteve në ruajtje 4665100, si e vetmja llogari që mbartet nga viti në vit. Zyra e Financës ka mbajtur njëkohësisht edhe llogarinë 468, si e drejtë për të arkëtuar mjetet monetare (llogari aktivi), dhe llogarinë 4665100, si detyrim për kthimin e mjeteve monetare subjekteve përkatëse, nëse finalizimi i procesit gjyqësor është në favor të subjekteve (pra, llogari detyrimi). Ndërkohë, Zyra e Borxhit e ka hequr subjektin si debitor në momentin që ai ka likuiduar detyrimin dhe ka vendosur garanci për gjobën, qoftë kjo në llogarinë 7115210 ("Gjoba"), qoftë në llogarinë ekonomike 4665100 ("Mjete në ruajtje"). Veprime të cilat janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.*2018 "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjrs së Përgjithshme*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 17-51 të Raportit të Auditimit).
6.1 Rekomandimi: Nga Dega Doganore Shkodër, Zyra e Financës dhe Zyra e Borxhit të merren masa që procedurat e kontabilizimit të detyrimit doganor, për rastet kur detyrimi doganor është objekt shqyrtimi administrativ ose gjyqësor dhe nuk ka marrë formë të prerë, të bëhet kalimi i shumave nga llogaria 7115210 "Gjoba" në llogarinë 4665100 "Mjete në ruajtje".

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të detyrimeve të papaguara është konstatuar se, në të gjitha rastet, Vendimi mbi Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor nuk është nxjerrë brenda afatit të parashikuar në pikën 2.1 të kapitullit VII të Udhëzimit nr. 15, datë 03.12.2018, "*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 17-51 të Raportit të Auditimit).
7.1 Rekomandimi: Nga Dega Doganore Shkodër të merren masa për nxjerrjen në kohë të Vendimit për Rikuperimin me Forcë të Detyrimeve Doganore, pas mbarimit të afatit 10-ditor nga marrja dijeni mbi njoftimin e vendimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të lidhura me veprimtarinë e regjimeve RPA që kanë operuar pranë Degës Doganore Shkodër, rezultoi se, në 58 raste në total të ndara në 28 raste me koeficentin të ndryshëm nga 1 dhe 30 raste me koeficentin e barabartë me 1, nuk është kryer kontroll fizik për verifikimin e koeficientit të shfrytëzimit, veprim i cili është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 4, datë 28.03.2019, "*Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv*", kreu XIII, pika 5.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 64-151 të Raportit të Auditimit).
8.1 Rekomandimi: Kryetari i Degës Doganore Shkodër të marrë masa për të siguruar kryerjen e kontrollit fizik, si dhe kryerjen e verifikimit të koeficientit të shfrytëzimit në të gjitha rastet e regjimit RPA, sipas kartave teknologjike.
8.2 Rekomandimi: Kryetari i Degës Doganore Shkodër të marrë masa për të siguruar kryerjen e kontrollit fizik si dhe kryerjen e verifikimit të koeficientit të shfrytëzimit për të gjitha RPA që janë akoma të pambyllura.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Dega Doganore Shkodër, lidhur me vendimet administrative, në 24 (njëzet e katër) raste, të specifikuara në aneksin nr. 1,

u konstatua se, edhe pse autoriteti vendimmarrës ka përdorur diskrecion në aplikimin e sanksionit, në lidhje me këtë të fundit, nuk ka dhënë asnjë shpjegim pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar. Mungesa e shpjegimit të diskrecionit, si një element i arsyetimit të aktit ndikon negativisht në ligjshmërinë e këtij të fundit. Mosveprim në kundërshtim me nenin 100 të *"Kodit të Procedurave Administrative*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 151-176 të Raportit të Auditimit).
9.1 Rekomandimi: Autoriteti Vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, në të gjitha rastet e përdorimit të diskrecionit në aplikimin e sanksionit, të specifikojë në mënyrë të qartë në arsyetimin e aktit administrativ, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Dega Doganore Shkodër, lidhur me vendimet administrative, në 3 (tre) raste, të specifikuara në aneksin nr. 1, u konstatua se, edhe pse autoriteti vendimmarrës praktikisht ka sekuestruar mallin objekt kontrabande dhe ka zgjidhur administrativisht kontrabandën sipas nenit 272 të Kodit Doganor, nuk rezultoi të ketë marrë (formalizuar) një vendim të shkruar për sekuestrimin e përkohshëm të mallit objekt kontrabande apo për zgjidhjen administrative të kontrabandës. Mosveprim në kundërshtim me pikën 1 të nenit 268 dhe nenin 272 të "*Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 151-176 të Raportit të Auditimit).
10.1 Rekomandimi: Autoriteti Vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, në të gjitha rastet e vendimmarrjes për zgjidhjen administrative të kontrabandës apo sekuestrimit të mallit objekt kontrabande, të shoqërojë dhe formalizojë këto veprime me një vendim të shkruar.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Dega Doganore Shkodër, lidhur me vendimet administrative, në 2 (dy) raste, të specifikuara në aneksin nr. 1, u konstatua se, edhe pse autoriteti vendimmarrës ka vendosur për zgjidhjen administrative të kontrabandës, nuk rezultoi që dosja (praktika) t'i jetë dërguar organit të prokurorisë. Nga dokumentacioni i administruar nuk rezultoi të administrohet shkresa e përcjelljes së praktikës pranë organit të prokurorisë, si dhe një veprim i tillë nuk është parashikuar në dispozitivin e vendimit administrativ, mosveprim në kundërshtim me pikën 1 të nenit 276 dhe me pikën 2 të nenit 277 të *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 151-176 të Raportit të Auditimit).
11.1 Rekomandimi: Kryetari i Degës Doganore Shkodër (Autoriteti Vendimmarrës), në të gjitha rastet e vendimmarrjes për zgjidhjen administrative të kontrabandës, të përgatisë dosjen e plotë, në lidhje me shkeljen, dhe t'a dërgojë atë menjëherë pranë organit të prokurorisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së sektorëve të akcizës në Degën Doganore Shkodër u konstatuan mangësi proceduriale dhe administrative në planifikimin, dokumentimin dhe ushtrimin e kontrolleve të akcizës, konkretisht: mungesë të dokumentacionit provues në dosjet e kontrollit; mosadministrim i deklarimeve mbi stokun kontabël, produktet dhe pullat fiskale; moskryerje e plotë e veprimeve përgatitore para ushtrimit të kontrollit; mungesë e analizës së riskut dhe e provave mbështetëse në relacionet e programeve të kontrollit; si dhe mosushtrim i kontrolleve periodike gjatë gjithë vitit. Gjithashtu u konstatuan mangësi në procedurat e inventarizimit për trajtimin e tepricave dhe mungesave, regjistrimet në kontabilitetin e stokut dhe administrimin e dokumentacionit DSHA. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 66/1, 66/4, 73 të Urdhrit nr. 146, datë 07.05.2018 "*Për miratimin e Rregullores së Brendshme të DPD-së*", me VKM nr. 612, datë 05.09.2012 "*Dispozitat zbatuese*

të ligjit mbi Akcizat", si dhe me pikat 6.3, 6.4, 6.4.2 dhe 7.4 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2021 "*Manual mbi metodologjinë e kontrolleve të akcizës*", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 51-64 të Raportit të Auditimit).
12.1 Rekomandimi: Dega Doganore Shkodër të marrë masa për forcimin e kontrollit dhe monitorimit të veprimtarisë së sektorëve të akcizës, duke garantuar zbatimin e plotë të procedurave ligjore dhe metodologjike për planifikimin, dokumentimin dhe ushtrimin e kontrolleve, administrimin e dokumentacionit provues, kryerjen e analizës së riskut, si dhe respektimin e procedurave të inventarizimit dhe administrimit të stokut e pullave fiskale, në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË BUXHETIN E SHTETIT

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të përzgjedhura për auditim u konstatua mosrespektim i afatit për mbylljen e regjimeve RPA, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi. Më hollësisht, për 7 subjektet, "C.E", "J.C.", "K.", "P.M.", "Da", "C.", "A.Sho.", regjimet RPA rezultojnë të mbyllura jashtë afatit kohor prej 30 ditësh për mbylljen e regjimit, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e nenit 251/2/1 të Kodit Doganor "*Mosrespektimi nga mbajtësi i regjimit të përpunimit aktiv i detyrimit për mbylljen e regjimit doganor brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 23*", si dhe me Udhëzimin nr. 4, datë 28.03.2019 "*Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv*", pika 18, germa "*dh*" dhe kreu XIV, pika 2 të këtij udhëzimi, pasi regjimi duhej të mbyllej 30 ditë pas dhënies së destinacionit të produkteve parësore kompensuese. Nga autoriteti përgjegjës nuk është mbajtur procesverbal konstatimi, referuar nenit 273.3 të Kodit Doganor. Nga mosveprimi, referuar nenit 256, pika 1, shkronja "*b*" të Kodit Doganor, penaliteti është 20,000 lekë dhe, si rezultat, efekti financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit rezulton në total 140,000 lekë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 64-151 të Raportit të Auditimit).
1.1 Rekomandimi: Kryetari i Degës Doganore Shkodër të marrë masa për shqyrtimin, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve doganore/penaliteteve në vlerën totale 140,000 lekë për subjektet që kanë rezultuar me shkelje në procedurat dhe respektimin e afateve për mbylljen e regjimit të përpunimit aktiv, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor në fuqi.

Menjëherë

2. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të përzgjedhura për auditim u konstatua se 12 raste të ndarë në 6 subjekte, konkretisht subjekti "K" në 3 raste, subjekti "R.F." 1 rast, subjekti "K 12" në 3 raste, subjketi R.G." 1 rast, subjekti "C.Sho" 2 raste dhe subjekti "A.Sho" në 2 raste, kanë importuar mallra që do të vendoseshin nën regjimin doganor për t'u përpunuar me kode që nuk janë pjesë e autorizimit RPA, të përcaktuara në pikën 7 të autorizimit të operatorit, si dhe kanë eksportuar mallra të përpunuara për të cilat nuk disponojnë kodet përkatëse në pikën 8 të autorizimit të RPA. Për këta artikuj, të papërfshirë në kodet tarifore të përcaktuara në pikat 7 dhe 8 të autorizimit, duhej të ishin paguar detyrimet doganore si në hyrje, ashtu edhe në dalje. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 250.1/a, 250.2 dhe 250.4 të Kodit Doganor. Referuar neneve të sipërcituara, për shkeljen doganore të kryer, subjektet, përveç detyrimeve doganore (të cilat nuk janë përllogaritur në këto raste, duke qenë se mallrat janë rieksportuar në formën e produkteve kompensuese), për kodin tarifor të papërfshirë në autorizim duhej të penalizoheshin me 20,000 lekë për çdo deklaratë, referuar nenit 251, pika 1 dhe nenit 256, pika 1, shkronja "b" të KD. Efekti financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit përllogaritet në vlerën 990,000 lekë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 64-151 të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Degës Doganore Shkodër të marrë masa për shqyrtimin dhe trajtimin e rasteve të subjekteve që kanë rezultuar me shkelje të kushteve të autorizimeve përkatëse, duke kryer kontabilizimin dhe ndjekjen për arkëtimin e detyrimeve doganore dhe penaliteteve të lindura në vlerën totale 990,000 lekë, në përputhje me përcaktimet e Kodit Doganor dhe akteve nënligjore në fuqi.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të përzgjedhura për auditim, lidhur me subjektet që operojnë nën regjimin RLP, rezultoi se në 4 raste: subjekti "C.Sh." ShPK me NUIS .... (për 1 rast), subjekti "P M G" ShPK, me NUIS ..... (për 2 raste) dhe subjekti "C." ShPK, me NUIS .... (për 1 rast) kanë diferenca në sasi, pasi kanë tejkaluar sasitë e përcaktuara në autorizimet përkatëse, duke eksportuar sasi mbi kufijtë e miratuar nga autoriteti doganor. Këto veprime të subjekteve, për diferencën në sasi të përcaktuar në autorizimin e RLP-së, përbëjnë shkelje doganore, referuar neneve 250, 252/c dhe 257/1, shkronja "b" të Kodit Doganor. Efekti financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit përllogaritet në vlerën 200,000 lekë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 64-151 të Raportit të Auditimit).
3.1 Rekomandimi: Kryetari i Degës Doganore Shkodër të marrë masa për shqyrtimin e diferencave në sasi të konstatuara në eksportet e kryera nga subjektet që operojnë nën regjimin RLP, si dhe të marrë masa për shqyrtimin, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve doganore apo penaliteteve për subjektet që kanë rezultuar me shkelje në vlerën totale 200,000 lekë, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor në fuqi.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Dega Doganore Shkodër, lidhur me vendimet administrative, në 5 (pesë) raste, të specifikuara në aneksin nr. 2, u konstatua mostrajtim i drejtë dhe klasifikim i gabuar i shkeljeve doganore duke mos aplikuar sanksionet apo penalitetin e duhur. Si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve, në kundërshtim me nenet 251, 252, 256 dhe 257 të Kodit Doganor, janë shkaktuar të ardhura të munguara në shumën 208,483 lekë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 151-176 të Raportit të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: Kryetari i Degës Doganore Shkodër të marrë masa për shqyrtimin, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve doganore apo penaliteteve për subjektet që kanë rezultuar me shkelje në vlerën totale 208,483 lekë, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në Nenin 15 "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*", shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Nenin 58 "*Llojet e masave disiplinore*", të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*" dhe VKM-së nr. 115, datë 05/03/2014, "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*", **i rekomandojmë** Kryetarit të Degës Doganore Shkodër dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën, proporcionalitetin dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë individuale, të bëjë vlerësimin e shkeljes dhe, kur është rasti, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë këtij Institucioni, marrjen e masave disiplinore përkatëse.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT